BKSH

BKSH

ВКSН

E VËRTETA MBI SHQIPNINË DHE SHQIPTARËT

STUDIM HISTORIK

NGA

VASSA EFFENDI

Përkthim nga frengjishtja
dhe komentim

NGA

MEHDI FRASHËRIT

BLSH

BKSH

E VËRTETA

MBI

SHQIPNINË DHE SHQIPTARET

Studim historik

prej

VASSA EFFENDI

Përkthim dhe komentim

prej

MEHDI FRASHËRIT

TIRANË
Shtypur në shtypshkronjën „Tirana"
1935

BKSH

BKSH

Vassa Pasha Shkodrani

Vjersha
e Vaso Pashë Shkodrësë

Mori Shqipëni, e mjera Shqipëni,
Kush të ka qitun me krye në hi?
Ti ke pas ken nji zonj e rand,
Qi burrat e dheut të thirshin nan.
Ke pas shum të mira e shum begati,
E vajza të bukra e djem me trimni.
Gja e dhena shum e ara e bashtina,
Me armë të lara me pushka latina.
Me burra trima me gra të dlira,
Ti nër gjith shoqet ke kën ma e mira!

Por tani Shqipni, pa më thu si je;
Posi lis' i naltë i rezum për dhe; (1)
Gjith bota vjen, me kambë të shklet;
E nji fjalë t' ëmblë, kurkush s' ta flet
Kur kriste pushka si shkepëtin moti,
Zogu i Shqiptarit gjithmon i zoti.
Ka pas ken për lufta e në luft ka vdek.
E dhuni për mrapa kurr nuk ka hek,

Kur ka pas lidh besën burri i Shqipnis,
I ka pas shti dridhën gjith Rumelis.
Ner lufta të rrepta gjithmon ka ra,

---

(1) N'at kohë kur ësht thënë vjersha.

Me faqe të bardh gjithmon asht da,
Ene s' të ka met as fam as bes,
Vet e ke prish me faqe të zez.
Ju Shqiptar' me vllazën jini tui vra,
E n' nj' qint çeta jini shpërda.
Ca thon kena fe, ca thon kena din,
Njani thot jam turk, tietri latin.
Do quhen grek, shqie disa të tjer,
Por jeni vllazën gjith mor të mjer,
Priftnit e hoxhët ju kan hutu,
Për me ju damun e me ju vorfënu.
Vjen njeri i huaj e ju ri në votër,
Për me ju turpnu me gru e me motër.
Për sa pare të shkreta qi do të fitoni,
Besën e të parve të gjith e haroni.
Ene bahi robt e njeriu të huaj,
Qi nuk ka as ginhën as giakun tuj.

Qani ju shpata, qani ju dyfeqe,
Se u zu Shqipënija si zogu nër leqe.
Të qaj trimnija të qaj bashkë me ne,
Se ra Shqipënia me faqe në dhe.
Ene s' i ka metun as buk as mish,
As ziarm në votër as drit as pish.
As gjah nër faqe as ner nër shok,
Por asht rrëzumun asht banun trok.

Mblidhuni ju vajza, mbildhuni ju gru,
Me ato sy të bukur që dini me qa.
Ene të vajtoni Shqipënin e mjer,
Qi ka met e shkret pa erz' e pa ner.
Qi ka met e vej si grua pa burr,
Si nana qi nuk ka banun fëmi kurr.
Kuit i ban zemra me lan me vdek,

Kët far trimneshet që sod asht mek.
Kët nan të dashme as po dot e lam,
Qi njeria i huj t' a shkeli me kam?
Nuk, nuk, kët marri kërkush s' e do,
Kët faqe të zez kërkush s' e duro.
Para se të humi kështu Shqipënija,
Me pushk në dor le të vdes trimnija.
Çohni Shqiptar pri gjumit çohni,
Të gjith si vllazën n' nji bes shtërngohi.

Ene mos shikoni kisha e xhamija
Se feja e Shqiptarit' asht Shqiptarija.
Që pri Tivarit deri në Prevez,
Gjith kund lishon dilli vap dhe rrez,
Asht toka jon të parët na i kan lan,
Kush mos të përkas se vdesim të tan.
Se vdesim si burrat qi vdiqën që motit,
Për mos me u turpënu para Zotit!

Parathanje

Jeta e kombeve, si dhe ajo e njerzëve, pësoi anomali dhe coptime. Koha, këjo rafshuësse e madhe e sendeve dhe e njerzëvet, ç'do gjë që jetòn e që lëvis nen-diell, e shtroi nen ligjën e epërme të s'aj; dhe me qënë se ç'do send ka një fillim, ç'do gjë xhvillohet, bije edhe mbaron duke u ndryshuar.

Popujt, përgjithësisht u dëfyruan të shkojnë nga gjith këto faza edhe t'i paguajnë pushtetit të kohës pagen e tyne. Kurgja nuk mbetet e qendrueshme: Përparimin e tyre e pasoj çkatërrimi dhe këtë, ndryshimi ose një prishje e plotë.

N'ësht se ndodhen popuj që kanë pasun fatin e mirë të kenë glorije, begati, fuqi dhe që historia ka vazhduar të mbajë të gjallë në brezat e pastajmë kujtimin e qenjes dhe të fatmeve të tyre, ka dhe të tjerë që me gjith përpjekjet edhe peripetit prej të cilave kanë mbetur të pa njohur edhe kujtimi i tyre, na ësht transmetnar nen një formë t'errët edhe jo të pëkturuar mirë.

Jashta këtyre dy rendeve prej të cilave njeri pushton popujt që kanë humbur ekzistencën e vet dhe janë përzier me ekzistencen e popujve të tjerë, dhe që tjetëri përfshin ata kombe që janë shuar krejt edhe janë fshirë prej faqes së dheut pa lënë as një trage të ekzistencës së tyre; ka dhe një rend të tretë në të cilin mund të radhiten ata popuj që origjina e tyne humbet

nē naten e kohērave prallore dhe qē vazhdojnē tē jetojnē me njē jetē tē posaçme, me gjith qē kanē kaluar njē radhē tē gjatē veshtyrsinash dhe qē historia e tyre, pēr shkak mungese qytetnimi tē pērparuar ose rethanash qē ikin nga kuptimi jonē, mbetet njē problem zgjidhja e sē cilēs pritet akoma.

S'ka dyshim se populli shqiptar hyn nē kategorin e tretē.

Prej ku vjen? Kush ēsht? Si jeton?

Qe, çashtje shum tē komplikuara, tē cilavet akoma nuk u ēsht dhēnē njē pērgjigje e kēnaqēshme.

Ēsht larg prej nesh pretendimi se do tē themi sende tē ra ose tē besojmē fuqit t'ona t'afta pēr tē lēftuar me titore kundra vēshtirēsinave qē gjen pērpara studimi abstrakt i origjinēs dhe i jetēs sē njē populli qē nuk' ka pasur historishkronjēs tē vetē pēr tē transmetuar gjer tek na, organizimin qytetnor dhe politik tē tij, as edhe peripetitē qē kanē kerenuar ekzistencēn e tij pa mundur qē ta shuajnē.

Nuk' kemi qellim tjetēr veç se tē parashtrojmē me njē formē pērshkruēse, pershtypjet qē na kanē lēnē zakonet dhe doket, gjuha, vetiat dhe karakteri i kētij populli dhe t'i vemē sup pēr sup me ato tē popujve ma tē vjetēr. Tē tjerē njerz mē t'aft nga na mund t'i pērdorin me dobi edhe mē me shum sukses pēr shkencēn, vērejtjet dhe gjykimet me tē cilat do tē shoqērojmē studimin t'onē.

KAPTINA I.

Duke hypur në kohërat e vjetëra më të thella, gjejmë në për mes të prallave që popuj të ndryshmë, duke ardhur nga Asia, në shum raste, i janë afruar tokës Greke dhe se më i vjetëri dhe mbase më i shumti, midis këtyre popujve pushtuës, ishte ajy popull traditat dhe historia e të cilit na kanë lënë kujtime nen emrin Pellazg.

Pa qendruar në të thënat e prallës që përmend një pellazg të parë, të bir' e dheut që nga shekulli XIX para Krishtit ishte vendosur n'Arkadie edhe q'u pasua prej një pellazgu të dytë që mbretëronte në Etolie dhe prej një Eueloni që mbretëronte mbi Mollosët, popull Epiri, në shekullin XVI para Krishtit gjejmë një Danaus Egjyptas i cili duke qënë i pranuar si bujtës «musafir» pranë Pellazgut ose Gjelanorit, me tradhëti vret këtë edhe i rembeu shkopin e Argosit.

Gjith ngjarjet që kanë ndodhur gjat kohës që ne e quajmë prallore e gjer te shekulli (IX) para Krishtit, na provojnë se toka Greke ishte pushtuar pikë së pari prej pelazgëve edhe pastaj prej popujve të tjerë që vinin në përpjekje me ata që ndodheshin të vendosur me parë. Këjo duket t'ishte një vajtje e ardhje e popujvet q'i afroheshin kontinentit; lëftonin me njeri tjetërin edhe me qënë se nuk mund të përziheshin, ktheheshin pas ose dhonin ata që nuk mund të qëndronin. At-here, s'ka dyshim se Pellazgët të pas lindurit e Pellaz-

gut që quhej i bir ii dheut, ishin ata që kanë arritur më parë në Greqi dhe që ndaj atyre q'erdhne më vonë kanë pasur karakterin e vendeve «autochthones».

Duke qënë të sulmuar prej popujve q'u çfaqnë pastaj nen emrat «Eolë», «Jonë», «Dorinj», edhe të tjerë, u shternguan të lënë buzët e detit dhe rafshinat për të kërkuar një struk «Asile» në brëndësin e vendit nder vise të repta.

Pellazgu i dytë që ka mbretruar në «Eolie» edhe Faetoni mbi Mollosët, popull' i Epirit, nuk mund të ishin pa dyshim veç se kryetarët e këtyre Pellazgëve të cilët i shtërnguan sulmimet e Eolevet, e Jonevet dhe t'Elineve të lënë Argonë dhe vendet e tjera që kishin pushtuar që në fillim të çfaqjes tyre në tokë. Një provë që mund të tregohet në mbështetjen e këti gjykimi, ësht fakt' i Danausit që ka ardhur në Argo në shekullin XVI dhe pas si vrau Gjelanorin, q'e kish pritur si mik bujtës, i grabiti Shtetin dhe shterngoj nenshtetasit e tij të çkulen e të shtetgtojnë grumbullisht në drejtim të mateve.

Në shekullin e IX kur kohrat prallore filluan t'i lënë vend historis, gjejmë një Karanus q'ishte ngritur prej Argose dhe kish vajtur të vendosej në «Emathie» dhe vuri themelet e mbretëris Maqedonas. Karani ishte nga të paslindurit e Pellazgëve origjina e të cileve humbet në pralla. Duke mos mundur që të qëndrojë n'Argos, e okupuar, siç thamë më sipër, pikë së pari prej Danausit edhe pastaj mbase prej të tjerave, shkoj të kërkonte një struk në brëndësin' e vendit edhe u ngul n'Emathie.

Esht provuar se para kësaj kohe emri i Maqedhonis nuk ekzistonte. Pra si mbas thënjes të të gjith historijanëve të vjetër, Emathia ishte emer' i parë i Ma-

qedhonis dhe ësht këjo Emathi që duhet të konsiderohet si berthama dhe si djep' i asaj Mbretërie e cila ma vonë u bë kaq e fuqishme dhe kaq në zë.

Pra në origjinën, Emathia nuk mund t'ishte tjetër veç se aji vend që ndodhet në malet e Shqipris, ndermjet Dibrës, Krujës dhe Mirditës që sot akoma quhet Mat dhe Matia. Ky emër Matia ju dha atij qarku malësor nga emri i lumit që e përshkon dhe që nen emërimin Matia bije në detin Adriatik midis Durrsit dhe Shkodrës. Afër Matjes gjëndet një vend i mbushur me rrënime të vjetëra dhe duken të mbeturat e një kulës rumbullake e cila përgjithësisht ësht e njohur nen emrin «Pel-la».

Ç'vështirësi do të kishte ne qoftë se pranojmë që Matia dhe Emathi të jetë po aji vend dhe që «Pel-la» ka qënë Kryeqytet i tij? E dimë se popujt e vjetër kur shtërngoheshin të linin vendin e parë të tyne për të kërkuar një tjatër, kishin zakon t'u jepnin vendeve të ra emrat e vjetëra dhe kur ngrihnin qytete të ra zakonisht u jepnin emrat e qyteteve që linin.

Gjith ashtu dimë se Karani, shokët dhe të paslindurit e tij nuk u kufizuan vetëm me okupimin e Emathisë; por dal nga dal zgjeruan zotrimin e tyre si me prudencë ashtu dhe me trimërin e tyre duke u treguar t'urtë në fitimet dhe duke i përdorur si vëllezër popujt që kishin pushtuar. Ahere nuk largohet provushmënia e një fakti që ësht përsëritur një mijë herë, d. m. th. se emertimi Emathi do të ketë përfunduar duke u zgjeruar mbi gjith zonën e pushtimit të tyre dhe që «Pel-la» të cilën gjeografët e tregojnë afër Selanikut nuk ësht tjetër gjë veç se një qytet i ngrehur ma vonë prej mbretërve maqedhonas dhe të thirur me emrin «Pel-lë» e cila u bë djep i parë i pushtetit të tyre

Emri Maqedhoni ju dha ma vonë vendit të cilin Aleksandri i Math e bëri të famëshme me gjenin e tij ushtarake.

Nuk pretendojmë të çfaqim një mejtim si një sentencë pa apel, na tregojmë faktet, bëjmë afrime dhe regjistrojmë vërejtjet që na shpirtëson bashkëqëllesa e emrit, e dokeve, e zakoneve edhe e karakterit të popullësive të tashme të qarkut të Matit të cilat janë një me emrin, me vetijat edhe me zakonet e maqidhonasve të vjetër. Ja lemë shkencës kujdesin që të shkoqitij të vërtetën dhe të nxjerë përfundimet që përmban rasti.

Në shekullin e VII para Krishtit, gjejmë Filipin I, Mbretin e Maqidhonis, provushmënisht një të paslindur direkt i Karanit edhe një «Eropus» që pason atë. Në fund të këtij shekulli hasim një «Alkon» Mbret' i Epirit dhe në fillim të shekullit VI Aleksandrin të bir e Amintes, Mbret i Maqedhonis i cili vret ambasadorët e Persianeve për shkak se kishin dashur të turpëronin gratë.

Në shekullin e V, shekull' i Periklint, n'at shekull ku gloria e grekëve shkëlqeu me shkëlqimin ma të math, shofim një Perdika, Mbretin e Maqedhonis që ka bërë luft me Sitalcin, Mbret i Thraqjes.

Në këtë kohe, Maqedhonia ish një mbretëri mjaft e gjërë dhe mjaft e fuqishme.

Në kohen e pushtimit të Persianeve që ka ngjarë në këtë shekull, shohim popullin Elin të bashkohet në një mejtim kombtar lisnik dhe të kujdesohet për mbrojtjen e të drejtave, të nderit edhe të independences së tij; por nuk shohim as Maqedhonasit as Epirotët që të marin pjesë me grekërit kundra ushtërive të Xerxesit (Kserksesit). Herodoti thotë se vetëm ata që rinin për këtej Thesprotëve, duke qenë të afër me kufit

greke, dhanë përkrahjen e tyre; edhe nga këjo del se popullësit e Epirit jo vetëm që nuk bënin pjesë me Greqinë; por që nuk ishin as beslidhurit e tyre. Përkundrazi shumë Thrakas, Maqidhonas, Epirotë dhe Gale, vinin pas ushtëris Persiane si ndihmës dhe lëftonin kundra Greqis e cila u mbulue me glorie të pa vdekshme duke prishur ushtërinë më të madhe*që regjistron historia në faqet e saj me faqi të kufizuara.

Në shekullin IV u ndodh Perdika i tretë Mbret' i Maqidonis, që ra i vdekur në luftën që bëri me Ilirianët. Dhe Filipi, i ati i Aleksandrit të madh, që rahu Athinasit, shtroj Foqidhasit dhe që duke u pranuar në mbledhjen e Anfiksionit, hedh syt' e tij mbi Greqin dhe së andejmi pregatit të birët për fushën e fitimeve të mbëdha që do ta bënin të pavdekur.

Grekërit që nuk pushonin t'i quanin si barbarë gjith popujt që ndodheshin jashta kufive të republikave të tyre dhe q'i thrisnin barbarë ata që flisnin dy gjuhë, Greqishten dhe Pelazgjishten, ata që ndodheshin më afër tyre, dhe që me maredhanje të vazhduara kishin mundur të mësonin greqishten, me një mend nuk mund të pranonin Filipnë në mbledhjen e Anfiksionevet se pse nuk ishin të shtytur prej një ndjenje vëllazërije as prej një kombësije të përbashkët.

Filipi i kishte rahur dhe ju kërcënohej që t'i vinte nën zgjedhë plotësisht. Gjith ashtu n'ësht se njëri pranonte të hynte në mbledhjen e përgjithme Anfiksionike, këtë e bënte vetëm me një qëllim të politikës së naltë, për të rafshuar rrugën për ralizimin e projekteve të tij ambicioze, kurse të tjerët duke i hapur aty portat e mbledhjes, nuk bënë gjë sendi tjetër veç se ju shtruan nevojës; u shtrënguan me sjelljen e tij armi-

qësorë të duken paqtuës; Filipit nuk i dhanë veç se atë që mund të merte. Ësht e mundëshme që Filipi i trajtuar gjer at-here si barbar t'a ndiente vehten e tij të savderuar me kët akt' i cili atij i jepte një vënd në gjirin e qytetërimit.

Shënime mbi këtë kaptinë

Libri qi jemi duke përkthyer, nga pikpamja kombtare, ka një rëndësi krejt të posaçme për shkak se ësht libr' i parë, redaktuar dhe botuar në Frëngjishte prej një shqiptari patriot dhe nasionalist si Vassa-Pasha, në një kohë kur bota Evropjane edhe sidomos bota politike edhe dipllomatike nuk' ka pasur një ide mbi origjinën dhe historinë ashtu dhe mbi çështjen e nasionalizmës shqiptare që po çfaqej për herën e parë në Kançelarit e dipllomasis edhe në shtypin e Evropës.

Vepra, me një fjalë, ësht shtypur në Paris me 1879, në një gjuhë frëngjishte të bukur të cilën e shpirtëson dhe e ndriçon nxehtësia e ndjenjave patriotike të auktorit. Që ng'ajo kohe e gjer tashti, për sa i përket origjinës shqiptare, prej shkrimtareve të ndryshmë janë bërë studime dhe kërkime, jo vetëm me rastin e ethnollogjis shqiptare; por edhe reth ethnollogjis së kombeve fqinj me shqiptarët.

Çështja e Pelazgeve, në kohërat e fundit, midis shkëncëtarëve dhe historishkronjësve, ësht rahur shumë dhe si përfundim i këtij studimi ësht marë vësh se nën Emërin Pellazg Grekërit e vjetër kanë kuptuar në mënyrë të përgjithëshme gjith ato raca që janë ndodhur më parë në tokën klasike Greke. Disa shënime që shënohen në veprat e Grekërve të vjetër mbi Pellazgët

nuk japin një mejtim të qartë se ç'ka ishin Pellazgët. Kërkimet arheologjike në Gjirit edhe në Greqi ashtu dhe në tragat e zbuluar prej këtyre kërkimeve, tregojnë në mënyrë kategorike, që në një kohë kur fiset e ndryshme që kanë formuar popullin Elin, para se të vinë e të vëndosen në tokën Greke, atje ndodheshin fise të tjerë, qytetërime të tjera, q'akoma nuk dihet origjina e tyre. Për këtë shkak shkencëtarët e sotmë, për sa i përket fiseve para Elenike, kanë rënë d'akord mbi disa pika të cilat janë këto:

1. — Që populli që ka krijuar qytetërimin para-Elenik i cili është zbuluar në kërkimet arheologjike të Gjirit dhe si do mos të qytetit vjetër që quhej «Gnosos» dhe të qytetit Mikenës në Greqinë kontinentale, provojnë se populli në fjalë ka qënë prej një race të cilën dijetarët e sotmë e kanë emruar raca e Egjëut ose raca Mediterane edhe këjo racë nga shtati ka qënë e shkurtër, nga ngjyra si mulliri edhe nga kryet në formë oval.

2. — Se populli Elin është formuar prej katër fiseve:

a) — Jonët
b) — Eolët
c) — Ahainjtë
ç) — Dorinjtë.

Ahainjtë dhe Dorinjtë kanë qënë fis me Ilirjanët dhe kanë ardhur nga an' e Veriut të Greqis edhe të sirethnjezës Ballkanike, si do-mos Dorinjtë në kohëra shumë të vjetra para Krishtit, janë çkulur nga malet e Toskëris dhe kanë vajtur në Greqin' e vjetër, kurse Ahainjtë, shum shekuj para këtyne, kanë ardhur ng' an' e Veriut edhe janë vendosur atje.

Jonët nuk dihet mjrë se nga kanë ardhur. Sa për Eolët thuhet se janë një deg' e Ahainjve, të cilët kanë ardhur 1000 vjetë para këtyre në Ballkan. Me kalimin e kohës këtu katër fise janë përzierë dhe së bashku kanë krijuar popullin Elin. Këto fise kur kanë vajtur në Greqi, kanë gjetur një qytetrim më të vjetër i cili karakterjzohet nen emrin qytetrimi i Minosë. S'ka dyshim se në Greqin e vjetër kur kanë vajtur e janë vendosur të katër fiset të cilët formuan popullin Elin, atje ndodheshin elemente vëndas që me shumë provushmëni konsiderohet se kanë qënë prej racash të ndryshme para-Elenike. Grekërit e vjetër kanë shkuar një kohë mjaft të gjatë n'errësirë dhe pastaj kanë filluar të qytetërohen. Shkrimtarët grekë me ethnografi dhe me lengjistjkë nuk janë marë aspak, prandaj kur bëjnë fjalë për elemente para-Elenike i përmëndin me emrin Pellazgë. Dijenitë që japin shkrimtarët grekë mbi Pellazgët janë shum të kufizuara dhe t'errta; prandaj theoria që zhvillon në këtë broshurë Vassa Pasha ka qënë theori e vjetër e Haanit e Emjl Benleuvit, dhe e profesor De Rades të cilën e ka pranuar edhe Sami Bej Frashëri; por që diturija e sotme e refuzon kategorikisht dhe ksilloj, mbi ardhjen e grekëve në Greqi ikja e Pellazgëve dhe vendosja e tyre në Shqipni nuk ësht aspak e drejtë. Jo vetëm shqjptarët, por as edhe grekët nuk kanë ardhur nga Juga, përkundrazi kanë ardhur nga veriu si gjithë popujt e tjerë Hindo-evropjanë, bije fjala, si Gjermanët, Seltët, Latinët dhe Sllavët.

Gjith' ashtu edhe shqiptarët nuk janë gjë tjetër veçse stërnipërit e Ilirjanëve të përzierë me Thrakas, me tjetër fjalë jemj një popull Thrako-Ilirian. Analiza e [illegible] shqipe provon këtë të vërtetë; Shkrimtarët gre-

ke e Latinë kur bëjnë fjalë për shqiptarët, i përmendin me emrin Ilirian të cilët grekërit i quanin barbarë. Dhe këta Thrako-Ilirianë simbas fjaseve kanë pasur emra të veçantë, bije fjala: Çamëria, në kohërat e vjetra quhej Thesprotie; Labëria, Kaoni; Muzeqea, Tavllantie, qarku i Korçës, Desaretie; Shqipnia e Mesme Partheni e të tjera.

Analiza e emrave që kanë mbetur nga gjuha Thrakishte dhe krahasimi i saj me gjuhën shqipe, tregon se një pjes' e madhe e gjuhës s'onë, përbëhet prej Thrakishtes dhe pjesa tjetër prej gjuhës Ilirianë. Si Thrakasit ashtu edhe Ilirianët kanë ardhur nga ana e veriut, nga Evropa qendrore; Thrakasit, janë përhapur në gjithë kontinentin e sirethujzës ballkanike, janë ardhur dhe përtej Dardanelit në trualljn e vjetër «Trova» neu emrin «Frikas». Kurse Ilirianët janë shkëputur nga Evropa qendrore, nga Alpet e Austrisë të Çeko-Slovakis, të shtytur prej popujsh të tjerë dhe janë derdhur më të dy anët e Adriatikut, nga ana e Ballkanit gjer në gollfin Ambrasik dhe nga ana e Italis gjer në Mesapi. Gjithë pjesa e Venecjës së vjetër jshte e banuar prej Venelëve që ishin fis Ilirian, ashtu edhe Lapikërit dhe Mesapërit e Kalabris nuk ishin gjë sendi tjetër veçse Labërit dhe Mesapët e përtejmë.

Mesapliku i Vlorës, po t'i heqim prapashtimin «llëk» q'ësht turqjsht, mbetet fjala Mesapi dhe fjalës latine «lapik» po t'i heqim prapashtimin latin «ik» mbetet fjala Lab. Nga kjo meret vesh se dy fiset Ilirianë «Lab» e «Mesap» kanë okupuar dy brigjet e Adriatikut tej e përtej.

Sa për muret të ndërtuar me gurë të mëdhenj pa këlqere që kanë marë emrin «Muret e Qiklopëve» ose «Muret Pellazgjike», më të shumtit ndodhen në Ita-

gjet e detit të Greqis, të rethojzove l'Egjeut dhe në Butrinto e në Fenige (rreth i Delvinës), janë ca mure para-Elenike dhe disa dijetarë thonë se midis popujve paraElenjik që kanë ardhur në rethojzat e Egjeut e në Greqi, janë çkulur prej Kolshidës të Kaukazjes ku toka është e përzierë me gurë të mëdhenj. Ky fis, duke vazhduar brigjet e detit, është përhapur gjer në Greqi dhe në brigjet e detit të Shqipnis Jugore ku kanë ngrehur kështjella dhe mure të thatë pa këlqere me gurë të mëdhenj si në Kolshide, në vendin e origjinës ku ishin mësuar, të shtytur nga natyra e vëndit, të ngrihnin mure me gurë të mëdhej.

Me këto shpjegime, unë duam të shvelltësojnë veprën mjeshtërore dhe patriotike të Vasso Pashës; por dëshërojnë të shtyjnë intelektualët shqiptarë që të gjyrmojnë shkencën historike dhe ethnologjike të shekullit XX ku jetojnë.

Origjina Thrako-Iliriane e Shqiptarëve është pretenduar prej autorëvet gjermanë: Gustav Mayer, Kërçmer, Dr. Paç dhe Jokli, Autorët e tjerë më të rinj pretendojnë se jemi Balto-Sllavë dhe këtë pretendim duan t'a mbështetjn në disa krahasime gjuhësore ndërmjet shqipes së tanishme dhe fjalëve Iliriane të mbetura e të mbledhura nga veprat e ndryshme t'auktorëve të vjetër greko-latin; kur se ky krahasim nuk është i drejtë për shkaqet që vijojnë:

1) Pikë së pari gjuha shqipe nuk është gjuhë fjesht Iliriane, por themeli është thrako-iliriane e përzjerë me lëndë gjuhësore të kombeve që ndodheshin në këto vënde para se të vinë Ilirianët dhe Thrakasët;

2) Kësaj gjuhe i janë shtuar edhe fjalë të tjera të mara nga gjuhët e huaja me të cilat kombi shqiptar, historikisht dhe gjeografikisht ka qënë në kontakt. Kë-

to gjuhë janë: latinishtja letrare dhe vullgare, fjalë gotike, Greqishte, Sllavishte, Turqishte, me këto bashkë fjalë Persisht dhe Arabisht, ashtu edhe në kohëra të mesme fjalë italisht në dialekt venecjan;

3) Çdo gjuhë shekull pas shekulli zhvillohet dhe ndryshohet. Çdo gjuhë po të krahasohet me atë gjuhë që flitej e shkruhej dy-tre shekuj më parë, gjithmonë konstatohet një ndryshim midis dy periodave;

4) Fjalët iliriane që kanë formuar bazën e krahasimit me gjuhën e solme, kanë qënë të transkripuara o me shkronja latinishte ose greqishte dhe me qënë se këto dy alfabete — latin dhe grec — janë shumë të meta, ndaj alfabetit shqip, baza e krahasimit është shumë e metë.

Për këto arsye, pretendimi j shkrimtarëve se nuk jemi Thrako-Ilirianë është e gabuar, sidomos ardhja e Sllavëve në Shqipni dihet fare mirë; dhe gjuha e jonë me sllavishten është shumë larg. Kombet baltikë, si Lituanët nuk kanë ardhur në Shqipni.

Sa për Pellazgët, sjellë lhamë edhe më parë, këta janë një racë Zgjeane dhe që kanë lënë shënja të pakta vetëm në Toskëri e jugut dhe në brigjet e detit, posht Vjosës. Nga Vjosa e lartë nuk janë parë shenja asgjëkundi.

Përshkrimet e Vasso Pashës që i përkasin Maqedhonës, kanë nevojë për një koment, sëmbas kërkimeve të dijetarëve në kohëra të mbrame. Origjina e kombit Maqedhon është një nga problemet që ka formuar objekt studimi dhe kontestjimi.

Sëmbas gjeografëve dhe historianëve Grekë, Latinë dhe Bizantinë dhe, simbas krahasimit dhe kritikës së këtyre shkrimeve, me zbulimet arheollogjike dhe

me shkencën lengjistike, për popullin maqedhonas dhe për Maqedhonin e vjetër rezultojnë të vërtitat e poshtëshënuara:

1) Që maqedhonasit e vjetër nuk kanë qënë grekër;

2) Që grekërit e vjetër, maqedhonishten nuk e mernin vesh aspak, sepse ishte krejt një gjuhë tjetër.

3) Se zakonet e maqedhonasve si dhe sistemi shoqënor dhe politik me të cilin sundoheshin, ishte krejt i ndryshmë nga sjstemi i grekërve: maqedhonasit ishin bujq, kur se grekërit ishin treguëtarë, detarë dhe kolonizatorë.

Maqedhonasit kanë pasur sistemin feodal dhe pastaj monarshik që bashkonte gjithë popullin maqedhonas, kur se grekërit sundoheshin me qytete republikane, indipendent nga njëri tjetrj.

4) Grekërit e vjetër, në brigjet e detit të Maqedhonis së vjetër, kanë pasur ngrehur kolloniza greke të shpërndara aty këtu, si në gjithë brigjet e Mediterranes. Emrat gjeografike të këtyre kollonive ndryshojnë krejtësisht prej emrave gjeografjke të Maqedhonis së vjetër.

Ta-h të vinë në shpjegimin e fjaleve: Emathi edhe Maqedhoni, asht u dhe në origjinën e derës Mbretënore të Filipit e të Aleksandrit të math.

Gjeografët e vjetër quanin Emathia një krahinë të Maqedhonis e cila ndodhej ng'an' e perendimit të lumit që sot quhet Bistrice ose Inxhe Karasu edhe si mbas emrit të vjetër «Haljakmon», e kufizuar ng'an' e perëndimit me malet e Vodenës dhe me liqenin e Ostrovës. Emri Maqedhon, si mbas shkrimtarve të vjetër, ish emri i një populli j cili më parë banonte në

malet e Pindit e të Gramosit e që më pastaj kish zbritur në fushat e Maqedhonis. Esht e tepër ta themi se Kuco-Vllehtë që ndodhen sot në Pind e në Gramos at-here nuk' kishin ardhur akoma n'ato vise.

Nga studimet e sipërpërmendura meret vesh se në Maqedhonjn e vjetër ka pasur fise të ndryshme. N'anën e perëndimit kanë qenë Ilirjanët, ng'an' e veriut qenë Peonët dhe nga Shkupi e lart Dardhanët. Për këto dy fise shkrimtarët e vjetër nuk janë d'akor, disa thonë për Peonët se kanë qenë Pellazgë, disa të tjerë thonë se dhe këta kanë qënë Ilirianë; sa për Dardhanët, kur i ka pushtuar Roma i ka gjetur Ilirianë; por shkrimtarët e vjetër thonë se Ilirjanët kanë valur si pushtonjës edhe q'i kanë Ilirjanizuar vëndësit e vjetër: në një vënd të Maqedhonis që quhej Krestonie banonin Pellazgët. Në rjedhinën Maqidhone të vargut të malevе që quhen sot Rodop, banonin Agrianët. Ponukët e tashmë që ndodhen aktualisht në malet e Rodopit, akoma quhen Ahrian. Në mes të Maqidhonis; por ng'an' e lindjes të Vardarit, banonin Migdonët. Maqedhonia lindore banohej prej Thrakasve edhe qyteti Stagjir ku ka lindur filozof' i math i kohrave të vjetëra Aristoteli, ka qënë një qytet Thrakas edhe kështu gjuha amtare e Arjstotelit nuk' ka qënë Greqishtja; Këjo gjuhë, ka qenë gjuha kulturore e tij të cilën e kishte mësuar në Greqi.

Nga këjo meret vesh se Maqedhonia ka qënë e banuar prej fiseve të ndryshme ku fliteshin shum dialekte. Sa për derën Mbretënore të Filipit dhe t'Aleksandrit të math historianët grekë tregojnë dy burime. Sj mbas të thënave të këtyre një i quajtur Karanus është ngritur ng'Argoja dhe ka vajtur në Maqidhoni; mir po me emrin «Argo» ka pasur edhe një qytet në

Toskëri, për veç kësaj emri «Karan» nuk' ka fonetikun e një emertimi Grek, për kundrazi fjalët që fillojnë me (k. r. n.), figuropnë më tepër në gjuhët Thrako-Ilirian. Si mbas një legjende fjetër e përmëndur në historin' e vjetër maqidhone, shtërgjysh i Filipit me dy vëllezërit e tij kanë qënë në shërbim të një prenci Ilirian i cili kur i lirnë u fali një dhi dhe i porositi që të vendosenì ku të qëndrojë dhja. Ajo qendrojti afër Vodenës dhe prandaj të tre vëllazërit zanë vënd atje dhe këtij vëndi i thonë fush' e dhisë; me shkronja gërqishte kryeqytet i parë i Maqidhonës është shkruar «Edhise».

Tue u mbështet mbi këto arsye ka shumë propabilitet që dinastia e Mbretërís Maqidhone t'a ketë rënjën o në Gegëri ose në Toskëri. Dhe nuk dihet mirë se cili dialekt ka parazotnuar mbi djalektet e tjera, si gjuhë zyrtare në Maqidhoni. N'është se ka parazotruar gjuha e derës Mbretnore, këjo ngjan të jetë një dialekt Ilirian. Me gjith këtë kur në kohen e Filipit V-të, qeveria Maqidhone dërgoj në Shkodrë një delegasjon për t'u marrë vesh me qeverinë Ilirjane të Shkodrës, midis Maqidhonasve dhe Shkodraneve, përdorim i dy dialekteve nuk ka qënë e mjaftueshme për një marëveshje dhe prandaj kanë përdorur përkthyës nga një dialekt të tjetëri. Si do që të jetë gjuha e përdorur në Maqidhoni prej popullit nuk' ka qënë gërqishtia; por një gjuhë Thrako-Ilirisane e veçantë që ka pasur një afrim të ngushtë me dialektet që përdoreshin athere në Shqipri.

Esht e vërtetë se me emrin «Pel-lë» ose «Pel-lion» në Shqipri ka pasur qytete të cilat i përmënd historia; por që në një mënyrë të saktë pikërisht nuk dihet se ku kanë qënë. Midis luginës së Drinit dhe të Matje-

në një rafshinë ku ndahen ujërat dhe më tepër afër Lurjes, ndodhet një vend më rënimë të vjetëra ku i thonë hjeshka e Pelës; por nuk mund të themi me një saktësi historike se Pel-la që ka qënë një Kryeqytet i dytë i Maqidhonis, afër Jenixhes së Vardarit, e ka marë emrin prej Pelës që ndodhet në hjeshkat e Lurjes.

—o—

BKSH

KAPTINA E II.

Gjat kohës që shkon ndërmjet shekullve prallor dhe atij të Aleksandrit, nuk hasjm personalitete të mbëdha midis mbretërve të Epirit: këtu këtje shihen ca shenime të mbetura prej prallave të cilat nuk mund të konsiderohen si elemente të mjaftueshme për të sherbyer si bazë për një studim të posaçmë.

Hijet e mbëdha të Mbretërve t'Epjrit lilojnë të vizatoben vetëm në shekullin e IV-të, ku gjejmë një Aleksandër, Mbretin e Epirit, që kalon n'Itali, mund Samenitët dhe bashkohet me Romanët, kur Aleksandri i math ishte duke pushtuar Asinë. Këjo ngjarje historike meritom një vërejtje serjoze, duhet të formojë një objekt studimi të posaçmë, se pse provon q'Epiri jo vetëm që nuk formonte një pjesë të Greqis të cilën Aleksandri e kish zotnuar dhe q'Epiri nuk ishte as aljati politik i Maqidhonis dhe që nuk' kish marë as një pjesë në shkaqet që shtynin Maqedhonasit për të pushtuar Greqinë dhe Asinë: Por Epiri qendrojti plotësisht asnjanës dhe indiferent në këto lëvizje.

Në 376 para Krishtit, Epjri ju dorëzua Kasandrë, Mbretit të Maqidhonis, por pas tre vjeteve Epirotët ngrenë krye dhe e munden. Me gjith këto të këqia, në shekullin e tretë para Krishtit shohin të çlaget një personalitete i math Epjrot, Piroja, i cili para se të kalojë n'Itali, u hapi luftë Maqedhonasve, ashtu dhe

«Grekerve që ndodheshin kufitarë me të; në këtë rast ushtarët e Piros, të habitur nga shpejtësia e lëvizjeve ushtarake të tij, i thanë se, ja kishte kaluar dhe shqiponjës. Pjroja ju përgjigj duke thënë se ishte e vërtetë, por q'ishin ushtat e tyre q'i kishin sherbyer si krahë për të xhvilluar një fluturim të tillë.

Plutarku, që në jetën e Piros, tregon këtë rethanë karakteristike, kurrë s'ka ditur edhe as që ka dyshuar se Epirotët dhe gjith ata q'i thonë vehtëhes Shqiptar, emnimin gjenerik Shqiptar ja detyrojnë pikërisht kësaj ngjarjeje.

Plutarku që nuk dinte gjuhën Pellazgjike, e cila konsiderohej si një gjuhë barbare që nga kohët e Herodotit, edhe q'Epirë me popullësit e tij nuk e kish parë për së afërmi, nuk mund të shpjegonte këtë ngjarje që po e parashtrojmë në çnimin e fjollogeve dhe të dijetareve.

Fjala «aetos» që përdor Plutarku në gjuhen arbënore thuhet Shqipe, Shqipri ose Shqipni, d. m. th.: «Vend' i Shqipes» edhe Shqyptar d. m. th. «Bjr' i Shqiponjës».

Ky fakt historik që ka ikur nga çnim' i historianeve të vjetër ashtu dhe fjollogeve dhe dijetareve të rinj, meriton një hetjm seriozë, se pse formon një provë të pa rëzueshme për ata si na, që pretendojnë se Epirrotët ishin një popull i veçantë dhe i dallusar prej Elineve, dhe që gjithmonë kanë pasur gjuhen e tyre gjuhen e Pellazgeve të vjetër të cilën Grkërit nuk e dinin aspak dhe që pa dyshim është ajo gjuhë që flitet dhe sot, n'Epir, në Maqidhoni, në Ilirí dhe në disa rethujza t'Arshipelit, ashtu dhe në malet e Atikës, po ajo gjuhë është që quhet gjuha shqipe.

Pēr t'i dhēnē filologjis njē mjet çmjīni mē tē sigurtē pēr rēndēsinē e thēnjeve t'ona, do tē tregojmē se emrat Epir, Maqidhoni dhe Albani janē plotēsisht tē pa njohura prej shqiptarēve; se kēto fjalē nuk ndodhen nē gjuhēn e tyre: ata nē mes tē tyre nuk njihen veç se me emrin gjenerik shqiptar dhe as nuk e vēnē nē dyshjm qē nē vendin e tyre tē ketē njē emertim tietēr jashta atij q'ata pērgjithēsisht dinē: Shqipri ose Shqipni.

Emertimet Epir dhe Maqidhoni vinē prej burimesh tē huaja, Greke dhe fjala Albani ēsht e re dhe janē vetēm Evropjanēt tē cilēt qē nga shekulli XIV ose XV vendit tē shqiptareve i kanē dhēnē kētē emēr. Por shqiptarēt vetē nuk dinē se ç'ēsht Epiri, Maqidhonia dhe Albania; pēr ata kēto emra janē plotēsisht tē pa njohura dhe qē nē gjuhēn e tyre nuk' kanē ndo-njē kuptim. Gjjth ashtu duke filluar prej fjalēs Skutari d'Albani, duke perfshirē krahinat e Ipekut, tē Prishtinēs, tē Vranjes, tē Kaçanikut, tē Usqupit, tē Perlepit, tē Manastirit, tē Follorinēs, tē Grebenes, tē Kallaritēs, tē Janinēs gjer te gjjri i Prevezēs, gjith ky vend qē pērfshihet midis pikave gjeografike dhe detit, njihet pēr Shqipri, njē vent q'i pērket fisit shqjptar edhe qē s'kanē as gjē tē pērbashkēt me Greqinē.

Si kur tē qēndrojmē njē katundar qē hasim edhe t'a pyesim se ç'je? do tē pērgjigjet shkurtimisht: Jam Shqyptar. Kējo pērgjigje epet pa ndryshim prej atyre tē Shqjpris sē sipērme si dhe tē Shqipris sē poshtēme qofshin musliman, katoliq ose ortodoks. Atyre, kur u bēhet fjalē me emrat Epir ose Albani, kujtojnē se u flitet Çinezçe ose u thuhet ndonjē sharje nē gjuhē tē huaj dhe mund t'a quajnē vehtēhen tē poshtēruar.

Shënime mbi kaptinën II.

Ngjarja e Piros me ushtarët e tij, për sa i përket fjalës Shqipe ose Shqiponjë me të vërtet përmëndet në jetëshkrimin e Piros, shkruar e botuar prej Plutarkut në librin e tij të famëshmë që mban titullin: «Jeta e njerzëve të famëshmë».

Vasa Pasha kur bën fjalë për gjuhën që flitetj në kohen e Piros thotë se gjuha që flitnin Epirotët ishte gjuhë Pelazgjike, ksr se pas mendimit t'onë, gjuha që flitej athere ishte gjuha shqipe Thrako-Iliriane, me ndryshimet e kohës. Fjala Shqiptar mund t'a ketë burimin, si ç'thotë auktori, në fjalimin e Piros me ushtarët e vetë; por përgjithësimi i përdorimit të kësaj fjalë është shumë më vonë nga koh' e Piros dhe prova e ksaj është se Shqiptarët e Greqis dhe t'Italis fjalën Shqiptar nuk e dinin as pak; këjo fjalë për ata është krejt e re; ata vehtes fyre i thonë Arbër ose Arbëresh. Duket se kombi jonë si emër të përgjithshëm ka pasur fjalën Arbër, Arbëres ose shkurtimisht Arbëresh. Ky emertim përfshinte gjith fiset e kombit t'onë edhe: përdorej si një shenjë dallimi nga kombet e huaj të cilët emërtoheshin me fjalën, Shqah ose Shklah dhe fjala arbër kaq duket e vjetër, sa që kombi jonë ndodhej për brinjë me Skithët e vjetër; s'ka dyshim se fjala shqah ka rjedhur nga denotyrim' i fjalës «Skith» në një kohë kur Thrako-Ilirët kishin pushtuar gjith sirethujëzën Ballkanike edhe ndodheshin kufitar me Skithërit.

Midis auktoreve të huaj fjala Shqiptar pikë së pari është përdor në shkrimet e Ptolemé Bizanntinit. Fjalët Arbër dhe Shqah u përgjigjen fjaleve që përdornin

Grekërit: Elin dhe barbar. Grekërët e vjetër thoshin: Kush do që nuk është Elin' është barbar, d. m. th.: huaj dhe i pa qytetëruar; ashtu dhe Shqiptarët njerzve të tyre u thoshin arber nga ç'do fis që të ishte dhe ç'do të huaji që nuk ishte nga gjuha e nga gjaku i tyre i thoshnin Shqah ose Shkalah.

Fjala Shqah mund të jetë ma e vonëshme edhe e marë nga dialekti Venecian: Sqavo, të cilën e përdorain edhe për Sllovenët që kanë ardhur në brigjet e Adriatikut në shekullin VII.

Sa për Epirin, këto fjalë, me të vërtet Shqiptarët në mes të tyre s'i kanë përdorur dhe pjesa e jugës së Toskërisë ka qënë e banuar prej Molloseve, prej Thesproteve dhe prej Kaoneve, popuj të vjetër të bashkuar me Ilirianë. Thesprotët janë Çamërit e sotmë, Kaonët, Laberit dhe Mollosët ishin një popull që banonin Mollosinë, d. m. th. qarkun e tashmë të Janinës. Kurdoherë që gjeografët dhe historianët e vjetër të Greqis bëjnë fjalë për të tre fiset që thamë më sipër, kanë përdorur këto fjalë: «Varvari që avasiloftio d. m. th. që popuj jo Elinë edhe pa qeveri. Vetem shohim se pranë Mbreterve të Molloseve kanë ardhur Grekër, a kanë mësuar leksat, artet dhe zakonet Greke, si pas mendimit të tyre, i kanë qytetëruar.

Z. Karapano nga Narta, dhendër' j Kristaq Zografoe, ka bërë kërkime arheologjike në malet e Kurendës në perendim të Janinës, ku ka zbuluar tempullin e vjetër të Dodonës edhe kryeqytetin e Molloseve. Veprat e zbuluara janë shkrime të vjetëra Gërqishte, monedha të Mbretërve të Molloseve dhe shtatuje të bukura të shekullit V e IV para Krishtit. Po të marim para sysh poziten gjeografike të këtyre maleve afër Sulit edhe që rjedhina perëndimore e tyne që ndodhet kundrejt

detit Jon dhe fillesës së detit Adriatik, këto vende formojnë malësin' e Çamëris e cila krijon lugjinën e bregut të detit. Kur ishte Suli mbë kembë, Çamërit, Suliotët i përmëndnin nen titullin malësor edhe vendin e tyre e quanin malësi. Këto rethana na shtyjnë me të drejtë që fjalën Mollosi e përmëndur në veprat gjeografike dhe historike të vjetëra, t'a shpjegojmë me fjalën e vërtetë shqipe malësi. Është e vërtetë se në këtë pjesën e Epërit Shqiptarizma edhe Elenizma kontestojnë njëra jetrën dhe si mbas mendimit t'onë këjo pjes' e jugut nga pikpamja ethnografike ka qenë Shqiptare; por nga pikpamja kulturore dhe qytetërore është Greqizuar.

Mbreti Aleksandrë që përmëndet në këtë kapitull është një nga Mbretrit e Mollosis që ka shkuar n'Itali, i thirrur nga Grekërit që kishin formuar kolonira të mbëdha në Italinë jugore dhe në Sikhilje. Këta princër të Shqipris jugore shkonin përtej detit si mercenerë për të ndihmuar një nga të dy palët në luftë.

Sa për marëdhënjet midis Epiroteve dhe Maqidhonasve, në pikpamje ethnike kanë qënë t'afërt me njeri tjetrin, bile e ëma e Aleksandrit të math, Olimpia, ka qënë prej dërës Mbretnore të Mollosis. Epirotët nuk' kanë marë pjesë në ngjarjet politike të Greqis së vjetër.

KAPTINA III.

Ç'kemi thënë për Epirotët, besojmë se mund t'a thëmi edhe për Maqidhonasit e vjetër. Historikisht është e provuar se dhe ky popull, si Epirotët ka pasur gjuhën e vetë, të ndryshme nga gjith dialektet e gjuhës Gërqishte; Maqedhonasit kanë pasur një formë qeverie e cila largohej plotë-isht prej asaj së Greqis, ka pasur ligjet e veta, zakonet, dokat dhe organizaten ushtaruke të saj e cila nuk' kish as gjë të përbashkët me atë të Eladhës.

Për të provuar g'ko themi, nuk kemi veç se të kshillojmë historinë. Pikë së pari është Plutarka i cili duke treguar vrasjen e Klitus-it ng'an e Aleksandrit të math q'ishte miku i tij thotë se: «Aleksandri, duke qënë i dehur me verë dhe me duf (inat), u hodh jashtë çadëres dhe thiri rojen dhe seizët e tij në gjuhen Maqidhonishte.»

Pra, siç e pohojmë gjith historianët, gjuha Maqidhone ishte e ndryshme nga gjith dialektet që fliteshin në Greqi; nga këjo del se, Aleksandri për t'a folur njerzve të tij nuk mund të përdorte gjuhën Greqishte, se pse Maqedhonasit nuk mund t'a kuptonin duke mos ditur atë gjuhë. Prandaj gjuha që dinin e flisnin ushtarët e Filipit e t'Aleksandrit, nuk mund t'ish tjetër gjë veç se gjuha e Pellazgeve të vjetër, po ajo gjuhë që flitej n'Epir, ajo që shqiponjës i thotë Shqipe dhe që flitet edhe sot ku do në Shqipëri.

Në shumë shkrime të vjetëra thuhet se Eolët që kultivojnë me Epirë flitnin një gjuhë të përzier, gjysmës Gërqisht, gjysmës Pellazgjisht të cilën Grekërit e cilësonin si barbare.

Është nga shkaku i pozitës topografis së tyre që flisnin këtë gjuhë të përzier, se pse, me nj'anë hasnin me Greqinë dhe n'anë tjetër me Epirin.

Këto hollësina të kallëzuara prej kaqë historianeve, shtojnë një provë se gjuha e Epirotëve ishte gjuh' e Pellazgëve edhe q'ishte, siç u tha ma sipër, krejt e ndryshme nga dialektet e Greqis.

Gjuha Greke është e njohur vetëm prej shoqëris së naltë e cila studjohesh siç studjohet edhe sot në disa vende të Shqipris dhe është e mundëshme që n'oborin e Filipit e të Pirosit, Kurtizanët, gjeneralët edhe burot e Shtetit fjaloseshin edhe shkruanin Gërqisht, kultivonin shkronjat dhe letresinë Greke. Për veç kësaj, letrat Greke nësoheshin vetem n'Epir e në Maqidhoni, gjuha e Elinevë është përhapur n'Asi, n'Afrikë ashtu dhe në Romë e n'Itali, se pse ajo ishte gjuha më e përparuar edhe më e allë, n'ato kohë, për t'i vënë në mardhënje popujt e ndryshmë që kanë pasur më mes të tyre mardhënje tregëtare ose politike. Aso kohet Gërqishtia studjohej qysh studjohet sot frëngjishtia e cila është bërë një gjuhë e përbotëshme.

As njeri nuk mund të mohojë që Elinët të mos kenë arritur me përparimin e qytetërimit të tyre shkallën më të lartë të glorjes dhe që o me gjuhen e tyre q'ish bërë gjuha letrare e gjith botës, ose me artet, me tregëtinë dhe me industrin e tyre të mos kenë fituar vendin e parë në mes të popujve të vjetër, por nuk besojmë se gjith ata që flisnin Gërqishten të kenë qënë Grekër edhe të kenë qënë nga familia Elenike.

Ç'ka u lha më parë provon mialtësisht se Epirotët dhe Maqidhonasit ishin dy popuj origjina e të cilevet nuand të rilhle fare mirë ng'ay burim që kanë rjedhur edhe Eolët dhe Jonët; por që nga fillimi i dukjes së tyne në store kishin mbetur larg Grekërve dhe kishin formuar një shoqëri të veçantë, një nacionalitet të dallusr dhe as pak i një llojeshëm me atë të Elinevet; ata kanë pasur një qënje të veçantë edhe kurrë s'kanë pasur çështje të përbashkëta as kanë simpathizuar, me mendimet dhe me prierimet politike të Gregis.

E vetmja gjë që kishin të përbashkët me Elinët mbase kanë qënë Perëndité Pagane. Por dhe këto Perëndi, për një pjesë të madhe janë sjellë prej pellazgve të vjetër dhe që Grekërit nuk në fund kanë qënë të shtërnguar të marin fen' e tyre.

Ky fakt që provon mialtësisht historia forcohet dhe me emrat e atyre Perëndive që kanë një kuptim të qartë dhe t'arsyeshmë në gjuhen shqipe siç do t'a provojmë.

KAPTINA IV.

Pellazgët të cilët kanë qënë të parët q'i janë avitur steres Greke, kishin sjell me vehte kuptimet dhe kultin e një besimi krejt primitif. Historianët e vjetër, i par' i tyre Herodoti, thotë se Pellazgët, Perëndive të tyre u bënin fli nga gjith flojet, por që nuk' kishin zakon t'u apin emra të posaçme; nuk kishin Perendira të lëndëta, vepr' të dorës së njerëzit; adhuronin natyrën në çfaqjet e saja mirëbërëse. Edhe theogonit e tyre që më në fund u adoptua dhe mbase u prefeksionua prej Grekërve, nuk isht tjetër gjë veç se produkt' i vërejtjeve mbi lëvizjet fizike të natyrës, mbi vijimin e kohës dhe mbi marrëdhënjet e elementave; me një fjalë, nuk ish gjë send' tjetër veç se një varg përfundime të logjikshëme, ose ma mir me thanë, spjegimi krejt primitif i sistemit të botës, rezultatet e para të penimit të mendjes së njerizit në fushën e filozofis.

Haos q'ësht të zbrazëtit, i pa formë, Çqyësi, rjedh nga fjalët Pellazgjike: ha dhe has, kaos, ngrënës, çqyës, ose nga fjalët hap, hapëri, haepsi, e hapët, e zbrazët. Këto fjalë edhe sot kanë po ato kuptime në gjuhen Shqipe.

Nga haos ka lindur Erëbe. Këjo fjalë ka për rënjë: érh, érhem, érhemi ose érhesi, e errët. Në shqipe u err, errët, errëni, vend, i errët: érëbe ësht selia e errësirave të përjetëshme.

Gea, d. m. th. dheu. Dorinjtë shkronjën «p» e kthenin në «d»-edhe e shqiptonin: dha. Në shqipe toka thuhet dhé.

Uranos, këjo fjalë me dy gama flitet Oranos. Pra, vran, vrant, i vranët në shqipe do të thotë, i vrenjtë Po ti shtojmë fjalës vranë prapështimin grek (os), do të kemi fjalën, vranos ose oranos. Esht emri me të cilën Pellazgët dhe të paslindurit e tyre direkt, shqiptarët, shenojnë qiellin si seli e revet: me re. Bashkimi Géa me Uranos, d. m. th. bashkim' i tokës me qiell, ka produktuar Rhéa me Chronos. Rea në shqipe do të thotë re.

Chronos, rjedh nga fjala shqipe, kohe. Në disa qarqe të Shqipnis (k)-a ndronet në «r» dhe në vend që të thuhet (kohë) flitet «roh». Kohn, e Rohn don me thënë koha, shtojni kësaj papështimin grek «os» edhe kini pikërisht rohnos.

Nga Rhéa ka lindur Zevs, (Jupiter, Zaa, Zec, në shqipe d. m. th. Zë. Prandaj, Rhéa, d. m. th. rea, nuk mund të pillte veç se me një kërcëllimëe cila jepte një Zç: d. m. th. Rufea dhe bubullima, pikërisht Zaa, Zee e Pellazgëve. E dimë se Jupiteri oraklet e tij në Dodonë i çfaqte me një zë i cili ishte Perëndia e Pellazgëve. Në Shqipëri ka krahina ku edhe sot thonë: Zëe' lirona sot nga e keqia. Këto fjalë Zaa, Zee, më vonë u ndruan në Zaan, Zaan e Zoot të cilat sot kanë kuptimin e Perëndis dhe populli ben be për Zonë, për Zotin.

Zevsi bashkohet me Métis, inteligjenca, mendimi Siç dihet (ment) në shqipe ka kuptimin inteligjencë. Grekërit prej kësaj fjale kanë hequr (n)-në dhe duke i shtuar prapështimin «is» ka bërë fjalën, Metis. Pra me këtë bashkim Zevsi ose Jupiteri ka pjellë Athina-

në, Minervën; por këjo pjellje bëhet në kokën e Jupiterit, në selin' e inteligjencës dhe produkton Athinanë.

Grekërët që nuk' kishinj' ruajtur as një kujtim të gjuhës Pellazgjike kurrë s'kanë mundur t'i japin një kuptim t'arsyeshëm fjalës Athina; janë kufizuar me ipotezn të fjeshta. Përkundrazi, gjuha shqipe na ep një shpjegim tepër të qartë e t'arsyeshëm. Thanë edhe thënë, në gjuhen Shqipe kanë kuptimin: E thana, dhe e thëna, këjo ka kuptimin e thenjës edhe të verbit. «Ftillk». Ksisoj Athinä vjen me thënë fjal' e Perendis, këjo fjalë të cilën e gjejmë në gjith fet e vjetëra e të ra, është e Perendis Pellazgevet që procedon me Zefsin, fuqinë, pushtetin edhe me inteligjencën.

Héra, Junoni i Grekëvet, është (era) në shqip... Némës, në shqipe është «nëmë» që ka kuptimin mallkim, një gjë që sjell të keqen, që sjell mundim dhe që shkakton fatkeqësira. Na besojmë se cilësit e Némes përfshihen në kuptimini e fjalës shqipe «Nëmë».

Erinnes këjo fjalë rjedh nga fjala erh, erhni, t'errët, sferrë dhe rënim.

Muse. Në shqipe: Mësoj, mësonjës d. m. th. ajy që mëson, q'inspiron diturinë, shkencën. Këto janë cilësit e «Muse»-avet d. m. th. e mësonjavet, e shpirtësonjësavet.

Thetis, është e ditur se Thetis është një shpirtësim detar. Në shqipe «deti» është det.

Aphrodites, Vénus. Venusi Perëndesha e dashuris, e bukuris, ashtu dhe yll' i mëngjesit. Aferdítë në shqipe d. m. th. afër ditës ose yll' i mëngjesit është perëndi i dashurisë.

Delos, një rethujëz e dedikuar diellit. Fjalës diell

në shqipe, duke i shtuar prapështimin grek «os» bëhet fjala «dielios». Latoni pjell Dinnën. Hán e Hana është ëmri shqip i hanës, edhe Diana është simhol i s'aj.

Sélène. Lene, me gjuhen shqipe d. m. th. të lindur, lindje. Thamë se Zaa. Zee është Perendia; Pra Zaa, ose Zee, Sélène është Perendia ose Perendesh e lindjes. E dimë se Selini kryesonte lindjet.

Qëndrojmë këtu për të mos lodhur vëmëndjen e këndonjësit, duke qënë të bindur se këto shëmbëlla janë më se të mjaftueshme për të forcuar të thënat t'ona dhe për të vendosur definitivisht të drejtën e vjetërsis, të kombsis dhe të gjuhës shqipe mbi gjith gjuhët dhe kombsit e fjera të njohura n'Evropë.

Si do qoftë lavdërohemi për se u kemi hapur një fushë të re dijetarëve dhe filologëve për t'i vënë në gjëndje që të japin xhvillimet e duhura tezës që kemi filluar.

Komentime mbi kaqtinën III. dhe IV.

Në kaptinën III auktori vazhdon të trajtojë çeshtjen e gjuhës që flisnin Maqidonasit dhe Epirotët: dhe si provë fregon vrasjen e Klitos i cili ka qënë nga besnikët më të fortë t'Aleksandrit të math edhe në disa rethana të rezikshëme i kishte shpëtuar dhe jetën. Aleksandri si shkoj n'Asi filloj të pinte dhe në dehje e sipër bënte sende të pa pëlqyera. Nji nga këto fajet më të mbëdha që ka bërë duke qënë i dehur është dhe vrasja e Klitos. Në këtë rast, në duf e sipër, ka folur jo Gërqisht por në gjuhën Maqedhone. Në gjith rastet që çfaqej nevoja t'u fliste ushtarëve

të tij, u fliste me këtë gjuhë. Për veç kësaj e ëm' e Filipit ka qënë Iliriane, e bijë e një princit që qubej Iras. Prandaj Filipi për veç dialektit Maqidhonas dinte dhe dialektin Ilirisht q'e kish mësuar nga e ëma. Gjith ashtu edhe e ëm' e Aleksandrit, Olimpia, ishte prej malësis së Janinës që ndodhet afër Çamëris. Përveç kësaj profesor' i universitetit të Berlinit Z. Ulrich Wilcken thotë se Filipi me qënë se donte një grua tjetër dhe Olimpin dyshonte se mos Filipi e linte krejt me nj'anë, dhe trashigimin e fronit të Maqidhonis mund t'ia linte nonjë mashkulli prej harkut tjetër, u zemërua keq me Filipin dhe prandaj shkoj në derën e atit të s'aj me Aleksandrin bashkë dhe me këtë pretekst Aleksandri kur ish i vogël ka ndejtur në Ilirì, kshtu që me do-e-mos do të këtë mësuar dhe ajy, si i ati, dialektin Ilirian, Pra siç thamë në konsentimin e kaptinës tjetër dialekti Maqidhonas që fliste vullgu ka qënë një dialekt Thrako-Ilirian si Gegënishtin me Toskënishten, një dialekt i tretë që me ardhjen e Sllavëve në Maqidhoni, ka humbur. Në kohën e Filipit e t'Aleksandrit të math gjuha Gërqishte ishte vetëm gjuhë kulture dhe gjuhë zyrtare: por ky fenomen nuk' ka qënë vetëm në Maqedhoni, ka ndodhur dhe në vende ku Grekët s'kishin të bënin as pak. Bijë fjala legjendat e monedhave të mbretërve Ilirianë të Shkodrës janë shkruar në gjuhën gërqishte. Në kohën e mesme, gjith Evropa mbarë përdorte, si gjuhë kulture, zyrtare dhe fetare, Latinishten.

Prandaj përdorim' i gjuhës gërqishte në Maqidhoni, n'atë kohë, nuk formon një provë se Maqidhonasit kanë qënë grekër. Esht e vërtetë se Filipi me Aleksandrin, për të qytetëruar kombin dhe Mbretërin e

tyrë, si mbretër përparimtarë të çquar, kanë bërë ç'ka qënë e mundur për të futur qytetrimin grek në Maqidhoni; por ky qytetrim, i huaj për Maqidhonasit, ishte për cipë, nuk kishte rënjë në ndjenjat dhe në zakonet e popullit, ishte një gjë si kultura frënge në kohën e Frederikut të math në Prusjë. Prandaj nuk mund të pretendohet se Prusjanët e Frederikut të math ishin frengjër.

Disa auktorë duke vërejtur emrat e Maqidhonasve Zyrtarë, që janë Grekë, këtë gjë e konsiderojnë si një provë për Eelenizmën e Maqidhonasve; por dhe ky pretendim nuk mund të qëndrojë në këmbë; se pse emrat e njerzëve të çquar, më të shumtat herë, janë emra që vinë nga gjuha kulturore ose fëlare e adoptuar prej ati kombi: Bije fjala sot në Shqipri, për shkak të fevc dhe të gjuhërave kulturore të më parëshme, emrat e njerëzve aktualisht janë emra Arabe, Latine dhe Greke; por këja nuk provon se shqiptarët janë Latinë, Grekër ose Arabë.

Vasa Pasha, në kaptinën e trelë që po komentojmë përpiqet të tregojë se Maqedhonasit e vjetër si dhe Shqiptarët: Ilirinj dhe Epirotë, janë Pellazgët e vjetër dhe që s'janë Grekër edhe që gjuha e tyre nuk është gjëndi tjetër veç se Pellazgishtia; kur se si mbas kërkimeve archeologjike, studimeve gjuhësore dhe ethnografike më të vonëshme, merret vesh se Pellazgët kanë qënë vetëm në një pjesë të Maqedhonisë që quhej Krestoni. Si ç'e shpjeguam dhe më parë, kombi Maqedhonas përbëhej prej shumë fisesh të ndryshme; por që parazotnonte pjesa Thrako-Ilirisanë. Kështu që si mbas mendimit t'onë argument' i parë i auktorit me të cilin don të provojë se Maqedhonasit nuk' kanë qënë Grekër, është i vërtetë edhe në këtë pi-

kë jemi d'akord; por sa për pikën e dytë q'u takon Pellazgeve largohemi tepër.

Auktori në kapitullin e IV, theorin' e Pellazgëve do t'a provojë me një krahasim të besimit vjetër Elenik, duke thënë se shum kuptime fetare të Elinëve janë kuptime Pellazgjike dhe që fjalët kanë rënjën e gjuhës Pellazgjike dhe këjo rënjë, me disa ndryshime, shpjegohet me fjalë shqipe të sotme. Mendimi kryesor i Pellazgëve që ka adoptuar auktori, vazhdon edhe në këtë fushë; mir po studimet e më vonëshme kanë hapur një horizont tjetër edhe në pikpamjen fetare; prandaj e shohim të nevojshme që të japim një mendim të përmbledhur edhe të kulluar mbi besimet e vjetra të Grekëvet duke treguar për sa është e mundur se këto besime ku e kanë burimin edhe ç'far lidhje kanë pasur në fillim me besimet e popujve të tjerë.

Si mbas përfundimeve të shkencës së re, Greqia e vjetër nuk fillon më, me grekërit. Që prej triddjet vjet e këtu është konstatuar se përpara Grekërve, si ç'e thamë më sipër, është zhvilluar një qytetrim m'i vjetër se ajy i Grekërve dhe më qënë se ky qytetrim kaq i vjetër ka pasur për fush veprimi brigjet e detit dhe rethajzat e Greqis u quajt qytetrimi Egjean, dhe me qënë se qendra e këti qytetrimi ka qënë në Gjirit, u quajt dhe qytetërimi Gjiritas. Për veç kësaj po ajy qytetrim i vjetër, me qënë se u zhvillua edhe në qytetin që quhesh Miqenë, i cili ndodhet në Greqinë toksore, ka marë dhe emrin: «qytetrimi Giirito-Miqenas». Ky qytetrim, si mbas të thënave të shkencëtarëve, fillon tre mijë vjet pas periudhës Neolithike edhe gjen fund, për në Gjirit 1400 vjet, edhe në tokën Greke 1200 vjet para Krishtit. Pas kësaj llogarie si fillnan të vinë në Greqin' e vjetër Ahainjtë, Dorinjtë, Jonët edhe Eolët

të cilët duke u përzier me elemente para Elenike formuan kombin Grek: qytetrimi Egjean vazhdoji edhe 200 vjet të tjera. Me këtë mënyrë qytetrimi i vjetër Grek, në kohë t'errëta lidhet me qytetrimin Egjean.

Nga këto shpjegime meret vesh se besimet e vjetëra të Greqis klasike dishka kanë marë nga besimet që përmbante qytetrimi Egjean. Besimet e Grekërve të vjetër, po të shoshiten dhe të krahasohen me besimet e popujve të vjetër, shihet se edhe popujt e vjetër t'Asis vogël si Lidasit, Karianët, Hititët, Finikasit dhe Egjyptasit kanë kontribuar në formimin e besimeve Greke.

Midis këtyre elementave shohim se besimet e Thrakasve kanë lojtur një rol mjaft të rëndësieshmë në formimin e besimeve Greke. Thuqidhidhi thotë se Thrakasit janë dy pjesë: Njëra pjesë është Elenizuar dhe tjetëra ka mbetur barbar.

Kjo pjesë e Elenizuar e Thrakasve duket çiltas në besimet e Elefsis dhe të Delfit. Duke u mbështetur mbi këto shpjegime shkencore, në vend që të pranojmë, si auktori, marëdhënje fetare Pellazgjike të njësuara me besime shqiptare të sotme, është në e arsyeshme që besimet e vjetëra shqiptare, pjesërisht, t'i kërkojmë në besimet e Thrakasve.

Me qënë se edhe kaptina «V» e veprës origjinale vazhdon të bëjë fjalë mbi besimet e shqiptarve në marëdhënje me besimet e vjetëra Greke, të marruna prej Pellazgëve, e shohim më t'arsyeshëm që të vazhdojmë në perkthimin e kësaj kaptine dhe pastaj të vinë në komentimet t'ona.

KAPTINA E V.

Pamvarësisht nga kaq praktika fetare të tjera q'i përkasin kultit vjetër të Pellazgëve të cilat as Krishti as Muhamedi nuk' kanë mundur t'i çdukin plotësisht nga shpirt' i popullit shqiptar, ësht dhe bea mbi gurin që vazhdon akoma në gjith malet e Shqipris; këjo be ësht e rethuar po me atë nderim dhe me atë solemnitet që kishte në kohërat e vjetëra më të lashta.

Gjith historishkronjësit bejnë fjalë për këtë dhe J. J. Amprere, në historin «Romane në Romë» të tij tregon ngjarjen vijuëse me shum detaje. Sylla përpara se të linte Romën për të shkuar të lëftonte «Mithridate»-in kërkoj na Cinna, kryetar' i partis Marius, një be me të cilën t'angazhohej solemnisht se nuk do të bënte as një pertënim «innovation» në Romë gjat mungesës së tij. Sylla nuk donte që Cinna këtë be t'a bënte për Perëndit Romake, por mbi gurin e Shënjtë, dhe si mbas një zakoni të vjetër të Etruskëve të cilët këtë be e kishin marë prej Pellazgëve, Cinna këtë be e bëri, pikë së pari duke vënë gurë mbi supat e tij dhe pastaj duke hedhur nga pas me mallkime që foli me zë të lartë kundra vetvehtes në qoftë se do t'i shmangej zotimeve të tia.

Në raste të mbëdha dhe kur bëhet fjalë për të dhënë një sentencë me rëndësi të madhe, pleqt' e fiseve të Shqipris, musliman' e të krishterë pa dallim, thritea

prej paleve ndërgjyqëse për të bërë benë e gurit, para se të japin vendim mbi çeshtjet që do të gjykojnë.

Ky betim bëhet shum herë, bile edhe në ditët t'ona, si në Gegëri asht u dhe në Toskëri: Bea ësht e rethosur po me ato formalitete edhe me atë aparat, dhe pasohet po me ato mallkime që pershkruhen prej historianëve të vjetër. Edhe na, jemi ndodhur në malet e Shqipris në një betim të tillë, me rastin e një grindjeje q'ishte çpikur midis dy bajrakeve për su i përkisht kufivet të tokave respektive të tyre. Në këtë rast pleqt' e dy fiseve fqinj të zgjedhur prej paleve ishin thirur për të gjykuar çështjen e të drejtës, pas si bëne ben' e gurit. Gjyqtarët ishin të përzier të krishterë e Muhamedanë.

Malsorët e Epirit, të Maqedhonis edhe të Iliris, d. m. th. banorët që janë prej familjes Pelazgjike ose shqiptare, kanë zakon të betohen akoma edhe sot mbi gur, si gjith të tjerët që betohen për Perëndi, për Krisht ose për mbi nder. Gjith ashtu kur fjalosen në mes të tyre, banorët e Shqipnis sipërme, duke marë në duart e tyre ose duke treguar gur' e parë q'u çfaqet përpara, thonë: për këtë pesbë dhe atu të Shqipris jugore ose të Epirit shprehen kësi lloj: Për të randë të këtij guri.

Na nuk dinim se ky zakon edhe ky betim të këtë lyrë ndonjë herë në praktikën fetare të Greqis: së paku na nuk gjejmë traga që të mundij të na i provojë. Ësht një zakon fjesht primitif të cilin vetem të paslindurit e Pellazgeve e kanë sjellë dhe e kanë ruajtur në për shtegtimet e tyre, në vende ku janë vendosur.

Pelazgët që nuk shkelqenin n'artet e bukura dhe që nuk' kishin një dituri relativisht miaft të përpa-

ruar, adhuronin natyrën në ngjarjet e dukshme, në thjeshtësin e s'aj mirëbërëse: Perëndit e tyre ishin dheu, qielli, fusha, mali, ujët, zjari, guri, dielli, hëna dhe yjtë. Populli shqiptar si ç'ësht edhe sot dhe posaçërisht gjindt' e maleve randësisht betohen për dhé e për qiell, për zjar e për ujë, për mal e për fushë, për diell e për hënë, në vend që të betohen për Perëndi e për shenjtërit. Këto forma betimesh që ngjiten në vjetërsinë më të lashtë, kanë mbetur të pa cenuëshme në besimin prej ku dalin dhe në shprehimet e tyre. Shqiptarët, duke qënë se kanë mbetur të qëndruëshme edhe me gjith që kanë kaluar 40 shekuj mbi kryet e tyre, nuk kanë adoptuar as fjalë të tjera për të treguar sendet e shënjta, as mendime të tjera për të përfytyruar Perënditë.

Gjuha, zakonet, besimet e zëmrës, me një fjalë, gjith këto, kanë mbetur Pellazgjike që nga një kënd i Shqipris deri te tjetëri, pa u ndryshuar prej qytetërimit, pa u transformuar me kalimin e shekujve dhe me veshtyrësit njerzore.

Këjo, me të vërtetë formon një ngjarje të çuditëshem: Me ç'mënyrë këjo gjuh' e vjetër, bile më e vjetëra e gjith gjuheve të njohura n'Evropë dhe e folur vetem prej një popullësie prej dy milion frymësh, mundi të mbahet ashtu si ç'ka qënë në orgjinën e vetë, pa pasur një letrësi të përparuar, as një qytetrim të shënuëshëm? Gjuha e tij, si dhe ata q'e flasin, ka rezistruar kundra ç'do gjëje, dhe shqiptari ka mbetur Pellazg ku do që ësht vëndosur. Këjo ngjarj' e pa shpjeguëshme çfaqet jo vetem në Epir, në Maqedhoni dhe n'Iliri, d. m. th. në gjith këtë zonë që quhet Shqipri, ku popullësia ësht e përmbledhur, njëgjëndëse dhe e shumë, por edhe në shum rethujëza të

Kryepellgut «Archipelo», në malet e Atikës, në Kolonit shqiptare të Italis e të Dalmacjes, më në fund ku do që populli shqiptar ka vëndosur ndënjën e tij, qoftë në kohëra të vjetra, qoftë në kohën e shtegtimeve të reа. Sa do që ka përqafuar le të tjera edhe q'ësht pranuar në shoqrit e hrëndëshme të popujve të tjerë, kujtim' i besimit primitif të tij ka mbetur i pa prekëshme edhe gjuha e tij as pak s'ka humbur, as ësht prishur në hasjen me popuj të tjerë. Këjo ngjarje e konstatuar që nga kohërat e vjetëra prej historianeve Grekër, edhe e pashme sot në popullin shqiptar, me të vërtetë meriton gjith vërejtjen e filologëve dhe të dijetarëve, edhe duhej të bëhej objekt' i një studimi serioz dhe i duruëshëm. Shkënca këtu do të fitonte shumë.

Panvarësisht nga gjith ç'kemi thënë gjer tash ti, për të provuar vjetërsin e popullit shqiptar dhe ekzistencën e tij të veçantë jashta familjes Elene, ka dhe ngjarje të tjera që bashkëvrapojnë për të forcuar mendimin t'one. Në Shqipëri, shpirt' i gjëzave akoma ushtërohet në një shkallë mjaft të gjërë dhe kësi lloj nxjerin ngjarjen na zorrët ose nga disa kocka të kafshëve, nga flututrim i zogve, nga ulurima e ujkut, nga ëndërrat e të tjera. Ky besim ësht rënjosur edhe kur gjë nuk mund t'a dobsojë në shpirtin e popullit. Gostit e vdekjes, dhirimet me ujë edhe kaqë të tjera veprime likshtë-besuëse të pa ndara nga besimi primitif i Pellazgëve, që janë në përdorim, ku do, provojnë se shqiptarët sa do që janë bërë të Krishterë dhe Muhamedanë, kanë ruajtur besimet e zëmrës sa dhe gjuhën e shërgjyshëve të tyre.

Gjith kësaj t'i shtojmë ahmarjen, gjakun, q'ësht konsideruar si një dëtyrë e shenjtë kundrejt shpirtë-

rave të prindërve të vrarë, shpirt' i një njeriut të vra-rë prej një tjetëri nuk mund të gjejë as lumtëri as qetësi në botën tjetër, në qoft se gjinia e tij nuk vret gjaksorë ose një prej familjes ose të fisit të tij.

Komente mbi kaptinat IV. dhe V.

Krahasimi i besimeve pagane të popujve të ndry-shme, na tregon se këto besime janë tepër të vjetëra dhe kaq të përzier me njëra tjetëren, sa është te-për vështirë të shquhet njeriu me një siguri të plotë, duke thënë se besimi — x — është marë nga besimi — y —. Sidomos në Shqipri që nuk është bërë as një kërkim, as një studhije e folklorit, nuk mund të vëndosij njeriu duke pretenduar se akësh besim është marë ng'akësh kombi ose është produkt' i imagjinatës të Kombit Tonë Shqiptar.

Krahasimi i besimeve pagane i gjith kombeve, të njohura historikisht, na tregon se popujt e vjetër ashtu dhe popujt primitif të sotmë që ndodhen në disa vende të faqes së dheut, kanë besuar se edhe trupat organik ose jo organik, kanë një afsh «shpirt» edhe këtij besimi shkënca e sotmë i thotë «Animizmë». Ky besim u ngarkon një shpirt e një vullnet maleve, lumënjve, shkëmbinjve, drurëve, gurëve, trupave qiellore, dheut dhe qiellit. Një dru, një shty-llë, një shpellë, si mbas këtij besimi konsiderohet selia ose froni i shpirtrave të pa dukëshme. Këto shpirtra më vonë janë kuptuar dhe fytyruar nën formë kaf-she dhe pastaj nën formë njerzore. Një burim është përfytyruar si një kalë: bije fjala Pegasi, Kal' i A-pollonit që bën të buçisij në malin e Parnasit buri-

min e Hipokrenit. Një rrëke në mitolozhinë Greke është përfytyruar si një dem me fytyrë njeriu. Dega e drurit që ri edhe në dimër me gjethe të gjelbëra, prej Grekërve të vjetër, konsiderohej shembull i fitores që është përfytyruar me emrin Dafne e cila i vinte pas Apollonit; dushku më parë ka përfytyruar Zeusin para se të bëhej drur' i Zeusit, edhe Dionisi është quajtur sikur qendronte në një dru, kur pushoj të jetë vetë lis.

Dheu është përfytyruar me fjalën «Gë», duke dalë për gjysmë nga toka nën formën e një gruaje që lut qiellin t'a lagë me një pikë. një. Qielli është Uranos, i bir' i kohës edhe at' i Perendivet.

Tashti kur shohim se malsorët e Shqipris, si të veriut dhe të jugut bejnë bé edhe sot; për këtë dhe, për këtë qiell e për këtë zjarr e të ljera, këjo gjë nuk mund të konsiderohet si një provë se jemi bijt e Pellazgëve. Se pse këto besime, i shohim dhe në për kombe të tjerë me qindra vjet para Krishtit. Benë me gur që ihotë auktori të cilën Sylla ja ka ngarkuar Cinnës, ka qënë një zakon' i Etruskeve edhe nuk' ka ardhur me anën e Pellazgëve në Romë; se kërkimet e më pastajme kanë provuar se Etruskët me anën e detit, kanë ardhur vetë n'Itali edhe në disa vende, bije fjala në Florancë ka dhe muzeum të qytetrimit Etrusk. Këta kanë ardhur nga Lidja e vjetër e Anadollit. Prandaj betimi me gur nuk është' i Pellazgeve, është i Etruskeve që kanë qënë një popull' i Asis vogël. Shqiptarët e sotmë, muslimanë ose i krishter qofië, kur bën bé me gur, nuk don me thënë se i beson gurit. Zakoni ka qënë i vjetër të cilin shqiptari e ka ruajtur; por kuptimi ka ndryshuar krejt. Shqiptari kur bën benë, tuke marë gurë në dorë, don të thotë: se në mos thënça të vërteten shpirt' i im, të mbajë të rëndit e gurit.

KAPTINA E VI.

Le të vinë përsëri në historinë.

Pirua, Mbret i Epirit, pas si u kthye nga Italia, në vitin 274 P. K., prishi Antigonë edhe u bë Mbret i Maqedhonis. Maqedhonia dhe Epiri u bashkuan nën një sovran: por pas vdekjes së Piros, Maqedhonasit ngritnë krye, dhe i biri i Piros, Aleksandri u bë Mbret edhe Maqedhonasve u shpalli luftë. Qysh prej kësaj kohe dhe gjer në kohen e Perseut, mbret i mbrumë i Maqdehonis, shohim se Epiri dhe Maqedhonia kanë vazhduar me alternative shum a pak të zgjatuna duke u bashkuar, duke u ndarë, her nën-urdhrin e mbretërve të një vendi, herë nën sundimin e mbretërve të vendit tjetër, por pa ju drejtuar kurrë Greqis as për t'i kerkuar ndihmë, as për t'a aneksuar.

Kur Romakët i deklaruan luft Mbretit të Maqedonis Perseut, republikat Greke nuk i dhanë ndihmë Maqidhonis, për shkak se bashkim' i tyre politik me Maqidhoninë që rezultonte nga pranim' i Filipit në mbledhjen e anfiksioneve, ishte shkaktuar vetem prej forcës dhe prej rethanave. Ky bashkim kishte pushuar me pushimin e shkaqeve q'e kishin provokuar, dhe prej kohet bashkimi ishte çartur. Maqedhonasit, ashtu dhe Epirotët, pas vdekjes të Aleksandrit të Math dhe pas përfundimeve fatkeqe të rivalitetit ndermjet gjeneraleve, perseri muar pozitat e mapërshme, d. m. th. se duke mos pas as një marëdhë-

një fisi me Grekët, nuk mundnë të ruajnë afrimin që-kish sjellë parapeshimi i armeve Maqedhonase gjat një kohe midis dy popujvet.

Për kundrazi, Epirotët dhe Ilirinjt që kishin ba-shkim fisi, gjuhe dhe aspirata me Maqedhonasit si të paslindunit e Pellasgëvet, q'ishin perzënë prej Eoleve dhe Jonëvet, të gjith vrapuan si një njeri i vetëm në ndihmën e Perseut edhe u përfshinë në fatkeqsirat që pasuan prishjen e Perseut në luftën e Pidnës. Maqedhonia u pjestua në katër province q'i paguanin pagesë Romës. Epiri pa qytetet e veta të djegura dhe të rënuara dhe banorët e tyre të zvaritur në skllavëri. Iliria gjeti fund duke u bërë një province Romane dhe Mbreti i mbrami i s'aj, Gjenti, u çua në Romë për të stolisur triumfin e fituesve.

Po ajy fat ishte rezervuar edhe për Greqinë: por pak më vonë: Romanët Greqis i muar independancen edhe ja aneksuan Perandoris së tyre. Romanët Greqis i rembyen edhe hegnitë e s'aj, kryveprat e s'aj të cilat edhe sot ruajnë akoma perkthesën e glorjes së vjetër dhe të gjenis të pa imituëshme të 'saj, të cilat do t'i imponojnë admirimit të brezavet të më pastajmë.

Që nga këjo epokë, Greqia nuk mundi të ngrihej nga rën-ja e s'aj. Shkelqimi që çlaqej nga një herë gjat periudhës perandoris Bizantine me të cilen Greqia ishte përzjerë, nuk pati ate natyrë sa të zhustifikonte glorjen e vjetër, se për këtë lypeshin shum sende. Greqia duke qënë e ndarë në dy provinca: Ahaija dhe Peloponezi, shum herë u renua prej Gotëve dhe prej Bullgareve dhe kshu si Perandoris Bizantine u rrukullis në një dekadancë të vajtueshme. Pastaj ngjanë luftat e Kryqit, dhe Kryqzorët e coptuna në shum shtete të vegjël si mbas sistemit të vje-

tër feudal edhe ushtruan një autoritet tepër të reptë: Barbaria e Oksidentit u shartua mbi mbeturinat e qytetrimit të vjetër dhe dekadanca arriti kufit' e fundit.

Epiri, Maqedhonia dhe Iliria pas si u bënë provinca të fjeshta të Romës, nuk patnë më ndonjë maredhënje me Greqinë; ndryshim i racës, j aspiratave dhe i interesave të cilat nuk i kishin bashkuar kurrë në një mendim kombsije, mori fund duke j bërë që të harojnë edhe kujtimet e largëta të marëdhënjeve politike të vjetëra të tyre.

Pushtim i Goteve, i Bullgareve dhe i barbareve të tjerë, pushtetit të Perandoris së lindjes i solli një grusht të tmershëm sa që ajo Perandori për shkak të sistemit despotik dhe të sundimit të keq të s'aj, humbi fuqinë dhe u coptua si Perandori e Perëndimit, para se të hinte plotësisht nën zotnimin Ottoman.

Në mes gjith këtyre fatkeqësiravet që grumbulloheshin edhe peshojshin rendësisht për mbi popujt, mendim' i një kombësije të përmbledhur mbarroj dukë u dobsuar: Njeriu nuk ishte ma qytetas i një atdheut. Gjith ashtu dhe fanatizma fetare që zuri vendin e dashuris së atdheut dhe të lidhjes tek fisi, solli si përfundim antagonizmin q'u çfaq midis mundësve dhe të mundërve; të parët shtypnin dhe të dytët vuanin, të parët vepronin energjikisht të dytët mbeteshin pesuës «pasif» për të përmbajtur ndryshimin e aspiratave që ndante e perçante muslimanët nga kristianët.

Të krishterët e Greqis u asimiluan me të krishterët e tjerë të Perandoris dhe pas trubullimeve të para q'u vertetuan me pushtimin Tyrk, mbaruan dukë u dhënë në tregëti, në lundrim dhe në arte. Pë kundrazi, Epirotët, Maqedhonasit dhe Ilirianët d. m. th.

gjith atà q'ishin fjesht prej races Pellazgjike, të cilët të huajt i kanë thirur në kohërat e ra në emrin Shqiptar, u bashkuan në një ide patriotike dhe në shekullin XV u kundrejtuan një qëndrim shum të rreptë zotrimit Ottoman.

Me të vërtet, në këtë shekull shohim se, gjith Shqipria kishte marë armët për të mbrojtur panvarësin e vendit. Gjerq Kasterjoti, mbiemrnar prej Turqve Skenderbej, pas si jetoj një kohë pranë Sulltanit si peng, arriti të pushtojë Krujën edhe gjithë pronjat e stërgjyshëve të tij q'i kishin pushtuar Tyrqit. Në emrin e Shqiptareve edhe me ndihmën e tyre, i shpalli luft dy sulltanëve më të tmershëm të perandoris Ottomane, Muradit të dytë dhe të birit të tij Mehmetit, rënuës i perandoris Bizantine edhe pushtuës' i Konstantinopojës.

Në këtë kohë u lidh bashkimi Shqiptar kryetar' i të-cilit ishte Skender-Beu.

Po hoqim dorë të japim hollësina këta mbi jetëshkrimin e këtij njeriu të jashtzakonëshëm; mjafton të themi se në një kohe kur as gjë nuk i qendronte armeve Tyrke, Skender Beu guxoj t'u bënte ballë me shqiptarët e tij edhe në 22 beteja q'u dha i mundi. Këto ngjarje historike flasin mjaft nalt mbi trimërinë shqiptare dhe s'kanë nevojë të komentohen. Por këtu na paraqitet një fakt tjetër që lëfton në favorin e tezës s'onë edhe parashtresës s'onë i jep një peshë të re.

Kur gjith krenët edhe populli Shqiptar kishin aderuar në lidhje e në bashkim dhe që princ' i Dukagjinit Leka, Arianiti, Zotni i Kaninës dhe i Vlorës, Bozhdari, Kryetar' i Nartës dhe i Janinës, Moisiu, Kryetar' i Dibrës, Topia, Streza, Kuka, Shpata, U-

rani, Engjëlli dhe kaq princer të tjerë dhe krenë të fiseve shqiptare, ishin reshtuar me armë në dorë nën kumandën e naltë të Skender Beut, popujt e Greqis ndëjtën krejtësisht larg edhe nuk bënë as më të vogëlin shforcim për të ndihmuar lëvizjen kombtare në Shqipri

Këjo pakujdesi formon një provë më tepër, se Grekët nuk' e konsideronin vet-hen e tyre solidar me të paslindurit e vërtetë të Pellazgëvet; ata nuk besonin njëjësin e racës as dhe në një afrim moral dhe politik: Çarjet e vjetëra, ndarjet origjinale, çfaqeshin për të tretën herë në një shkallë të madhe dhe hirështi, midis dy popujve të cilët mbetnë të ndarë, mbase dhe të huaj me njeri tjetërin, si në kohën e pushtimit të Persianeve dhe të Romanëve.

Shënime mbi kaptinen VI.

Autdori në këtë kaptinë bën një rezume historike mbi ngjarjet e Shqipris, të Maqedhonis të Greqis duke përfunduar se Epirotët, Maqedhonasët edhe Ilirinjtë si të paslindurit e vërtetë të Pellazgëvet kanë vepruar së bashku dhe në kundrështim me interesat politike të Greqis. Të themi të vërteten se këjo tezë nuk i përgjigjet realitetit, është themeluar mbi një pikënisje të gabuar e cila është theori e Pellazgeve q'u shpëgua në kaptinat e më parëshme.

Po të marim parasysh njgarjet historike siç kanë rjedhur shohim se mbretnia e Maqidhonis si në kohen e Filipit e të Aleksandrit ashtu dhe më parë, me popujt e Ilirës ka bërë miaft luftëra herë sulmuëse herë mbrojtëse, d. m. th. se të dy popujt, Maqedho-

nasit dhe Ilirianët nuk' kanë vepruar së bashku dhe në marëveshje kurdoherë; por këjo gjë nuk tregon se Maqedhonasit dhe Ilirianët kanë qënë dy popuj krejt të ndryshmë; për kundrazi kanë qenë dy popuj në mos vëllezër, kushurinj fare të afërt dhe ky lloj gjuni ka qenë shkaku kryesor i luftërave. Si t'afërt q'ishin. Maqedhonasit kanë dashur të formojnë një unitet politik me Ilirinjtë për të qenë më të fortë kundra të tjerëve. Ngjarje këso doresh, d. m. th. luftë midis popujve krejt të afërt, shihen shumë në faqet e historis. Bije fjala Turqit Osmanlinj për të bashkuar gjith elementet Tyrq t'Asis vegël që ndodheshin të ndarë nen sundimin e 12 princeve, u shtenguan të bëjnë luftëra të repta që vazhduan gati dy shekuj, për t'i suprimuar këto principata e për të formuar një perandori të përbashkët.

Dhe mbretrit Maqedhonë për të pasur krahët të sigurta u kanë hapur shum herë luftë princëve Ilirianë që ndodheshin në perëndim dhe në veri të Maqedhonis. Për me gjith këto luftëra shum princër dhe mbretër Maqedhonas janë martuar me princesha Iliriane, këto krushqi të shpeshta tregojnë afritmin e gjakut. Për të dhënë një ide mbi këto ngjarje lufte dhe krushqie, po i rjeshtojmë këtu poshtë:

Si mbas të thënave t'historishkronjësëve të vjetër: Dion de Kassius, Appien dhe Arrien, me 360 para Krishtit kur në Maqedhoni mbretëronte Aleksandr' i dytë, ka ngjarë një luftë midis Maqedhonasve dhe Ilirianeve pa ndo-një përfundim. Në kohën e Perdikës III (364-359 P. K.) për së dyti herë ka ngjarë një luft' e madhe, midis Maqedhonasve dhe Ilirinjve. Këtë herë Ilirinjtë ishin marë vesh me një tis Maqedonas që quhej Lynkest; prandaj Ilirinjtë ndodheshin në

kondita më të favorshme. Në këtë luftë të madhe në fushën e luftës ra i vrarë Perdika vetë me 5000 ushtarë.

Mbi këtë fitore të madhe Ilirinjtë po përgatiteshin që të pushtonin dhe Maqedhoninë Orientale, për veç pjesës Oksidentale q'e kishin qysh më parë në dorë. Asi kohet mbret' i Ilirinjve ka qënë Bardhuli i cili kish mundur e kish bashkuar shum fise Ilirinjsh, midis të tjereve dhe Peonët, dhe me këtë mënyrë ishte bërë një mbret i math që duke bashkuar Ilirinë dhe Maqedhoninë, do t'i ndronte fatin e Ballkanit; por me qënë se në Maqidhoni dolli Filipi, i ati' i Lekës Madh. me një zotsi të jashtzakonëshme, falë u kthye për ndryshe. Filipi ish i biri i Amintës së II dhe mori titullin Filip II. Ka mbretruar (midis 359-308 P. K.).

Filipi ësht një fytyr' e madhe historike, pak simpathik, politikan' i math, dredharak, këmbëngulës, intrigun dhe adverser i pa besë; por me një qendrim të fortë dhe me një hollësi të madhe. Ësht një nga çpikësit të arsyeshtetit me gjakftohtësi. Kur hipi Filipi në fronin e Maqedhonis, populli Maqedhonas ishte një popuj hujk dhe i vobektë, vendi s'kishte qytete të mbëdha. Filipi prej këtij populli krijoj një ushtëri të madhe, organizoj falanzhet dhe kërkonte që të vinte në dorë bregun e detit dhe për këtë shkak erdhi në konflikt jo vetëm me kolonit Greke që ndodheshin në brigjet e detit; por dhe me Athinën e cila ushtronte egjemonin e s'aj mbi gjith brigjet e Maqedhonis dhe të Thraqës.

Filipi, para se t'u binte Grekëve, lypsej o të miresh vesh me Ilirinjtë ose t'i munte dhe kështu të siguronte krahët. Peonëve u pagoj një shpërblim për t'i liruar vendet që kishin pushtuar më parë. Bar-

dhulë e ftoj në luftë, ky sa do q'ishte plak 80 vjeçar, pranoj luftën dhe në një betejë të madhe që ngjajti midis dy paleve, Filipi me gjith ushtërin e tij mbeti në një pozitë të rezikshme dhe shpëtimin ja detyron kalorësis Maqedhone q'u mori krahe Ilirinjve. Diodor' i së cilës thotë se Bardhuli në këtë luftë la 7000 të vrarë dhe në paqen që lidhi me Filipinë u shtërngua të lirojë Maqedhonin Oksidentale. Këto luftëra ishin luftëra vëllaznore për sigurimin e bashkimit. Athina me të marë vesh paqën, u alarmua tepër dhe shtyti Ilirinjtë në një luftë të dytë kondra Filipit. Tre princër Ilirinj u bashkuan kundra Filipit dhe ne 356 P. K., çuar traktatin e paqjes dhe çpallnë luftën. Filipi me një shpejti të madhe, të tre aliateve u ra më parë dhe i prishi, dërgon e fitimat të luftës i lindi i bir' i tia Leka i Math; ndejti mot-mot n'Iliri për të forcuar vendet e fituara. Nga kjo Athina u çqetsua njaftë dhe filloj t'intrigojë përsëri n'Iliri kundra Filipit. Oratori me famë Demosteni kshillonte aliancë me Ilirinjtë kundra Filipit për të ndihmuar Greqinë. Qeveri e Athinës këtë gjë nuk e pranojti; por Demosteni me nisiativën e tij erdhi në Durrës e në Pojan për të parë me sy situatën; pa lejen e qeveris Athinës bëri një beslidhje me këto dy qytete dhe me Tavllantinë «Muzeqen».

Maqidhonja për të prishur këtë aliancë më vonë ka bërë një luftë të tretë n'Iliri ku ka marë pjes edhe Leka i math duke qënë një djalë 18 vjeç. Gjith këto luftëra si ç'thamë më sipër ishin lufta me qëllim bashkimi të cilat nuk ndalonin krushqitë midis dy fiseve kusharinj: I at' i Filipit Aminta j dytë u martua me një princes Ilirïane i at i së cilës quhej Sirra dhe Filipi vetë u martua me një princes Ilirïane që quhej Avdata, e shoqe e Amintes quhej Kinana dhe grua e dytë e

Filipit ishte Olimpia, princes e Toskëris prej së cilës kishte lindur Leka i Math.

Si ç'shifet, mbretrit e Maqedhonis tre breza resht janë martuar me princesa Ilirjane d. m. th. Shqiptare.

Për të provuar se Maqedhonasit nuk' kanë qenë Grekër, nga raca e nga gjuha, kemi prova të tjera më të sigurta të cilat janë këto:

1. — Si nhas të thënave të Arienit q'ësht historishkronjës' i asaj kohe, Aleksandr' i Math në shum raste kur u fliste njerzve të oborrit të tij u fliste Maqedonisht, d. m. th. se Maqedhonishtia ish një gjuhë tjetër të cilën Grekrit nuk e kuptonin;

2. — Në veprat e shkruara prej Grekëve meret vesht se Maqedhonasit muajit Korrikut i thoshin — Dejos. Këjo fjalë në Gërqishte nuk ka kuptim; por po të marim parasysh se emrat e ditve, si e diel, e hënë, e martë, janë emra të perëndive të cilave u luteshin at dit, ashtu janë dhe emrat e muajve, o shprehin ngjarjet e stinave ose kryejnë emrat e Perëndive dhe — deje — në shqipë është emri një perëndie. Në malsinat e Matit edhe sot disa rënimeve që kanë qënë të destinuara për lutje e festime perëndish i kuptojnë me emrin, Dej' e madhe dhe Dej' e vogël. Nuk është e largët që fjala Maqedhonishte — Dejos — të ketë kuptimin e Perëndeshës — Dejë —;

3. — Po të vetmë re emrat topografike të Maqedhonis vjetër, shohim se ku do që ka pasur koloni Greke në Maqedhoni, emrat e tyre janë fjesht Gërqish dhe kuptohen me një herë. Është e tepër ta themi se këto koloni kanë qënë vetem në brigjet e detit dhe afër kufirit të Thesalis, kur se emrat e vëndeve të hin-

tertlantit Maqidhonas, jo vetëm që nuk janë Gërqisht, por nuk kanë as një afrim ose gjasim me atë gjuhë. Për kundrazi këto emra po të krahasohen me gjuhen shqipe, dalin tepër t'afërta; bile mund të themi, se këto emra në gjuhen shqipe kanë dhe kuptim. Bije fjala karaferja e vjeter në Maqedhonishte quhej — Beroe, fjalë — blegtori e cila ka kuptimin e një berit femër që s'ka pjellë; gjith ashtu kryeqytet i parë i Maqidonis — «Edhes» — nuk është gjësendi tjetër veç se breku i dhis; dhe q y t e t i dytë quhej — «Pelë» — fjalë që s'ka nevojë për shpjegime. Kryeqytet i tretë i Maqedhonis quhej — Pydhna — ose (Pyllna). S'ka dyshim se vjen nga fjala — «pyll» —. Edhe sot Shkodra dhe Gjinokastra në vend të «ll»-s përdor — «dh» dhe në vend — «dh» — se — ll —;

4. — Në histori t'asaj kohe shohim se mbretria Maqedhonase e Filipit me ligje si gjuhë zyrtare ka pranuar gjuhën e Atikës. Esht afër menth se Maqedhonasit po të ish që të flisnin Gërqisht, do të përdornin gjuhën e tyre dhe s'kish nevojë të bënin ligjë për gjuhen Gërqishte. Asi kohet gjuha Gërqishte ishte gjuhë kulturore të cilën e kishin adoptuar shum kombe të botës si gjuhë zyrtare.

Me tjetër fjalë Maqidhonasit ishin një fis i veçantë dhe kushuri i afërt me Ilirinjtë; por që kishin adoptuar qytetrimin Grek.

KAPTINA VII

Pas vdekjes së Skender Beut që ka ngjarë në gjysmën e shekullit XV, Turqit pushtuan dhe e shtruan krejt Shqipninë, siç kishin shtruar dhe më parë Greqinë. Në Shqipri ngjau ajo që kishte ngjarë në Greqi: Një pjes' e popullësis shtegtoj n'Itali, të tjerë pranuan Islamizmën dhe resti ndejti në Shqipri duke ruajtur fen Kristiane, Ortodokse ose Katolike.

Me gjith këtë pushtimi dhe bindja e Shqipnis si një provincë ottomane nuk rënoj as pak shpirtin luftëtar të popullsis. Banuës të malevet të repta dhe të pashkelura, duke mos pasur as toka të mjaftueshme për t'u dhënë në bujqësi, as dhe miaft hollësi për t'u shtruar në një mënyrë nojtje të re dhe për t'u hedhur në tregëti ose në industri, populli shqiptar gjithmonë ruajti karakterin dhe kujtimet e vjetëra të tij: u mbajt si një popull ushtar, dhe ushtar si stërgjyshërit e tij.

Kshu u bë jo vetem për muslimanët të cilët u shtërnguan të ndjekin traditat luftëtare që kishin zë në rënjë në vend, por dhe të krishterët, katolik ose orrtodoks qofshin, mundne të ruajnë armët e tyre dhe të bëjnë një karierë të lirë prej prierimeve luftëtare të tyre. Ushtërit që ngrinte qeveria në Shqipri kur do herë ishin të përziera: kristianë e muslimanë, qytetasit e një vëndi dhe degut e një fisi, gjith bashkë

mernin armët dhe luftonin trimërisht për të mbrojtur interesat e perandoris Ottomane.

Në krahinat malësore, në Shqipninë e Veriut ose n'ato të Jugës, të krishterët gëzonin privilegje dhe imunitete të ndryshme të cilat të krishterët, me pak përjashtime, i vinin në një rafshë të plotë barasije me bashkatdhetarët e tyre muslimanë; pashallarëi e Shqipris kur do herë ishin të rethuar prej krenëve ushtar muslimanë e të krishterë dhe mbështeteshin në trimërinë e tyre, pa ndonjë dallim.

Gjith racat e tjera që nuk ishin bashkëgjinës me fisin shqiptar qendruan larg, duke mos dashur kurrë të kenë çështje të përbashkta me muslimanët; racat e tjera heshtësisht kishin pranuar kandilat e të mundurve dhe u treguan gadi për të jetuar në një gjendje të përulëshme.

Ndarja e tyre i bëri që të humbasin zakonet e perdorimit t'armëvet, dhe pastaj shkaktoj mos besimin dhe poshtënimin ng'an e muslimaneve të cilët mbetnë kasti luftëtarë. Kshi Boj gjith ata që nuk ishin shqiptarë kurrë s'kanë dashur të njohin e të pranojnë detyrën e mbrojtjes së Midheut të përbashkët me armë në dorë, edhe gjith naburuan duke u dhënë në tregëti, në industri dhe në bujqësi si harbutët e kohës së mesme.

Në fillim të shekullit t'onë gjejmë Mustafa pashën në Shkodrë dhe Ali pashë Tepelenën në Janinë, të cilët kishin arritur që të dy në një shkallë pushteti që çpetsonte Portën e Naltë. Njeri zotnonte Shqipninë e sipërme edhe tjetëri Shqipriu' e poshtme, me pak përjashtime, si feodalë të mbëdhenj të kohës së mesme. Që të dy dilnë të bashkojnë elementin musliman me elementin e krishter në një mendim patriotik dhe në një glorie ushtarake. Gjith ashtu të përkrahur prej

Sejlerëve muslimanë, prej kapetaneve të krishterë dhe prej krenëve të fiseve, që të dy guxuan të kenë për qëllim ndryshime me një rëndësi të jashtëzakonshme; por rivaliteti q'është çfaqur në mes mbaroi me humbjen e të dyve; këta të dy ishin herë tiranë, administronin vendin me një despotizmë të tepruar, prandaj populli i la kur Sulltani filloj t'i ndeshkonte.

Me gjith këto kleftët dhe kapedanët shqiptarë ortodoksë që ndodheshin në sherbim të Ali Pashë Tepelenës, qen' ata q'i pergatitne Greqis së re trimat më të çquar të luftës së independencës s'aj. Boçari, Karajuskaqët, Xhavellat, Miaulet dhe Bullgaris si dhe kaq luftëtarë të tjerë gjith qenë shqiptarë që muar pjesë me mish e me shpirt në favorin e Greqis, duke qënë të ndhëshqur pikës pari prej shpirtit luftëtar, laktmimtar ngjarjesh edhe luftëraesh, dhe pastaj prej ndjenjave fetare q'i kishin të përbashkta me Grekërit. Lufta e independancës Greke në fillim nuk mund të merej parasysh prej këtyre kapedaneve shqiptarë të reptë si një luftë kombtare, por më tepër konsiderohej një luft fjesht fetare: ishin kristianë lëftuan kontra muslimanëve. Ishte Kryqi që lëftonte kundra hënës dhe ngjau ajo që kishte ngjarë gadi në gjith popujt e Evropës, që qytetasit e një Atdheut u thernë në mes të tyre n'emrin e një feje që nuk bashkohej as puk me ate që besonin të tjerët. Heqim dorë të tregojmë se gjer në ç'pikë hutimi mendor mund të çohen njerzit prej fanatizmës fetare dhe prej smirit të klasit.

Esht e drejt të themi se më vonë, kur independanca e Greqis u bë një pun',e mbaruar, kapedanët shqiptarë, të dehur prej fitores edhe prej pozitës së shkelqyer q'u kish dhënë trimëria e tyre në mes të Grekërve, përfunduan duke i thënë vehtëhes «helenë» edhe

duke marrë nasionalitetin e tyre. Por ky fakt pjesor nuk sjell përfundimin se gjith bashkgjinësit e këtyne kapedanëve të jenë helinë.

Të këtilla ndodhina kanë ngjarë kudo edhe do të përsëriten gjithnjë. Njerz që janë prej një kombësie mund të marin kombësinë e një tjetër vëndi; dhe shohim se në Francë ku shum njers të mbëdhenj prej origjinës Inglize, Irlandeze, Greke dhe Italiane të cilët, duke u vendos atje qysh prej kohë, kanë mbaruar duke u bërë francezë. Po ky fenomen na paraqitet n'Ingliterë, në Rusi dhe gjetkë. Por këjo nuk provon veç se një gjë: Njerzit e një kombësie individualisht mund të adoptojnë një kombësi tjetër, o me zgjedhjen e tyre të lirë, ose me fuqin' e sendeve, pa rënuar këjo, pa ndryshuar kombsinë e bashkgjinesve të tyre.

Për veç kësaj, është gjë për të shenuar se gjith Grekrit që ndodhën në Greqi dhe që janë bërë nenshtetas helen kurrë nuk' kanë pushuar të flasin gjuhën e tyre, dhe të formojnë një familje më vehtëhe: Feja dhe edukata të cilat janë të perbashkta me Grekërit nuk' kanë mundur t'i bëjnë që të harojnë origjinen e tyne, as t'u ndryshojnë sjelljet e tyre. Pra mund të këtë Shqiptarë shtetas Elinë; por nuk mund të pranohet që Shqiptarët të jenë prej racës Elinë, as që të dy popujtë të kenë një kombsi, dhe aspirata të njejta.

Akoma më pak do të pranojmë parimin që Kristjanët e Shqipris «Epirot ose Maqedonas» mund të konsiderohen si Grekër, për shkak të fesë Ortodokse që besojnë dhe që kanë së bashku me Elinët, ose për shkak të gjuhës Greke që mësojnë në shkollat, dhe që disave prej tyre u pëlqen të flasin. Po të jetë që të pranohet një gjë e këtillë, as gjë nuk do të ndalonte që Katoliqët Shqiptarë të cilët mësojnë dhe flasin

gjuhën Italishte të konsiderohen si Italianë me të cilët kanë dhe bashkim feje; por këjo bashqelles — Coincidance» kurrë nuk u ka shpirtruar Italianeve mendimin t'i revandikojnë Katolikët Shqiptarë si bashgjinesit e tyre, gjith asbtu dhe Katolikët Shqiptarë kurrë s'kanë pasur dëshirën të besojnë në më të paktën kushërini race ose kombsie me popujt' e Italis.

Mbas pikpamjes s'onë, Shqiptuërt qofshin muslimanë, ortodoksë ose katolikë, janë edhe mbeten siç kanë qenë tridhjet shekuj më parë, populli më i vjetër i Evropës race më pak e përzier e gjith racave të njohura, racë e cila si një fenomën që në lepër mund të quhet mrekulli e që nuk mund t'a shpjegojmë, ka munduar të qëndrojë kundrejt kohës që rënon e ndryshon, ka munduar të ruajë gjuhën pa patur as një letrësi, as një qytetrim të përparuar edhe për veç kësaj ka arritur të ruaj një tip origjinal dhe karakteristik pa u treguar i pa shoqueshëm edhe në çlaqjet e jashtëme, pa hedhur poshtë besimin dhe ritet e feve që ka përqafuar dhe ka dalë duke u përhapur fituës nëpër evolusionet e shekujve.

Ka një send tjetër mendimesh dhe konsideratash mbi të cilin heqim vërejtjen e dijetarëve dhe të filologëve për të na ndihmuar që të nxjerim argumenta të ra në mbështetje të tezës s'onë.

S'kemi nevojë të themi se Kostandini qe ajy imperator' i Romaneve që harti selin e imperatoris në Bizans, as që më vonë, këjo perandri e madhe u ndu më dysh, njëra prej të cilavet mori emrin perandori e Oksidentit dhe tjetëra perandori e Orientit, as që më vonë akoma me një shperdorim q'u bë me fjalë, këjo perandori e mbrame u quajt perandori Bizantine dhe

perandori Greke. Këto janë sende fillestare të cilat i dinë gjithë. Pra është e vërteta se nuk qenë Grekërit ata që ngrehnë në fillim ose pushtuan më vonë perandorinë Bizantine: Këjo qe një veprë e Romanëve. Në qoftë se ma vonë, u quajt perandori Greke, nuk është nga shkaku i një krijimi Grek, por se pse perandorët që pasuan njeri tjetërin dhe shumica e popullësivet që lidhej me atë, u ndanë nga kisha Romane dhe ndognë ritin q'u quajt Grek për t'a dallua nga tjetëra q'u quajt Roman ose Latin.

Në pranim të këtyre fakteve, njerin është i shtërnguar të pranojë se emertimi perandori Greke nuk jo dha me një kuptim konkret as për të treguar origjinën; por vetem me një kuptim krejt tjetër, me ate mënyrë që në vonë, duke shpërdorur kuptimin dhe përdorimin e fjalës, mbaroj me të përzier nën emërtimin Grek jo vetëm ata q'ishin prej racës dhe prej kombësis Greke, por edhe ata që duke qënë prej racave të tjera ushtëronin ritin e kishës orientale Greke.

I lidhemi këtij mendimi me aq këmbëngulje sa që deri në ndarjen e Fotius: edhe më vonë akoma, perandori e Orientit nuk quhej tjetër veç se perandori Romane; dhe në fakt këjo perandori nuk ish tjetër gjë, me gjith që kishte rënë copa copa si ajo e Oksidentit, neo pushtimin e barbarëve. Perandorët e Bizansit vetem me titullin perandor Roman rusjtën për shumë kohe ekzarhatin e Ravennës ashtu dhe të tjera vende që ndodhen në zëmrën e Italis.

Emëri me të cilin trogoheshin në Gërqishte neashtetasit e kësaj perandorie që fjeshtësisht fjala, Romei, d. m. th. Roman edhe sot Arabët njerzit'e perandoris Ottomane që nuk janë prej racës Arabe i thresin me emrin Rum, d. m. th. Roman; gjith ashtu fja-

let: Roumëi e Rumi sherbenin për të treguar pushtonjësit Romanë, themelonjësit e perandoris edhe as pak njerzit prej racës ose prej kombesis Greke. Arabët e kohës s'onë, duke bërë fjalë edhe për muslimanët nëpunës të qeveris Turke, i thresin me emrin (Rumi).

Dihet se Arabët armiqesonin dhe urejtnin Romanët; ishin armiqt' e reptë të tyre. Këto ndjenja nuk janë këmbyer as ndryshuar për shkak të bashkimit të fesë; ashtu dhe bijët e shkretimës edhe sot akoma i thresin ata që kanë zëvëndsuar Romanët si zotnuës të vendit tyre me emrin Rumi.

Vetëm kur perandoria Ottomane u ngreh mbi rënimet e perandoris Bizantsit edhe që pushtuësit e rinj nuar emrin Osmanlli, emërtimi «Roumëi» mbaroj duke u aplikuar për banorët e perandoris q'ashtronin fenë Ortodokse. Fjala Romeos në gjuhën e vullgut u hë sinonim me fjalen Grek.

Gjërësia që ju la kuptimit të këti emri «Grek» dhe shpërdorimi q'u bë më pastaj, mbaruan duke bërë ket emër gjeneryik. Këjo fjalë pikës së pari u përdor për të treguar Romanët, themeluësit e perandoris, pastaj për të treguar të krishterët prej ritit Ortodoks dhe më vonë po me këtë emërtim u përfshinë dhe njerzit prej racës dhe prej nasionalitetit Grek dhe ata q'ashtëronin dhe kishin së bashku me ata besimet dhe dogmat fetare. Pikërisht ngjau ajo gjë që ndodhi dhe në Islamizmë.

Me ermin Turk nuk' u tregua nasionaliteti; ky emër ju dha gjith njerzëve q'ishin pej fes muslimane, pa dallim. Për shkak të mungesës të një kombsie të vetme në përpjekje me racën dhe me origjinën, feja Muhamedane zuri vendin e kombsis edhe muslimanët

prej gjith racave dhe prej gjith kombsive u bashkuan-në një kuptim fetar dhe politik i cili kuptim nuk formoj një kombsi, pro një pushtet të math, një perandori aq të madhe sa ajo e Romaneve të vjetër q'ishin parashkuesit e tyre.

Sot që lakmitë edhe pasionet po ziejnë, njerzit përpiqen t'i apin shkembimin, nuk them shkencës që mbetet e pa pësuëshme dhe e pa tundëshme ballë enteresave dhe aspiratave të kombsive të ndryshme, por opinionit publik që gabohet ndo-një herë edhe duket përkrahës për disa çështje që nisen nga një parim i gabuëshëm. Ka njerz që besojnë se gjith ata q'ushtërojnë fenë Greke edhe që për shkak të kësaj janë detyruar të mësojnë gjuhën Greke, janë grekër prej race dhe prej origjine.

Anëtarët e panhelenizmës për të revandikuar një pjes të popullësis së Epirit edhe të Maqedhonis, zakonisht vëhen në këtë pozitë. Por si mbas ç'kemi parashtruar edhe si mbas provave që kemi paraqitur për të u mbeshtetur argumentat t'ona, të këtilla pretendime janë të pa pranuëshme; edhe këto pretandime ballë historis dhe ballë fakteve që rjedhin prej asaj nuk mund të qëndrojnë më këmbë. Gjith ashtu kuptimi që duan t'u apin fjalëve dhe dredhia që përpiqen t'u npin sendeve, nuk janë veç se një punim ënditimi që nuk ka as një themel për t'i u impozuar besimit të njerzëve as dhe sanksionimit të shkencës.

N'është se Islamizma ka përmbledhur njerzit në një unitet fetar, duke larguar çeshtjet e racës dhe të kombsisë për fitimin e fesë, e cila ka ushtëruar një veprim perzimtar dhe ka kthyer aspiratat e të gjithëve në trëumfin e besimtarëve, ky fakt nuk mund të shërbejë si frazë fillestare për një krahasim «silogjismë-

i cili jep si përfundim se gjith ata, që në Turqinë Evropiane, ushtërojnë fenë Greke, janë prej race dhe prej kombesie helenike.

Njësia e besimit fetar ka ushtëruar këtë pushtet edhe ka nxjerë këtë fenomen mbi muhamedanët, themeluesit e perandoris Ottomane, por që nuk mund të invikohet si një e drejtë as dhe si një provë kombesije helenike për ortodoksët e Epirit dhe të Maqedhonis.

Për ditë dëgjohet të thritesa shqiptarë, muslimanët e Epirit dhe të Maqedhonis dhe për kundrazi të emrohen Grek — helinë të krishterët po t'atyre vendeve. Broshurat dhe fletoret që janë shpallur në kohërat e fundit kanë përsëritur me gjith zërat këto emërtime po dyshuar as kush nuk pasaklësin' e tyre. Me gjith këtë, ata që rëmbehen prej dallimeve të këtilla çuditërisht gënjehen, se pse nuk bëjnë as një gjykim nga të fjeshtë, vjen me thanë se muslimanët e Epirit nuk janë veç se vëllezërit e të krishterëve; janë prej një race, në rëmbat e tyre qarkullon një gjak, kanë po ata shërgjyshër që kanë dhe të krishterët.

Para zotnimit Ottoman, muslimanët nuk ishin tjetër gjë veç se Kristian ortokodsë të ciltë, me dëshirë ose për interesë përqafuan Islamizmën, si gjith muslimanët e Shqipris epërme që nuk ishin tjetër gjë veç se Katolikë të kthyer muhamedanë, si muslimanët e Greqis nuk ishin tjetër gjë veç se helinë që ushtëronin Islamizmën.

Thiria Shqiptar, muslimanet e katolikët që nuk janë prej kishës Greke dhe pretendimi se ortodoksët po të një vendi janë Elinë se besojnë doktrinat e kishës Ortodokse, si mbas mendimit t'onë, don me thanë, me dasht ngreh besimin fetar në parim kombesie dhe me

zëvëndësue racën me dogmë, rritin me aidhe, gjë e cila nuk është e pranueshme.

N'është se popullsit e Epirit ato që takojnë më afër kufive të Greqis, pjesërisht flasin gjuhën Gërqishte, këjo nuk mund të luftojë në favorin e pretandimit të çoditëshmë që jemi duke shënuar. Gjeografikisht, ethnologjikisht dhe historikisht, është e provuar se Epiri dhe Magedhonia kurrë nuk' kanë bërë pjesë të Greqis: Rraca e banorëvet, gjuha e tyre, zakonet e tyre, ngrehinat qytetnore, politike dhe ushtarake të tyre, ishin krejt të ndryshme. Për sa i përket gjuhës, do të them që si Eolët që banonin pranë kufive të Epirit flisnin një gjuhë të përzier gjysma Greke dhe gjysma Pellazgjike ashtu dhe Epirotët kufitarë të Greqis natyrisht duhej të kishin mësuar shum fjalë Greke dhe t'i kenë përzier me gjuhën e tyre. Këjo s'ka nonjë gjë të jashtzakonëshme. Por ajo që duhet të vehet në pah, është që këjo gjë nuk ndolli vetem për ata Epirotë që hasnin plotsisht në kufitë Greke, se pse sa largohet njëriu ng'ajo kufi, aq më tepër kuptimet e gjuhës Greke bëhen të ralla. Ato kuptime humbin krejtësisht në krahinat e Filatit, Margëlleçit, Gjirokastrës, e tej, ku popullësitë muslimane dhe ortodokse nuk dinë veç se gjuhën shqipe. Për veç kësaj në është se gjuha Greke u kultivua dhe u adoptua në disa krahina të Epirit, që ndodhen fare afër vijë-shenimit të kufive Greke, ky fakt, pikës së pari i detyrohet fqinjësis me grekërit, pastaj fes Ortodokse e cila ka mësuar lutjen e kishës në gjuhën Greke dhe më në fund, pa kujdesis së qeveris Ottomane që nuk' ka menduar kurrë të përkrahij as të përhapij mësimin botnuer në një shkallë të gjërë dhe në një mënyrë të një formëshe për të gjithë.

Në mungesë të shkollave të ngrehura prej autoritetit politik të vendit, pikë së pari priftëria dhe dhaskajt Helinë pas atyre kanë filluar edukimin e popullit: edhe gjuha pellazgjike ose Shqipe duke mos pasur një letërsi të vetin për të përhapur arsimin, është përdorur gjuha Gërqishte për të mësuar shkencat asht u dhe lutjet e dogmat e fesë.

Dhe këjo është aq e vërtetë sa po ajy fenomen duket dhe në Shqipninë e Epërme për sa u përket popullësive katolike. Dhe atje qeveria Ottomane s'ka bërë gjë sendi për Arsimin botnuer, edhe qenë priftëria dhe sidomos fetarët Fransiskan prej origjines Italiane, që predikuan fenë, shërbyen kishën edhe hapnë shkolla ku mësohej njikohësisht Italishtia dhe Shqipia. Mbasi fetarët Italjan të Shqipris s'Epërme nuk kishin për qëllim të italianizonin popullin për dëm të kombsis Shqiptare, nga këjo përfundoj që gjuha Italisht u fut vetiu për shkak të fqinjësis me Italinë dhe maredhënjet tregtare si dhe për shkak të kujtimit të republikës së Venedikut në provincën e Shkodrës, por gjuha e vëndit, gjuha Shqiptare, nuk u dhua as nga lutjet, as nga predikimet fetare.

Bile klerit Katolik i jemi të detyruar për ato pak libra të shtypuara në gjuhen shqipe q'ekzistojnë akoma në ditët t'ona dhe që mbase më vonë do të përmenden me titullin e fillesave «esais» të para të një letrësije e cila sa do që nuk' ka ekzistuar gjer tashti, më vonë mund të dalij në dritë dhe të kërkojë një vend në vatrën e qytetrimit.

Me gjith këtë, fetë dhe studimi i gjuhëve q'u përkasin atyre «këjo është për Gerqishten, Italishten dhe Turqishten», nuk janë veç se ngjarje që mund të ndriçojnë inteligjensat dhe të zbutin shtytkat e popullësi-

ve, por që me as një mënyrë nuk mund të lëndojnë racën, as që t'i sjellin dëm parimit të kombsis që është dhe mbetet një dhe e pa ndashme për gjith shqiptarët — o të besojnë Krishtin, ose Muhamedin, të ndjekin ritin Latin ose ritin Grek.

Shënime mbi kaptinen VII.

Auktori në këtë kaptinë ka trajtuar disa çeshtje historike, politike dhe shoqnore të rëndësishme për kombsin Shqiptare.

Pikës së pari bën një paralel midis popullit Shqiptar dhe popujve Ballkanas të tjerë. Dhe me të drejtë thotë se vetëm në Shqipëri elementi i Krishterë nuk ishte bërë raja; por kanë ruajtur të drejtën të mbajnë armë dhe të lëftojnë për një atdhe të përbashkët.

Ky fenomen formon një ngjarje me shum interes nga pikpamja politike dhe historike dhe me të vërtetë meriton një shpjegim t'arsyetueshmë.

Nga gjith popujt e Ballkanit vetem kombi Shqiptar ka treguar një qendrim të përgjaktë dhe të vazhdueshmë kundra pushtimit dhe zotnimit Ottoman. Ky qendrim i shkelqyerë me fitoret e mbëdha të heroit kombtar Skender Bej Kastriotit hoqi verejtjen dhe admirimin e gjith botës mbarë. Turqit Osmanllinj nga trimëri e pashembëllta e shqiptarëve muar një mësim edhe vendosnë që këtë popull ta bëjnë për vehtëhe për t'u mbajtur me armë në sirethujzën e Ballkanit.

Me qënë se Turqis së vjetër i mungonte kultura dhe shpirti i organizimit q'ësht i lidhur me atë, i vetmi mjet vepruës për një gjë të këtillë ishte bashkim' i

fesë. Prandaj Turqi e vjetër gjith energjin' e s'aj, në fushën e politikës brendëshme, për sa i përkiste Shqipris, e përqëndroj në propagandën fetare të Islamismës. Këjo pikë me randësi të madhe për fatin e Shqipris ka nevojë për një shpjegim. Turqia në periudhën e pushtimit të Ballkanit u mendua që të krijonte disa kolloni ushtarake për të qenë një pikëmbështetje në mbrojtjen e vendit. Këto kolloni ushtarake formoheshin:

1. — Duke vendosur familje Turqësh të Anadollit në disa vende me rëndësi të Rumelis.

2. — Duke vendosur Jenicerët që dalnin në pension në për qytetet e Rumëlis;

3. — Duke treguar disa dobina paris së vendit dhe si domus populësive të zjohur si luftëtare, i islamizonte dhe i shoqeronte me dy elementet e tjera të sipërtreguarë. Kollonitë ushtarake të formuara kësi lloj, në disa vende ishin të shpeshta dhe në disa të tjera ishin të ralla dhe kishu elementi ushtarak dhe musliman, për vec Shqipris, as me një province të Rumelis nuk formonte shumicë. Me këtë mënyrë popullsia e Rumelis ndahej në dy kaste:

a/ — Elementi Muslimun, Tyrq ose i përzier me të vendit, formonte kastin ushtarak, zotnuës dhe pronar i tokës dhe i çifligeve. Natyrisht një klas e këtillë e kishte për turp të merrej me tregëti dhe me zejtari; katundarët e kësaj kategorije, kur u linte kohe sherbimi ushtarak, merreshin vetem me bujqësi;

a/ — Kasti i rajave ku mblidheshin gjith të krishterët të cilët gëzonin të drejtat civile dhe jo politike. Dhe pjesa e rajave që banonte nëpër fusha formonte klasën e bukut gjysmatar ose tretar' i kastit ushta-

rak, vjen prej vetiu se klasa e rajave s'kish as një interes lendore ose morale për të mbrojtur Zotnimin Ottoman q'e kishte lënë në klasin e dytë. Këjo klasë, përkundrazi, duhej të kishte për ideal çkatrimin e zotnimit Ottoman për t'u liruar nga zgjedha.

Shkaku i vërtet i dekadancës Ottomane ishte dobsia e qendrës së perandoris dhe ndodhja e një shumicë popullsije, armiku i zotnimit Ottoman. Tue qenë puna kësi soj pajtim' i dy kasteve ish i pa mundur se nuk ndodhej as një pikë bashkimi.

Tash të vimë n'aplikimin e kësaj politike në Shqipri:

Pas vdekjes së Skenderbeut me 1467, veprimet luftëtare dhe pushtuese të Tyrqve Osmanllinj muar fund; por Shqipria në dy të tretat e s'aj ishte djegur e rënuar, gjith pasunit shkretuar, popullsitë nga luftërat, nga sëmundjet e nga mërgimi ishin dhjetuar. Tyrqia 80 vjet resht mbajti vetëm një okupasion ushtarak në Shqipri; por brenda kësaj kohe filloj propaganda e proselitizmës në favor t'Islamizmës. Në kohën e Skender Beut gjith Shqipria ndodhej nen sundimin e zotnive të krahinave; me tjetër fjalë nen sendimin e feodalizmës, si ç'ishte zakon' i kohës së mesme n'Evropë, të përfaqësuara prej disa familjeve të mbëdha që kishin rënjë tradisionale në vend. Familjet e Zotnive të klasës së parë, asi kohet, ishin:

1. — Kastrijoti
2. — Dukagjini
3. — Topia
4. — Strazmiri
5. — Arianiti
6. — Urani
7. — Spanoj
8. — Spata
9. — Kurona
10. — Muzaka
11. — Dushmani

Pas këtyre vinin dhe familje Zotnish të dorës së dytë. Burat e disave nga këto familje të para e të dyta u vranë në luftërat e vazhdueshme, disa u mërguan duke shtegtuar n'Itali e gjetkë dhe disa mbetnë në vënd. Me qenë se Tyrqia armët dhe çifligjet ja linte vetëm muslimanit, po të krijonte koloni ushtarake në Shqipri të formuar prej ardhësëve prej Anadolli, ngrindja do të vazhdonte gjithmonë. Për këtë arsye Tyrqi e vjetër në Shqipri zbatoj një politikë tjetër e cila ishte kjo: kush të pranonte Islamizmën nga fëmijët e para dhe të dyta do t'u falte çiflige, do t'i linte të lirë të mbanin armë, do t'u akordonte grada ushtarake të mbëdha brënda dhe jashtë Shqipris. Kombi Shqiptar në luftërat e repta dhe të vazhdueshme të Skender Beut, kishte bëtuar me fanatizmën fetare, duke shpresuar se më në fund do t'a fitonte luftën me ndihmën e Kryqit. Prandaj kur u mund definitivisht humbi dhe besimin që kishte te kryqi. Pas një aksioni të fortë, me dosmos vjen një reaksion. Për veç kësaj kombi Shqiptar, përgjithesisht dallohet me ambicje të madhe, me energji dhe me inteligjencë. Gjithmonë kërkon fushata të gjëra që të xhvilloj këto vetia. Sidomos rivalitetet me njeri tjetrin,, sa do që kishin pushuar deri me një shkallë, në kohën e luftëravë kundra armikut të përgjithshëm, me pushimin e luftës filluan të veprojnë përsëri. Tyrqit përfitoninnga këto rivalitete. Kur një familje pranonte Islamizmën për të gëzuar avantazhet q'i akordonte Islamizma, rivali tjetër me dashur ose pa dashur, për të mos mbetur pas, pranonte dhe ajy Islamizmën. Duke parë avantazhet që gëzonin muslimanët e rinj dhe duke parë çkatërrimin e organizatave kishëtare, gjith bota fir lluan të imitojnë njëri tjetërin me pranimin e Isla-

mizmës. Në shum vende burat pranonin Islamizmën gratë mbeteshin kristiane. Në shum vende, vëllaj i math mbetej' i krishter për të ruajtur fenë dhe vëllaj i dytë në marëveshje me të madhin pranontëIslamizmën për të ruajtur rangut e familjes; dhe me qënë se në gjuhën Shqipe, lalë, d. m. th. vëllaj i math, në disa vënde fjala — lalë —, duke u larguar nga kuptim i parë u destinua për të treguar të krishterët.

Pa u mbushur një shekull, që nga pushtim i plotë i Shqipris, shumic' e madhe e popullit pranoj Islamizmën për cipe, por brez' i dytë u bë tanam musliman. Në një popullësi (1.800.000) njerz. 1500.000 u bënë muslimanë dhe 300.000 m b e t n ë të krishterë ortodoks e katolikë. Këta të krishterë formonin disa grupe gadi independant dhe për të mbrojtur ar' mët erdhë në marëveshje me qevorinë Tyrke, që të mos paguanin haraç, as të dhjetë, me kondilë që të kishin të drëjt të mbanin armë dhe në rast që perandoria hynte në luftë, detyrohëshin të vinin e të luftonin bashkë me muslimanët për mbrojtjen e perandoris.

Këto grupe të krishterësh kishin një organizatë mbi vehtehe: Ç'do fis kishte bajraktarin e vetë, disa bajraktarë kishin mbi krye një vojvodë, dhe disa vojvoda kishin për të parë kapetanin e Krahinës. N'ushtërimin e fes'ishin të lirë, çeshtjet familiare i shikonte kisha e tyre dhe çeshtjet civile dhe penale i shikonin pleqt' e vendit duke pasur në mes të tyre nga një gjyqtar tradisional që dinte mirë zakonet e vendit dhe kanunin e Lek Dukagjinit. Gjith katolikët e Shkodrës, ortodoksët e Himarës, të Sulit, të Lunxherisë, të Zagoris e të Rëzës formonin grupe kësodoret.

Ato fshatëra kristiane që ndodheshin midis fshatërave muslimanë në për male kishin ndonjë kapetan

ose bajraktar të cilët në kohe lufte lidheshin me bejlerët e vendit. Pas kësaj organizate, të krishterët e Shqipris nuk u bënë raja si kombet e tjerë, se zakon' i vëndit, historia e përhapjes së Islamizmës në Shqipri nuk i la të degradoheshin në shkallën e rajeve.

Vassa Pasha në këtë kaptinë tregon këtë ndryshim midis shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit.

Ndermjet Grekërve, Bullgarëve dhe Serbëve, elementi musliman, vendës ose ardhës, ka qenë i pakte dhe shumica ish e Krishterë. Elementi musliman mbronte zotnimin Tyrk se pse bashkohej me te fetarisht, se pse qeveria i siguronte sipërmësinë e kastit e të rangut ashtu dhe të drejtat e pronësis mbi toka të mbëdha, kur se shumica e Krishterë lëftonte qeverinë Tyrke për të shpëtuar nga zgjedhja. Në Shqipri gjante e kundërta. Përveç që shumica ishte muslimane por dhe pakica kristiane ishte e mbrojtur dhe e privilezhuar, të paktën në grupet e mbëdha të s'aja, dhe një far sojë bashkohej me elementin musliman deri sa mund t'i bashkonte gjaku dhe gjuha që kishin të përbashkët. Ky ndryshim i Shqipris ësht që vonoj ndarjen e s'aj nga Tyrqia.

Qeveria Ottomane pas si konstatoj se shumic' e madhe e Shqiptarëve pranoj fenë muslimane, nuk pa nevojë të formonte koloni ushtarake si në Serbi, Greqi e Bullgari. Me qenë se bashkim' i fesë siguroj besimin reciprok midis qeveris Ottomane dhe popullit Shqiptar, qeveria preferonte valinjtë prej racës Shqiptare për të sunduar vendin. Deri sa qeveria qendrore e Stambollit ishte e fortë, qeveritarët i zgjidhte Stambolli lirisht, të huaj ose vendës. Por kur ngrehinat shtetnore të Stambollit filluan të dobësohen, Porta

e Naltë humbi lirinë e emnimit të qeveritarëve në Shqipri; feodalë të fortë okuponin vendet me forcë e me dinakëri; shtërngonin popullin që t'i drejtonte lutje Sulltanit për të legjitimuar postin që kishin okupuar gadi me forcë.

Vassa Pasha në mes të këtyre feodaleve shenon dy më të fortë të cilët janë Bushatlitë në Shkodër dhe Ali Pahë Tepelenën në Janinë. Në ç'do sanxhak të Shqipris kishte nga një prefekt ose më mirë të thomi nga një Pasha vëndës, fisnik i vjetër ose cubë me forcë që sundonte vëndin. Suvraniteti Ottoman kish mbetur krejt për cipe: Respekt i Kalifatit, ferman i emnimit dhe marja pjesë në luftë kur e lypte nevoja.

Që nga mbarim' i shekulllit XVII, demoralizimi dhe dobsia e qeveris qendrore përparonte me hapa të mbëdha dhe si përfundim i kësaj dobsije fuqia e feodaleve qeveritar sa vinte po shtohej

Esht e interesaçme të hedhim një sy mbi situatën e Gegëris në kohën e Mustafa Pashës në Shkodër dhe mbi atë të Toskëris në kohën e Ali Pashë Tepelenës në Janinë.

Bushatlinjtë gjith Shqiprinë e veriut e sundonin me kanunin e Lek Dukagjinit, populli pagesa nuk paguante dhe vilajet i Shkodrës administrohej me t'ardhurat e doganës e të krypës dhe me të dhjetën e rafshinave ku punonte qerrea. Qytet i Shkodrës ishte një qendrë e madhe e tregtis, se malli që vinte nga Triesta dhe nga Venediku, grumbullohej në Shkodrë dhe mbartej me aniet e Ylqinakëve. Malli që grumbullohej atje shpërndahej në gjith vilajetin e Kosovës, në sanxhakët e Nishit e të Sofjes dhe me udhën e detit vinte dhe në Greqi. Në gjith sqelat me rëndësi t'Adriatikut kishte shtëpia tregtare shqiptare që me-

rreshin me importim e eksportim. Tregtarët e Shkodrës jepnin mall veresije në shum vënde të Rumelis dhe Veziri i Shkodrës dërgonte malsorët për tahsil duke mbajtur një përqindje për të paguar malsorët. Asi kohet tregtia për tokë bëhej me anën e karvanëve që një qetësi e siguri të plotë ndjet fuqis së armatosur të Vezirit të Shkodrës. Veziri me t'ardhurat që thamë më sipër, paguante një fuqi t'armatosur prej malsorësh të cilën e shtonte në kohe lufte. Nen sundimin e tij mbretronte një farë lumtëri ekonomike. Katolikët e Shkodrës, qytetas ose malsorë shkonin një jetë jo të keqe. Prandaj kishin interesë të mbronin me armë postin e Vezirit. Të huajt nuk gjenin rast të nderhynin e të intrigonin me anën e katolikëve.

Në Toskëri situata nga disa pikpamje ndryshonte. Pikë së pari popullsia nuk ishte fjeshtë shqiptar. Në rethet e Janinës e të Prevezës kishte një popullsi Grekofone e cila nuk gëzonte të drejtat e privilezhet që gëzonin grupet ortodoks prej racës Shqiptare, si Himara, Suli, Lunxhëria, Rëza e Zagoria. E dyta në Toskëri, ndër vënde të banuara prej muslimaneve, feodalizma qe e përhapur shumë dhe prandaj Ali Pashës ju desht që këtë feodalizmë ta suprimonte për të vendosur pushtetin e tij. Prandaj në rast që Ali Pasha do të hynte në një konflikt të hapët me Sultanë e me Portën e Nallë, nuk do të gjente përkrahje në popullsin e vendit, ashtu si ç'ngjau me 1820 kur Pashaj i Janinës u bë fermanlli! D. m. th., u shpall nga Stamholli, i rëzuar. Ali Pasha për të shtypur fisnikët e vjetër të Toskërisë, u shtërngua të krijonte një klas të re. Prandaj nen titullin — «Armatoli» —, armatosi dhe një pjesë të grekofoneve të cilët gjer aherë konsideroheshin raje.

Katolikë e Veriut, duke qenë në kundërshtim race e feje me Sllavrit kufitar nuk mund t'i shërbenin qëllimeve të Pan-Sllavisë; Kur se në Jugë, pikë së pari Rusia filloj të bënte propagandë midis të krishterëve si grekofon ashtu dhe në mes të shqiptarofoneve në emër të Ortodoksisë. Grindja e përgjaktë që ndolli në mes të Ali Pashës e të Suljoteve ka filluar pas si u kthye prift Samueli nga Rusia me mendime fanatike dhe armiqsore. Me rethimin e Ali Pashës në kështjellën e Janinës filloj dhe kryengritja Greke në 1821 ditën e Ungjillzmojt. Që nga këjo dit' e pastaj ortodoksët e Toskërisë, si Grekofon ashtu dhe Shqiptar përqafuan çështjen e Helenizmës. Sidomos ortodoksët Shqiptarë me krenëri e shkelqyer të lyse ringjallën Helenizmën që kish vdekur prej shekujsh.

Si ç'thotë dhe auktori vetë, zakoni që mbretronte gjer at-here midis muslimaneve dhe të krishterëve u kthye në një luftë feje të replë; por këjo gjë nuk provonte se ortodoksët Shqiptarë ishin Helinë, gjë të cilën do t'a provojë auktori në këtë kapitnë.

Lindja e nusionalizmës shqiptare pas datës 1878 një pjesë të shqiptarëve ortodoks e hoqi me vehtëhe për të krijuar një Shqipni të lirë dhe independente. Si ç'e thotë dhe auttori vetë luftat fetare midis vëllazërve të gjakut dhe të gjuhës ka ngjarë në shum vende t'Evropës; por mendimet liridashëse të përparimit modern kan çdukur fanatizmën dhe kan ringjallur vëllazërin e parë.

Ali Pashë Tepelena dhe Mustafa Pashë Bushati në Shkodrë kanë pasun kaq fuqi sa si kur të ish e mundur që të bashkoheshin, independenca shqiptare, qysh m'at here, do të ish një fakt i mbaruar; por që të dy kishin mentalitet satrapi, prej të cilëvet nuk mund të dalte një gjë e re, me shpirt të ri.

KAPTINA E VIII.

Në parashtresën t'onë, është e qartë dhe e provuar në mënyrë të pa dyshimtë që popull' i parë i cili, që nga kohët prallore, i është avitur tokës Greke, ka qënë populli Pellazg. Esht një e vërtetë të cilën sot kerkush nuk guxon t'a verë në dyshim, se pse, me një fjalë, ka hyrë në fushën e fakteve historike të cilat shkenca dhe filologjia e kanë vërtetuar me një mënyrë të pa dhunëshme.

Gjith ashtu është e provuar se më vonë u ndodhën popuj të tjerë të ndihequr prej kreneve të ndryshme, u hodhë po-n'atë tokë dhe i bënë vehtes një vend në dëm të Pellazgëvet të cilët u shtërnguan të hiqen në vende të larta duke u lënë ardhësve të rinj pikë së pari brigjet e detit dhe më pastaj fushat që iqinjësonin detin.

Këjo tërheqja e racës Pellazgjike u detyrua të persëritet shum herë, se pse shohim që tej errësirave të kohërave prallore, çfaqen Eolët, Jonët dhe të tjerë të cilët shum herë përzihen nen emërtimin e Elinëve, emër i cili pikës pari mbahej vetëm prej një populësie q'ish avitur Thesalisë dhe që, siç besohet, kishte përzënë Pellazgët duke i hedhur këta në brendësin e tokës.

Më vonë arrijnë Dorinjtë të cilët përzënë një pjesë të Eolëvet dhe të Jonevet q'ishin vendosur më parë

dhe këta të mbramit shtegtojnë dhe venë e ngrehin qytetet Eolas dhe Joncas të Asis vogël duke shpënë atje një qytetrim të përparuar.

Nuk e shohim të nevojshme të ndalohemi mbi rivalitet dhe mbi luftrat që kishin ngjarë në mes të Joneve dhe të Eoleve që mbetnë në Greqi dhe të Dorinjve q'u vendosnë më pastaj, se pse Z. Paparigopullos, në historin e tij të shkelqyeshme, rëlen, në formën më terheqëse, ndryshimet e mendimeve, të vetiavet, të karakterevet dhe të aspiratavet të cilat për shum shekuj ushqyen përçarjen midis dy popujve, n'atë shkallë sa që dhe ata e konsideronin vehtëhen e tyre si dy race të veçanta që s'kanë gjë të përbashkët në mes të' tyre veç se armiqësis dhe smirit kundra njëri tjetërs.

Pellazgët me qenë se u zgjeruan duke u tërhequr në naltësinat e Epirit të Maqedhonis dhe të Ilïris, nuk patnë as një marëdhënje race as afrimi me Grekët; prandaj Pellazgët patnë një ekzistencë më vetëhe, ngrehina të ndryshme ng'ato të Greqis dhe me Eelinët q'i kishin përzënë nga toka e tyre kurrë nuk u përzien. Esht e natyrëë që këta dy popuj duhej t'armiqsonin njëri tjetërin.

Ka njers që sot pretandojnë se edhe Grekët nuk ishin gjë tjetër veç se Pellazgët, dhe në fillim të dukjes së tyre flisnin gjuhën Pellazgjike, kur se gjuha dhe dialektet Greke kanë hire më vonë, ndjet influencës të këngëvet të Omirit. Ky vërtetim ësht i drejtë: por pjesërisht, d. m. th. ësht e vërtetë se popujt e parë q'ia avitnë tokës Greke nuk flitnin veç se gjuhën Pellazgjike. Por këjo u takon vetem Pellazgëve dhe jo popullësive q'erdhnë më vonë dhe që suall me vehtëhe një gjuhë të ndryshme. Supozisioni gjenerik që bëhet sot nuk justifikohet as me histori as me fakte.

Herodoti verteton se helinēt kishin gjuhen e tyre dhe kējo gjuhē ēsht e përbashkēt për gjith bashkgjinēsit e tyre. Pra, n'ēsht se gjith grekērit në fillim nuk flisnin veç se gjuhën Pellazgjike, si bēhet që ata që erdhē për herën e parë, Pellazgēt e vërtetë dhe u mbajtne të qendruēshem në Hidre, edhe në rethujēzat e tjera të Kryepellgut ashtu dhe në malet e Atikës edhe në disa vende të Samos, të kenë ruajtur gjuhën e elēnve të tyre, kur se banorēt e tjerë po t'atyre vēndeve nuk' kanë as kujtimin?

N'ēsht se, si ç'pretendohet, raca dhe gjuha ishin një dhe për grekēt dhe për Pellazgēt, ngjarja që shēnojmë nuk duhet të ekzistonte. N'ēsht se kanë qënë prej një race dhe formonin një komb të vetëm, përse disa prej tyre u transformuan, kur se të tjerēt mbetnë si ç'ishin qysh në dukjen e parë të tyre në Kontinent duke ndejtur të dy në një qark? Ēsht e vërtetë se një ngjarje e këtillë nuk mund të ndodhte veç se pas një kataklizmit ekijameto të përgjithshëm: por në qoftë se ky kijamet do të kishte ngjarë, duhej të kishte po ato efekte për të gjithë e jo vetëm për disa duke kursyer të tjerēt.

Më në fund s'kemi as më të vogëlën dijeni mbi një kijamet të këtillë. Kurgjë nuk provon se një pjesë e këtyre popullēsive që tregohet si ēdanike qysh ngu kohërat e çfaqjes së tyre, të ketë pësuar ndryshimin e gjuhës, të zakoneve, të mendimeve të tyre për ndonjë shkak — i huaj në çeshtjen e racës e të origjinës, — kur se pjesa tjetër, duke ndejtur po n'atë vënd edhe duke pasur maredhënje të vazhdueshme me bashkēgjinēsit e tyre, të mos të jenë shtyrë prej asaj ryme. Një pohim i tillë ësht krejt badihava. Pra Pellazgēt janë raca primitive q'i janë avitur për herën e parë

kontinentit Grek dhe q'e kanë okupuar nga një kënd të tjetëri. Athere kuptohet se në gjith Greqinë nuk duhej të flitej veç se gjuha Pellazgjike,se pse Eolët, Jonët, Dorinjtë, Helinët, nuk ishin çfaqur akoma në Kontinent dhe prandaj gjuha Greke nuk mund të flitej atje. Por me t'u dukur Eolët, Jonët dhe Dorinjtë, Pellazgët u shpreqesën, shpëtuan, u vunë në në siguri nga përpjekja e ardhësve të rinj, dhe, duke u tërhequr, muar me vehtëhe, gjuhën, zakonet, besimet dhe perëndit e tyre, dhe ku do q'u vendosen, larg Greqis. në lugjet e maleve ose mbi shkëmbinjt e detit, i ruajnë si një emanet të shenjtë q'u kanë lënë stergjyshërit e tyre; i ruajnë të pa prekëshme tej shekujvet me gjith ndryshimet politike dhe fetare që kanë pasuar njeri tjetërin deri në ditët t'ona.

Për kundrazi, Helinët, qofshin Eolë, Jonë ose Dorinj, kanë mbetur me gjuhën e tyre të veçantë; këtë gjuhë t'a kenë marë me vehtëhe siç ka qënë në fillim të çfaqjes së tyre, ose ta kenë ndryshuar dhe perfeksionuar më vonë, këjo as nuk i heq as nuk i shton gjë ngjërjes. Ajo gjë q'ësht ekzaktë ësht se këjo gjuhë Greke, me pak përjashtime, ka qënë e njëjtë për të gjithë dhe s'ka pasur as më të paktën anallogji me gjuhën e Pellazgëve, për veç atyre që gjënden në renjën e fjalëvet të gjith gjuhëve që rjedhin nga një burim i përbashkët: D. m. th. gjuha Arjane dhe Sanskrite. Këtë gjuhë grekërit e kanë ruajtur, edhe nder vende ku ronin të përzier me kombet e racës Pellazgjike të cilët për llogarin e tyre kanë ruajtur gjuhën e vetë me gjith fjeshtësinë e origjinës vjetër të s'aj.

Janë kombet e racës Pellazgjike të cilët me gjith që kanë ruajtur gjuhën e tyre, më të shumat herë kanë mësuar dhe Gerqishten, por nuk dimë që Grekët të

kenë mësuar gjuhën Pellazgjishte ose që të kenë ruajtur kujtimin më të vogël t'asnj gjuhe. Në veprat e vjetëra të Helinëvet nuk gjejmë as një përmëndje, as një shënjë që të mundij të na bëjë të supozojmë të kundërtën.

Për t'ardhur në një përfundim, gjith ashtu do të thëmi se njerzit e racës Pellazgjike q'ishin prej shoqnis lartë, me gjith që ruanin gjuhen e tyre të pa pamuar, të cilën gjuhë grekët e cilësonin barbare, njihnin sipërmësinë e gjuhës greke si gjuhë e qytetruar, gjuhë dijëtare të cilën e mësonin dhe e kultivonin me dëshirë të zjart.

Por populli, shpirt' i kombit, nuk e dinte dhe nuk e fliste; provat që kemi sjellë janë të pa rëzueshme.

Shënime mbi kaptinen VIII.

Auktori në këtë kaptinë përsërit çeshtjen e origjinës Shqiptare duke meistuar mbi parimin e Pellazgevet dhe duke thënë se gjuha shqipe ësht gjuhë Pellazgjike dhe gjuha e Grekëvet ësht krejt një gjuhë tjetër që s'ka të bëjë me gjuhën pelazgjike, për veç atyre fjalëve që kanë rënja të përbashkta si fjalët e gjuhëve Ariane ose Sanskrite.

Si ç'e thamë dhe më parë shkenc' e sotme nuk pranon një theori të këtillë. Historishkronjësit Grekë përmendin një racë Pellazgjike e cila banonte reth Athinës, në një pjesë të Thesalis, në Maqedhonin orientale, në një vend që quhej Krestoni dhe në rethujzën Samothraqi; por as një shpjegim nuk japim mbi gjuhën dhe mbi origjinën e kësaj race.

Po t'analizohen gjith shkrimet e Grekëve mbi Pe-

Ilazgët, rezultoi se këta o kanë qënë Thrakas të cilët më pastaj u helenizuan ose grekrit me emrin gjenerik Pellazg, kuptonin gjith racat e vjetëra që ndodheshin në tokën Greke para se të vinin helinët. Disa nga këto raca parahelenike, si ç'meret vesh nga kërkimet arheologjike më të voneshme, kanë pasur një qytetrim miaft të lartë dhe për këtë shkak në vjershat Omerike përmenden me fjalët: «Pellazgët e Hyjëshmë». Kur kanë ardhur Helinët në tokën klasike që quhet Greqi kanë qënë krejt të egrë dhe në këtë egrësirë kanë vazhduar gjashtë shekuj, pastaj janë zbutur e qytetruar, ndjet pozitës së gjeografikë të Greqis e cila me brigjet e detit të shumta, me rethujzat e s'aj të tepërta dhe të vargoeura në drejtime të ndryshme midis detit Mesdhe, duke prannuar dhe duke asimiluar pjesërisht qytetrimin e racave parahelenike dhe të popujve të Orientit, si Egjyptas, Fenikas, Lidas, Hititas e të tjerë.

Shqiptarët, si ç'meret vesh nga krahasimi i gjuhrave, nga zbulimet arheologjike, janë Thrako-Ilirianë dhe kanë ardhur nga veriu i Evropës. Nuk' ka as një shëujë, as një provë që Thrako-Ilirianët të kenë qënë banuesit e parë të Greqis dhe të jenë përzënë prej grekëve t'ardhur nga deti. Për kundrazi historia e shtegtimit të popujve na tregon se kombet e verinit kanë qënë me të fortë dhe gjithmonë kan buçitur nga kto vënde me klimë të repët dhe kan lakmuar të pushtojnë vendet e jugut me klimë të butë. Popujt që kanë ardhur me anën e detit kanë qënë krejt të paktë dhe s'kanë pasur fuqi të përzënë ose të çdukën popuj të fortë prej racës Nordike. Edhe fiset e ndryshme si Ahainjtë, Dorinjtë, Eolët dhe Jonët që kanë formuar kombin klasik Helin, kanë ardhur nga veriu i Evro-

pës, duke pasur një farë afrimi me Iliranjtë. Këta kur kanë ardhur për herë e parë në Greqi kanë qënë t'egrë; por më të fortë nga kombet e më parëshme që kanë gjetur atje të cilët i kanë shtypur, pjesërisht i kanë çlukur dhe një pjesë e kanë asimiluar.

Gjuha shqipe ësht një gjuhë Hindo-Evropjane dhe Thrako-Iliriane. Kur se gjuha Gerqishte ësht e formuar nga përzjerja e katër dhialekteve. Maredhenja që ka shqipja me Gërqishten ësht fort e paktë; kurse me Latinishten e me gjuhën e Qeltëve ësht m'e afërtë.

BKSH

KAPTINA E IX.

Pas si kaluam, me ndihmën e historis edhe të traditave, rjeshtin e shekujvet dhe mbas si u larguam tej kohërave primitive të çfaqjes së Pellazgëve në kontinentin Grek, qendruam në bujtinat «etape» e ndryshme që kanë përshkuar dhe me prova në dorë provuam që Shqiptarët janë të paslinduritë e vertetë të tyre.

Tash na mbetet të tregojmë gjëndjen ku ndodhet sot populli Shqiptar. Do të përpiqemi të plotsojmë studimin t'onë duke vizatuar ekzistencën e sotme, organizimin politik të tij, nevojat dhe aspiratat e veta dhe, me gjith që besojmë se lexuësit nuk mund t'i paraqesim një vepre të regullt e të plotë, të paktën lavdërohemi të jemi një nga të parët që kanë vizatuar mbi këtë lëndë, një skice me tipare mjaft të theksuara; hurat politik dhe dijëtarët me këtë mënyrë do të mundën të gjejnë lëndat e nevojshme për të thelluar kërkimet e tyre dhe për t'i dhënë punimit t'onë xhvillimin që është i mundëshmë të marë.

Populli shqiptar, duke qënë i lënë në shtytkat e veta, i ngoesur me traditat e vjetëra të tij që kanë zënë vëndin e historis dhe të ligjës, i xhveshur nga letrësi e tia dhe i rethuar me mjëra veshtyrësina të cilat kanë ndihmuar në pengimin e xhvillimit moral dhe lëndor të tij, fatkeqsisht ka mbetur prapa dhe stasio-

ner si në kohrat primitive të shtetgjitimit të tij. Populli shqiptar i pajosur me një krenari karakteri tepër të shquajtuar dhe me një dashuri që nuk i bëhet ballë për racën dhe për traditat e tij, nuk mundi as të tretet e të përzihet me raca të tjera, as të xhvillojë në një shkallë më të gjërë qënjen e tij; dhe kshu në pikpamjen e përparimit edhe të qytetrimit u ki prej fqinjëvet të tij pa u lënë që të shtypen aspiratat fisnike të tyre të cilat janë ruajtja e kombesis, e gjuhës, e dinjitetit dhe e të drejtave të tij. Pellazg prej origjine dhe prej zëmre, gjith aspiratat e tyre janë përqëndruar kundrejt rujtjes të ekzistencës së tij dhe pa bërë merak për një qytetrim më të përparuar të cilit akoma nuk i dinte dobinat, ishte i kënaqur me ç'ka kishte si një trashëgim i stergjyshëve.

Trim deri në tmerëshmëni, inteligjent, i pa lodhëshmë, i kënaqur me pak, pa pasur ambicje të tepërta, as lakmi të pa drejta, është i lidhur në shkembënjt e tij me një dashuri që as gjë nuk mund t'a paksojë. I pajosur me ndjenja kalorësake, i drejtë, kembëngulës në dashurit e tij, duke aderuar të drejtat dhe ligjet e shenjta të mikpritjes dhe të fjalës, ka shkuar kuqë shekuj pa pësuar ndonjë ndryshim; si do qoftë, ka mbetur Pellazg, luftëtar, i ndershëm dhe i varfër.

Populli shqiptar ndahet në dy familje të mbëdha: Gegëri dhe Toskëri; e para quhet Shqipri e lartë dhe tjetëra Shqipri e poshtme. Shqipri e lartme fillon nga Tivari, perfshin gjith fiset katolike të Veriut, krahinat e Ipekut, të Prishtinës, të Vranjës, të Kaçanikut, t'Usqypit, të Perlepit, të Manastirit, t'Ohrës dhe mbaron n'Elbasan. Shqipri e poshtme nis nga Elbasani dhe zgjatet deri në gjin' e Prevezës.

Shqipni e poshtme ndahet në tre familje: Toskët, Çamërit dhe Labërit, q'u përgjigjen tre popujve të mbëdhenj të vjetër që hanonin n'Epirë, këta popuj janë: Kaonët, Thesprotët dhe Mollosët. Këto tre familje ndahen për së dyti në fise e në farra të tjera, që kujtojnë të 14 fiset e vjetëra për të cilët bëjnë fjalë autorët klasik, sidomos, Theopempi i permendur prej Strabonit. Shqipri e lartme nuk ndahet në familje të mbëdha; për kundrazi ësht e banuar prej një sasi fisesh tribu, «clane» q'i përgjigjen, në mos plotsisht me emertimet e tyre të tashme, së paku me numrin e tyre, popullsive të përmenduna prej të vjetërvet numrim i të cilëvet ndodhet më i plotsuar në veprat e Plinit. Ksisoj fiset e tashmë të Hotit, Klementit, Kastratit, Shkrelit, Shalës, Shoshit, Mirditës, Merturit, Krasniqit, Temalit e të tjerë u përgjigjen Ballanjve, Nestreve, Manlinjve, Ankeleve, Tavllanteve, Autarjateve, Ardenjëve, siç u thoshin të vjetërit.

Emrit Toskëri që pergjithësisht tregon Shqiprin' e poshtme nuk i gjejmë një kuptim ekzakt.

Për sa i përket fjalës Gegëri dhe gegëve, kuptimin ja gjejmë në vjershat e Homerit ku at' i vjershes thotë: «Për tej maleve të akroqeravnit (malet e rufes me tjetër fjalë malet e Himarës) rinë gegët — Jigas». —

Fjala gjigas, ka kuptimin gjigant. Pra me qënë se banorët e maleve të Shqipris Epërme gjithë kanë një shtat për mbi mesataren, të vjetërit i besonin se ishin gjigandë dhe prandaj i thirë «Gjigas dhe gegë», po ajy emër ësht i cili në të dy gjuhët ka po atë kuptim.

Ësht parë se krenët e fiseve të Shqipris epërme lashtas mernin titullin Gegë, se pse na vjen ndër mend që kemi parë më sytë t'ona një dokument zyrtar

dalë nga kadiu i parë, gjyqtar, i vendosur prej qeverisë Ottomane në krahinën e Dukagjinit në shekullin XV, pandërmjetësht pas vdekjes së Skenderbeut, vdekja e cila u pasua prej okupimit të plotë të Shqipnis ku thuhet: «Gega Lleshi, Gega Dodë, Gega Tanushi dhe një gegë tjetër emrin e të cilit s'e mbaj mend. Ianë malet e Peshterikut, në Jakovë pa i jetersuar dhe ceduar, për të shkuar e për t'u vendosur në Mirditë». Ky dokument q'u përkitte stërgjyshëve të kryetarit të Mirditës, ish në posedim të të ndierit Bib Doda Pasha, i cili para se të vdisëte na i kishte lreguar e kishim kënduar dhe jemi të sigurtë se i biri i tij, Preg Pasha dahet t'a ketë në dorë akoma.

Me qenë se në Shqipri kurrë nuk është bërë një regjistrim i populësis me regull dhe i saktë, për ne është e pa mundur të dimë pikërisht sasin' e populsis s'aj.

Me gjith këtë si nga dokumentat zyrtare, si nga informatat e veçanta që kemi për vendin, mund t'a caktojmë 1,800,000 deri më 2 milion frymë: 1,200,000 për Shqipriu e epërme dhe resti për Shqiprinë e poshtme.

Këjo popullësi që flet një gjuhë, që ka po ato zakone, ato doke dhe ato tradita, është e ndame në tre besime: Muslimane, Ortodoks dhe Katolik.

Gjysmët janë muslimanë, gjysma tjetër Hristiano-ortodoks dhe katolik.

Muslimanët të bashkuar me katolikët përfaqësojnë dy të tretat e populësis përgjithshme; Ortodoksët ndodhen në një proporsion të ⅓.

Vendi përgjithësisht është malësi dhe shum' i lehtë për t'u mbrojtur kundra shkeljes së huaj. Krahinat fqinj me bregun e detit janë shum pjellore. Lugjnat e

Bojanës, të Matjes, të Shkumbinit, t'Erzenit, të Vjosës, të Drinit, të Bistricës, të Vardarit e të tjera perfshijnë një sasi të madhe tokash produktuëse; por sistemi bujqësor ësht krej primitiv, vëndi nuk gëzon gjith dobinat që mund t'i siguronte një sistem i ndriçuar prej shkencës. Me pak përparim më tepër, produktet e tokës jo vetëm që do t'i miaftojnë për konsumimin e popullësis, por do të jepte dhe një tepricë tepër të konsiderueshme e cila do t'eksportohej në vende të huaja dhe do të shërbente si bazë për një tregëti ndërkombtare tepër fitimprurëse.

Më në fund, populli shqiptar ësht më shumë bari se bujk. Ritja e kafshëve bëhet në një shkallë shumë të gjërë dhe me një fjalë formon begatin e parë të vendit.

Në Shqipri ka pyje të mbëdhenj, rjedhina uji dhe madene të ç'do lloj që nuk janë përdorur as pak. Industri e vendit, që ndodhet akoma në shkallën e foshnjëris dhe pengimet qe ka hasur gjithmonë xhvillim' i begatis publike i bashkuar me plogështinë edhe me karakterin luftëtar të popullësis, kan kontribuar t'a lënë vendin në një gjendje vobektësie tepër të vajtuëshme, gjë e cila bën që në pikpamjen e qytetrimit modern, mund të konsiderohet si një vend tepër i prapambetur. Ku do natyra ësht kryenaltë, vendet janë madhështore, dhe veshtrim' i syrit piktoresk. Malet janë të lart' e të mbëdhenj edhe me arsye mithollogji e vjetër atje ka vendosur selin' e Perëndive dhe të Muzavet. Fushat qeshin, lumenjtë të kulluar, pyjet të virgjër e të dëndur. Më në fund ësht një vënd që shpirtron ëndëra dhe këngë, që nxjer njers të fortë, të zgjuar dhe trima, gra të bukura, të ndershme edhe besnike.

Me pak qytetrim më tepër edhe me kondita më të mira, Shqipëria jo vetëm që nuk do t'i kishte as pak lakmi Sviceës, por do ta kalonte nga pikpamja e bukuris, e poezis dhe e forcës.

Shënime mbi kaptinen IX.

Auktori në këtë kaptinë tregon se Shqiptarët janë ndarë në dy fise të mëdha: Geg' Toskë dhe se toskët ndahen në tre fise: Toskë, Laber dhe Çamer dhe se fjala «Gegë» vjen nga fjala gjigand si mbas të thënave t'Omirit, atit të vjershës.

Fjalët Gegë dhe Toskë me të vërtetë dhe në mënyrë të saktë nuk dihet se ku e kanë burimin. Mbas mendimit t'onë emrat Gegë dhe Toskë janë emra të përveçmë të cilët në kohrn të vjetëra do të kenë qënë emrat e dy të parëve, princër ose mbretër, të vendeve përkatës. Në malet e Çermenikës ndodhet një shkëmb të cilit i thonë Gur gegë; si mbas zakonit të vendit ky gur është vendi ku mblidhen periodikisht paria e maleve të Gegëris, për me vendos' ose me ndryshue duket e zakonet. Duhet të shtojmë se ky vend ndodhet në massifin ku piqen vargjet e malevei të Gegëris prej ku ndahen tri rjedhina «Versane»:

1. — Rjedhina e Matit; 2. — Rjedhina veriore e Shkumbinit; 3. — Rrjedhina lindore e Drinit.

Emëri Gegë duket të ket qënë emri i ndonjë ligjvuesi, si Dukagjini, por më i parë se ky, emri i të cilit duke qenë në zë është përgjithsuar për gjith Gegërinë.

Gjith ashtu dhe në rethin e Tepelenës, së veri lindje të Vjosës, është një vënd ku i thonë bregu i Toskës dhe kësaj krahine i thonë Toskëri. Prandaj Toska mund

të ketë qënë ndonjë i parë që ka vendosur dokë e zakone në krahinën e Toskërisë dhe më vonë ky emër do të jetë përgjithsuar e zgjeruar për t'emërtuar vendin që zgjatet deri në bregun e shkumbinit.

Auktori, përmend një nga një vendet që formojnë Gegërinë duke përmend brigjet e detit që nga Tivari e deri në Prevezë, si ç'e thotë në vjershën e famëshme të tij:

Që pri Tivari deri në Prevezë;
Gjithkund lëshon dielli vapë dhe rezë;
Asht toka jonë, të parët na i kanë lan,
Për mbrojtjen e s'oj vdesim të kan.
. . . . . .

Fjala Lab, është emri një fisi të vjetër të cilën auktorët Greko-Latin të kohëve të moçme e kanë përmendur me emrin Lapik dhe emri Çam rrjedh nga emr' i vjetër i lumit Kallama të cilin Grekërit e vjetër e shkruajnë «Thimo». S'ka dyshim se këjo ortografi që bashkonte «l»-në dhe «th»-në Gërqisht do të zëvendësonte shqiptimin e «ç»-së sotme. Kallamaja ose «Çiamia» është një lumë që përçan një pjesën e madhe të Çamërisë.

Auktori në një broshur të destinuar për propagandë n'Evropë, tregon se Shqiptarët janë një popull më tepër bari se da bujk, të lidhur fortsisht me gjuhen e me zakonet ashtu dhe me gojthanat kombtare: shton se Shqipëria është një vend pjellor, me fusha të gjëra dhe me pyje të virgjër, e pajosur me ujra dhe me madene dhe e zhukuruar me liqene. Por për fat të keq një pjes' e vendeve më të bukura të Shqipërisë ethnike kanë mbetur jashtu kufinit politik edhe nen

sundime të huaja barbare që përpiqen të çfarosin fisin Shqiptar që lëngon nen thundrat e tyre.

Auktor' i këtij libri sikur e parandiente një fatkeqsi të këtillë, me këngën e famëshme të Shqipris, ka vajtuar Zin' e kohëve t'ardhme.

BKSH

KAPTINA E X.

Jeta që shkohet në Shqipri është krejt primitive dhe patriarkale. Ç'do fis ka kryetarin dhe pleqsinë e vetë dhe që ushtërojnë gjyqsinë si mbas dokeve dhe zakoneve të vjetëra të tyre, të themeluara mbi ligjen e ahmarjes «të gjakut»: sy për sy, dhëmb për dhëmb. Kryetari dhe pleqt' e fiseve trashegojnë nga etnit e tyre vendin q'okupojnë, por këjo pozit nuk u jep ndonjë të drejtë të jashtzakonëshme ose ndonjë avantazh mbi popullin: Kryetari dhe pleqtë i shtrohen gjyqit me një titull si dhe të tjerët në çeshtjet e së drejtës komune dhe ndëshkohen po me ato ndëshkime: Një kryetar që vret vritet dhe ajy, me këtë ljalë kuptohen të gjitha.

Pa hyrë në hollësinat të cilat vepra jonë nuk mund t'i përfshijë, do të vëmë para syve të lexuësit një pjesë të ligjeve tradisionale që regullojnë maredhënjet e hanorëve në mes të tyre.

Ajy që vret vritet prej trashëgimtarëve të të vdekurit. Kur nuk mund të vritet dora vetë, vritet i ati, i biri, i vëllaj ose i kushuriri. Bile ndonjë herë vritet ç'do njeri prej atij fisi në qoftë se gjaksori edhe të afërtit e tij arrinë të shpëtojnë nga gjakmarja e palës lëaduar.

Ajy që vjedh duhet t'i kthenjë të zotit dy fishin e sendit të vjedhur, dhe pas kësaj, të paguajë një gjo-

bë për dobin e Kryetarit dhe të pleqve. Njeriu i vrarë për shkak vjedhjeje është i shpërfillur: nuk mund të thuhet se ka vdekur si burrë.

Rëmbim' i një gruaje të martuar vlen sa një gjak: Rëmbyësi ose një nga të afërtit e tij duhet të vritet prej burit ose prej të afërve të gruas së rëmbyer.

Një vajzë e fejuar, duke u martuar me një tjetër, i jep të fejuarit të këtë të drejtën të vrasë atin ose të vëllanë, ungjin ose kushurin e parë të s'aj. Në qoftë se vajza është rëmbyer, t'afërtit dhe i fejuar' i s'aj një-kohësisht kanë të drejtë dhe detyrë të vrasin rëmbyësin ose ndonjë prej t'afërvet.

Shkelja e Kurorës ndëshkohet me vdekje; burri ka të drejtë të vrasë kurvarin në është se e gjen së bashku me gruan ose shkelja e Kurorës konstatohet.

Një debitor duhet të paguajë huan e tij ashtu si e ka kontraktuar, në natyrë ose në të holla.

Pronësia është e shënjt: Kur kushi nuk' ka të drejtë të vërë dorë mbi gjën e tjetrit. Çështjet e së drejtës toksore, pronësis dhe të kufivet gjykohen prej pleqvet të cilët në këto rethana, detyrohen të hëjnë be mbi gur. Sentenet nuk' kanë apel; por me gjith këtë janë t'ekzekutueshme.

Këto ligje janë baras për të gjithë; ndryshim i fes nuk ndryshon gjë. Kur një musliman vret një të krishten, një i krishter mer gjakun ng'ajy. Kur një musliman vret një të krishter, një musliman prej fisit të të vramit, si i afërt i të vdekurit shterngohet të vrasij muslimanë gjaksor, dhe për kundrazi një i kirshter kur vret një muhamedan. Barasia e të drejtave është e plotë për gjith pa dallim: Doket e zakonet sigurojnë — vazhdimin e zbatimin ma të imtë.

Miku «Musafiri» ësht i shenjtë: Të drejtat e mik priljes nuk mund të dhunohen as me ndonjë preteks. Ajy që vret ose sillet keq kundrejt mikut, ësht i çnderuar, i përzënë prej fisit dhe kur kushi nuk mund të bëjë kreshqi me ate familje: ky turp ësht i përjetëshme, as gjaku nuk mund t'a lajë. Ajy që vret mikun e tjetërit mikpritësit i ka hua dyzet gjaqe të cilat fisi mikpritës ka të drejtë t'i kërkojë nga fis' i atij që ka vra mikun e tij.

Burri që vret një grua ësht i çnderuar; turpi spërkatet mbi gjith anëtarët e familjes tij të cilët quhen vrasësit e grave.

Ç'do fis ka kryetarin e vetë, ashtu dhe ç'do familje ka kryetarin e s'aj q'ësht më i moçmi. Gruaja më e moslshme e shtëpis konsiderohet Zonja e banesës. Dhe me qënë se jeta ësht krejt patriarkale, antarët e një familje junë lepër të shumtë. Ka familje gjer më 100-120 veta. Barat marin dhe zbatojnë urdhrat e të parit që drejton; disponon gjith ç'ka dhe gjithkënd, pa ju herë ndonjë kundreshtim. Bindja ësht e verbër, se pse nderito' i pleqëris ësht i pa kufizuar. E Zonj' e shtëpis ushtron po atë pushtet kundrejt grave dhe vajzave. Kur antarët e një familjeje kanë ndonjë ankim kundra njeri tjetërit, ësht i par' i shtëpis që gjëkon, ndeshkon dhe paqson, si mbas rethanave. Të ngritur krye kundra vendimit të kryetarit ësht një vepër që shkakton qortimin e të gjithve dhe çnderon fajtorin.

Shqiptari ësht sobër dhe kënaqet me një hejë shumë të paktë. Bukë misri, djathët dhe qumështi formojnë ushqimin renduer të tij; pin ujë dhe nuk përdor ver' e raki veç se me moderasion të math. Shqiptari vishet hollë, i reziston të ftohtit dhe të ngrohtit dhe duron lodhjen dhe privasionet me një

pakujdesi steike. Dashuria dhe smir' i tij janë të tepërta; nuk mbsheh as gëzimin as hidhrimin, qan dhe qesh pa prishur karakter' e tij. Ballë miqsis tregon një fe njomësie edhe besnikrie të provuar. Lehtësisht ekzaltohet edhe shpirtsohet prej ides-së bukuris, madhësis dhe prej punërave të shkelqyera. Esht vjershtor. Kur kushi nuk e mohon që malsori shqiptar kur hecën drejt mundimit, ësht i shtërnguar t'improvizojë një këngë të cilën e këndon pa profkëla dhe pa dobësi, në një kohë kur e ëma dhe t'afertit i venë pas, duke pas në thëllësin e zemrës dhimsë dhe qeshje në buzë. vete deri te vendi ku do të ekzekutohet. Këngët e atyre që vdesin si trima mbten të pa harnara dhe këndohen e përsëriten prej dialëris.

Pushka dhe jatagani janë armët që parapëlqen Shqiptari; sidomos pushka ësht miku dhe shoku i pa ndashmë i tij; e ka në kujdes dhe i përkëdhel me një dashuri krejt të veçantë, bën be për armët e veta si ç'bën bé për Perëndinë dhe për fen e tij; armët e bukura formojnë pasurinë dhe krenarin e tij.

Shënime mbi kaptinen X.

Auktori ne këtë kaptinë tregon zakonet që mbretërojnë në Shqipri dhe q'i përkasin personit, jetës familiare, shoqnore dhe politike. Pikat dalluëse të këtyre zakoneve janë:

1. — Jeta patriarkale;
2. — Bashkpërgjegjësia «solidaritet» e familjes dhe e fisit,
3. — Gjakmarja,
4. — Mik pritja,
5.— Nderim i grave,
6. — Respekt' i armeve.

Pjes' e madhe e këtyre zakoneve konstatohen në-shum popuj qi nuk kanë përparuar në rrugën e qytetrimit dhe që nuk' kanë mundur të formojnë një qeveri të regullë dhe një gjyqesi të qëndrueshme për të-siguruar jetën, nderin dhe pasunin' e njeriut. Por gjith këto zakone dal-ka dalë çduken, me krijimin e rrugëve, me përhapjen e arsimit, me ardhjen në kontakt me të huajt, me organizimin e një fuqie së armatosur në sherbim të Shtetit dhe me ngrehjen e një-qeveris dhe një gjyqsis së regullë.

Populli Shqiptar sot për sot ndodhet në një periudhë transitore dhe është duke kaluar fazat e nevojshme që nga një jetë primitive deri në jetën qytetnore.

Krahinat e ndryshme të Shqipnis për shum shkaqe ndodhen në shkalla të ndryshme të qytetrimit; shoqnia Shqiptare është duke kaluar nga një jetë feodale në një jetë burzhuazie. Duke u transformuar jeta disa nga zakonet e vjetëra çduken edhe disa mbetën duke u përmirësuar. Këto janë normat që na tregon historia e kombevet. Mbajtja e armëve individuale nevojitej kur fuqia publike mungonte për të mbrojtur njerinë: gjakmarja rjedh nga një ndjenj' e natyrtë e dinjitetit njerzor kur mungon një gjyqsi e pa anëshme për të merremetuar pa drejtësit. Jeta e fjeshtë vazhdon deri sa burimet e pasunis së vendit nuk janë pemëzuar. Populli Shqiptar këtej e futje nuk mund të lavdërohet me zakonet primitive; por duhet ta konsiderojë si një pikë sedre përparimin e shpejtë në rrugën e qytetrimit Evropjan.

KAPTINA E XI.

Deri në vitin 1831, Shqipria qeverisej prej paris kombtare të vetë. Ç'do qytet me një farë llojë rendësie kishte pashanë ose bejnë e vetë, i cili trashëgonte pushtetin nga etënit e tij; Port' e Naltë sanksionontе këtë zakon dhe e konfirmonte duke persëritur emninin në perkrahje të trashëgimtarit vijues.

Shqipria ndahej në dy qeveri të mbëdha,, Kryevendet e të cilavet ishin Shkodra dhe Janina. Pashaj i Shkodrës bashkonte gjith pashallarët e bejlerët e Shqipris së epërme, ashtu dhe pashaj i Janinës bashkonte pashallarët e bejlerët e Shqipris jugore.

Këta dy pashallarë, ishin si dy feodalë të mbëdhenj; me një fjalë kishin nen urdhrin e tyre pashallarët e qyteteve të fjera si dhe kryetarët e maleve që njihnin të gjith sipërmësin' e tyre dhe u bindshin urdhrave të tyre.

Shum herë është dashur të përhapet në mendimin e përgjithshmë besimi se ndërmjet Gegëve dhe Toskëvet qysh nga kohët e lashta ndodhej një lloj mosmarëveshje, mbase dhe një armiqsi tradisionale. S'ka gjë më e pa saktë se këjo. Mos marëveshja që çfaqet ndonjë herë midis tyre duhet t'i ngarkohet, jo ndonjë ndjenje të popullësive; por rivaliteteve që kanë ngjarë midis pashallarëve të Shkodrës dhe t'atyre të Janinës.

Këto rivalitete të gjitha kanë qënë personale dhe të shpirtsuara prëj ambicjeve të familjes. Populli ngu një herë ata i përkrahte; por në fund të zemrës së tij nuk i donte. Se pse kurdoherë që bëhej fjalë për të lëftuar për çeshtjen e perandoris, gegët dhe toskët vëllazëroheshin; dhe në mes të tyre nuk' kish as një ndjenjë që përpiqej t'i ndante, por kish një zili fisnike të dalloheshin prëj njeri tjetërit me trimëri, me besnikëri dhe me guxim. Gegët e toskët janë prej një familje: janë vëllezër që gjejnë struk nën një strehe dhe që ngrohen në një vatrë.

Gjer në kohën e treguar si më sipër, gjëndja e Shqipris ishte e shkelqyerë: vendi ish i bëgatëshmë, fatbardhë dhe i fuqishmë, fuqia ushtarake ishte nga më të tmershmet. Në një kohë kur mbretrit më të fuqishmë të Evropës nuk mund të mblidhnin nen armë më shumë se një qind mijë burra, Shqipria vetem, miaftonte për të nxjerë ushtërinë prej 60-80 mijë burra.

S'është nevoja t'a themi se ushtërit Shqiptare gjithmonë kanë qenë të dalluara me trimërinë dhe me zotsin e tyre ushtarake, ashtu dhe besnikërinë e me lidhjen e tyre te Sulltani. Pa vajtur në kohrat e vjetëra, gjejmë provën e pretandimeve t'ona në ngjarjet e rea: Javor, Plevna dhe Shipka rusajnë akoma trngat e trimëris të batalioneve Shqiptarë dhe flasin miaft lart për këmbë nguljen dhe për qëndritnin, ashtu dhe për përpjekjen e tmershme në sulmimet e tyre; ushtarët Rus dinë diçka në këtë pikë edhe qenë miaft burarë për të njohur të drejtën. Gjith ashtu mund të themi, pa frikë përgënjeshtrimi, se janë Shqiptarët ata që kanë mbroftur vetëm për vetëm dhe kurdoherë vendin e tyre kundra sulmimeve të fqinjëve të tyre.

dhe që kanë ndihmuar për të mbrojtur në plotsimin e pashtetit të vetë zotnimin Ottoman në Rumeli.

Për veç kësaj, Shqipria perandoris Ottomane i ka dhënë më të miret vezirët e mëdhenj edhe gjeneralët më trima. Qyprili Mehmet Pasha, Fazil Ahmet Pasha, Lutfi Pasha, Sinan Pasha, Bajraktar Mustafa Pasha edhe kaq burra Shteti e gjeneralë me vlerë të jashtzakonëshme të tjerë që kanë marë drejtimin e punëve ose kumandën e ushtëris në rethana të jashtëzakonëshme dhe me mirësjelljen e me guximin e tyre, kanë mundur armiqt' e jashtmë, kanë kapërcyer vështyrësinat e bërëndëshme dhe kanë ringjallur fuqin' dhe pashtetin e perandoris të cilin sundim' i koq, pa zotsia edhe korupsion i ministrave, më shumë raste e kanë shpënë perandorinë afër ngjirës.

Elementi Shqiptar gjithnonë ka qënë besnik në parimet e veta, Ka dashur dhe don Suvranin e tij, atdhen dhe traditat e veta dhe i don me gjith fuqin e shpërtik, me gjith energjin e karakterit të tij.

Për fat të koq, ndryshim i sistemit qeveritar të cilin burat e ngarkuar me sundimin e vëndit nuk' kanë ditur ose nuk' kanë mundur ta zëvëndësojnë volitësisht me një sistem të ri për të cilin ishin ngarkuar ta vënë në zbatim, ka sjellë trubullina në rotat qeveritare edhe ka shkaktuar një qetsim në ndërgjegjen botore. Shqipria duke u zhveshur nga administrata e vjetër dhe duke u mos zbatuar format administrative dhe ligjet e rea q'ësht duhur të vehen në zbatim, duke u mos aplikuar rasionalisht prej qeveritarëve që kanë pasuar njeri tjetërin, u bë shenjë gjujtje e lakmive të ndeshkueshme, përtërimeve pa qëndrim dhe veprimeve të pa lidhura me njeri tjetrin: Ndergjegja e popullit u trubullua dhe është tronditur midis kujtimeve

të kohës shkuar, çuditjeve të tashmë dhe të pa saktësive të kohës ardhme.

Ballë kësaj gjëndje të vajtueshme, popullsia shqiptare filloj të mos këtë besim në nenpunsat e derguar prej Stamholli për t'a qeverisur; i ka qasjtur si të huaj, se pse nuk dinin as gjuhën e popullit, as historin, as zakonet, as traditat, as dhe dëshirat e tij. Në kondita kaqë të pa përkrahëshme, autoritetet i tyre nuk ish dashur as pak; vasanin prej atij autoriteti si një gjë e nevojshme, pa u qorë, se pse dihej q'ajy autoritet buronte nga pushteti dhe nga vullneti i Sullkanit, person i shenjt i të cilit është objekt i dashurisë dhe i adhurimit prej të gjithëve. Këto adjenja rahin zemrat e Shqiptarëvet.

Për fat të keq, pashallarët e dërguar prej Stamholli për të qeverisur vendin nuk janë zgjedhur kurdoherë në mes të më të mirëve: shum prej atyne s'kanë pasur dashuri për Atdhe, as dhe për popull, dhe gjithmonë janë treguar nën raisbën e pozitës së tyre. Nuk' kanë ditur të vleftësojnë as pushtetin që kanë pasur.. as dhe disponimet me të cilat ishin shpirtsuar popujt. S'kanë ditur të sherbejnë as interesat e qeveris as që të sjellin lumtëri në popull. I janë shmëngur porosis së tyre.

Kësisoj kondita e Shqipris, për veç që nuk janë përmirësuar nën influencën e sistemit të ri q'është doshur të futet n'administratën, por janë ligsuar më keq dhe këjo, për shkak fort të qartë të këtij sistemi të papërsosur, të pa miaftueshmë dhe që burat e ngarkuar për t'a vënë në veprim as dhe vetë nuk e kuptonin ose bënin sikur s' e kuptonin. Sipërvënja e një sistëmi të papërsosur dhe pak i përshtatur gjëndjes së popullit të cilit dubet t'i

shtonte zotimet e lumtëris, mbi një sistem më primitif, për fonksionim i të cilit fillonte që prej shekujsh dhe që kish hirë në zakonet publike, e bëri që të humbas aqpeshim' i maqinës qeveritare, hodhi trubullinën në gjith degat e administratës dhe mbaroj duke tharë burimet e lumtëris publike. Tregtia pushoj për mungesë rrugash dhe sigurimi; bujqsia pësoj pengime të mbëdha ng'an e multezimëve; industrija mbeti pa punë, për mungesë inkurajimi dhe mbrojtje dhe arsimi publik s'bëri as më të voglin përparim për shkak mungese të stabilimentave shkollore, të përpjestuara me nevojat e vendit. Nga këjo rezultoj që hegatin e vjetër e pasoj një mjerim i tanishmë; tregtia u anulua për mungesë veprimi dhe prej mos besimit: dëshpërimi dhe plogshtia zunë vendin e aktivitetit bujqësor dhe industruer; injoranca e vjetër e mushtuar prej virtyteve primitive, prej bulbëris dhe prej nderimit të dinjitetit personal, u zëvëndësua me një injorancë të thatë, të pandërgjegjët dhe bija e mjerimit.

Këto kondita të trishtueshme të cilat peshojnë mbi popullin, përgjithësisht, është e drejtë ta themi, dermojnë më shumë muslimanët se sa të krishterët; se pse sherbimi ushtarak, që ka qen kaq i rëndë këto vitrat e fundit, për shkak të luftave që kanë vazhduar njëra pas tjetëres, duke rënduar plotësisht për mbi të parët, i dhjetoj, dhe duke hequr nga punim' i tokës krahët më të shëndoshë, shtoj mjerimin dhe privoj një shumicë të madhe familje nga përkrahësit e tyre, dhe prandaj nga gjith mjetet e jetesës.

Me gjith këtë Evropa që mori pjesë në fakt për hristianët nuk pati as një fjalë mëshire për muslimanët. Këjo është piklluese!

Për veç kësaj me gjith tablion e errët që do të vizatojë pena jonë për popullin Shqiptar, nuk duhet larguar nga sytë që shpirt' i këti populli akoma është i math, zemra e tij akoma e nxehtë dhe që elementet e gjallëris, të madhështis dhe të lumtëris nuk i mungojnë. Fatkeqsit q'i kanë rënë mbi krye mbase e kanë hutuar, por nuk e kanë rëzuar për dhe; miafton që Qeveria Perandore hallë së cilës është thellësisht besnik, t'i zgjatij dorën atnore për t'i tundë mefshtësinë, ta ngrejë, ta ndihmojë të ecij në udhën e përparimit dhe të qytetrimit; dhe athere do të marë vrugën e mbarë.

Shënime mbi kaptinen XI.

Auktori në këtë kaptinë bën një përmbledhje mbi administratën e ma parëshme dhe administratën e më pastajme të Shqipris dhe tregon gjith ligësitë që rrjedhin nga një administrat' e keqe, duke treguar nevojën e përmirësimit.

Para q'do gjëje lypset të shënojmë se pas luftës Russo-Tyrke më 1877-78, në një kohë kur u shfaq rezâku i parë për coptimin e Shqipris, u çfaqnë disa patriotë me një kulturë miaft të lartë si pas kohës dhe formuan një grup për të shpëtuar Shqiprinë nga reziqet q'i kërcënoheshin. Burrat që formonin këtë grup kanë qenë: Abdul Bej Frashëri, dy vëllezërit e tij Sami dhe Naim, auktor i këtij libri Vassa Pasha nga Shkodra, Hoxha Tahsin Çami, Daniel Oparaku, Kadi Shevki efendiu nga Gjinokastra, Naum Vretua nga Postenani, Nauk Veqilharxhi nga Vithkuqi dhe të tjerë burra në rendin e dytë pas kytyre. Këta burra,

materialisht dhe moralisht, kanë qënë të lidhur dhe mbase shkaktarët e lëvizjes kombtare që në histori mori emrin: Lidhja e Prizrenit. Me qenë se asi kohet mendim' i përgjithshmë i Shqiptarëve nuk ishte gati për një lëvizje separatiste ndaj perandoris Ottomane, këta burra e panë t'arsyeshme e të dobishme që në fazën e parë të çeshtjes kombtare të ndjekin vetëm qëllimin e autonomis duke bashkuar gjith vilajetet e Rumelis Oksidentale ku parazotnonte me shumicë elementi Shqiptar. Këjo politikë kombtare, si mbas kohës ish e arsyeshme, se pse ndarja krejtësisht nga Tyrqia asi kohet për veç që nuk ish e mundëshme, por do t'ishte dhe e dënëshme, për arsye se shkalla kulturore dhe qytetnore e Shqipris adodhej tepër e ulët dhe prandaj ish frika se mos hehej viktim' i anarshis. Fryma e autonomis, nën sovranitetin e Sullltanit të Stambollit, shpirtzua veprën e auktorit. Ç'do veprë duhët të çmohet si mbas kohës dhe rethanave që kanë pjellë atë veprë.

Auktori në qoftë se esht treguar si partizan i perandoris Ottomane, këjo politikë i esht diktuar nga rethanat e kohës. N'ate periudhë një autonomi e gjërë për Shqiprinë, me gjuhë zyrtare Shqipe, me një ushtëri kombtare, me një administratë vëndëse, duke mbledhur e bashkuar gjith krahinat shqiptare në një vend, do t'ishte shpëtim i Shqipris dhe sot në vënd të një Shqipris vogël prej një milion njerzish, do të kishim një Shqipri prej katër milionash. Sa do që athere popullsia Shqiptare e katër vilajeteve ku zotnonte elementi Arbnor, mund të çmohej deri në 1,800,000, por si efekt i administratës autonome që do të kishte vazhduar që nga 1878 deri në 1912 doemos do të ishte dyfishuar dhe kështu do të kishim një Shqipri të pakën me tre, katër milion njerzësh.

Brez' i ri për të kuptuar shpirtin e objektit të kësaj kuptime, ka nevojë për disa shënime.

Shqipëri e Jugës gjer më 1821 ishte sunduar prej Ali Pashë Tepelenës. Më 1822 Ali Pasha u dorzua dhe ju pre kryet edhe në vëndin e ti u emrua si Vali i Janinës Ismail Pasho Beu nga Janina q'ishte armiku i Ali Pashës dhe kish ndihmuar për rëzimin e tij. Por me qënë se ushtarët që kish përdorur Ali Pasha, kur më parë kush më vonë ishin kthyer me Sulltanin, kreret e kësaj ushtërie ushqenin një armiqsi kundra Ismail Pasho Beut. Për veç kësaj Ismail Pasho Beut në fillim të kryengritjes Greke nuk pati as një sukses, prandaj Porta e Naltë u shtërngua ta hiqte nga puna dhe në vëndin e tij emroj Ymer Virionë duke i dhënë dhe shkallën e Pashallëkut. Asi kohe valinjtë ishin dhe administratorë edhe komandantët e ushtëris që mund të axirte në kohen e luftës vilajet' i tij.

Pas rënjes së Ali Pashës gjith fuqia ushtaruke që ndodhej në Epir, u muar me kryengritjen greke e cila vazhdoj gjer më 1830 deri sa u dha vendim i Londrës që njohu independencën Greke. Me 1901 passi u zbërthye qeshtja Greke. Port' e Naltë dërgon në Manastir Sadriazen Reshit Mehmed Pashën për të shtruar Shqiprinë dhe për të suprimuar krejtësisht feodalizmën e këtij vendi.

Mustafa Pashë Bushati deri at-here kishte vazhduar të sundonte vilajetin e Shkodrës, por kur pa se Sadriazemi që kish ardhur në Manastir donte ta suprimonte, mblodhi një fuqi malsorësh dhe u nis prej Shkodre për ta lëfluar, duke kaluar nga Kosova ra në Perlep; Sadriazemi kishte me vehtëhe disa batalionë prej «Nizami-xheditit», të ushtris së re, t'organizuar pas prishjes së Jenïçerëvet; kishte disa bashi-

bozukë edhe me qënë se u muar vesh me mitropolitët Grek të vendit, të cilët dëshëronin shtypjen e Shqiptarëve, me anën e këtyre mblodhi disa kapetanë Ortodoksë Shqiptarë dhe prej viseve të tjera, i dolli përpara Mustafa Pashës dhe mbas një luftë që ngjau në grykën e Babunës, Bushatlliu u prish dhe u kthye në Shkodrë. Sadriazemi pas si vrau me të pa besë Veli Benë dhe Aslanë Benë, nga Kara-Muratas, i Toskëris, mblodhi parësinë e Toskëris dhe të Shqipris, Mesme e i internoj në Konjë e në Qutahje të Anadollit, ju lëshua Mustafa Pashë Shkodrës dhe pas disa luftërave e rethimeve, Mustafa Pasha u dorëzua dhe, ju dha fund sundimit të Bushatllive në Shkodrë.

Parësia e Toskëris, me qënë se e kish shtypur më parë Ali Pasha, Sadriazemi nuk hoqi ndonjë mundim për të shtruar Toskërinë. Pas operacionit të Sadriazemit, si në Gegëri ashtu dhe në Toskëri filloj një administratë e re kundra feodaleve. Më 1839 u çpalë reformat e mbëdha të Tyrqisë nen titullin «Tanzimati Hajrijë».

Autori në këtë kapitull kur bën fjalë për administratën e re dhe të vjetër, ka për qëllim administratën feodale të ma parëshme dhe administratën e re me bazë të sentralizimit q'u fillua me veprimet e Sadriazemit si ç'u fol ma sipër dhe u plotsua me Tanzimatin 1839 s.

Autori bën një krahasim midis dy sistemeve sundimtar dhe më në fund sistemin e sentralizimit e gjen më të dobët dhe më të dëmshme për Shqiprinë, nga shkaku i injorancës të nëpunsavë dhe të korupsionit të tyre.

Esht e vërtetë se sistem i administratës feodale në Shqipri ka kaluar dy faza: Faza e parë ka ardhur pas

okupasionit ushtarak, në një kohë kur qeveria qendrore e Stambollit ka qënë e fortë dhe nuk lejonte me as një mënyrë qeveritarët e vëndit të tiranizonin popullin. Kadilerët e asaj periudhe ishin miaft të ditur në të drejtën e Sheriatit dhe njerz me karakter. Në vendimet e tyre që gjenden aty këtu konstatohet një drejtësi e reptë dhe një paanësi e lavdëruëshme në padinat e rjedhuna midis muslimanëve dhe të krishterëve. Por kur në qendrën e Stambollit filloj të çkatërrohet morali në pallat të Sulltanit dhe në mes të drejtonjësve të Shtetit, si do mos kur hyri çregullimi në oxhakun e Jeniçerëvet, fuqia politike dhe ushtarake e perandoris, dita ditës, po dobsohej. Me nj'anë këjo dobësi dhe me anë tjatër «rushveti» e bëri që nënpunësitë e naltë të provincave, ashtu dhe kadillëket të shiteshin me të holla; prandaj morali dhe karakter' i nënpunsave ashtu dhe i gjyqtarëve, nder vilajete, filloj të tronditej dhe drejtësin e më parëshme e zevendësoj shpërdorimi; këjo ngjalli mos besimin në popull, prishi dhe qetsinë. Filluan të ngrenë krye hajdutëria. Dobsia e qeveris këtyre u jepte guxim dhe arritnë në një shkallë, sa qeveria qendrore shtërngohej të emnonte ata si administratorë dhe qeveritarë; me tjetër fjalë për të ndaluar cubëninë «hajdutllëkun», qeveria qendrore emnonte cubat sundimtarë.

Këjo faz' e dytë e administratës perandore krijoj një rend tjetër feodalësh ose fisnikë të rinj të vendit. Me këtë mënyrë feodalizma ose fisnikëria u nda në dy kategori: Të vjetër e të rinj.

Ali Pasha në Toskëri me qënë se shtypi të dy klasat që thamë më sipër, krijoj një klas tjetër si mbas mëndësis së tij. Me gjith këtë deri në zbatimin e Tenzimatit «1839», Shqipria po thua se s'paguante gjë.

Sundimtarët e vëndit, qofshin prej fisnikëve të vjetër qofshin prej të rinjve, ishin në shkallë që të mbanin një qetësi të plotë. Vetë ata edhe sikur të bënin ndonjë tirani, pak së paku ndalonin të tjerët. Populli, si muslimanët ashtu dhe të krishterët, parapëlqenin të kenë si sundimtar fisnikët e vjetër të cilët i nderonin tradisionalisht. Me një fjalë deri në datën e Tenzimatit Shqipria ekonomikisht ndodhej mjaft mirë: Tokat pjellore shin, blegtoria ish mjaft e fortë, gra burra, katundarë ose qytetarë, vishnin petkat e vëndit, këmisha prej lini ose prej mëndafshi, shajak të vëndit, opinga e kësulë të vëndit, petka të qindisur në vënd me fije mëndafshi ose ari, garçafë e mafëse prej mëndafshi, shtresa e mbulesa prej pambuku ose prej leshi të vëndit, në vënd të sheqerit përdorej mjaltë e pekmezi. Nga jasht hynte vetëm koh' e Marsiljës ose e Venedikut, fijet e sërmës kafen dhe sheqeri edhe pak vaj-guri. Kur se Shqipria eksportonte bagëti të holla e të trash, duhi' e gjalpë, landë pyjesh, lesh e lëkurë, fshika mëndafshi, shqeme «Vallamidhe» dhe kuaj nga Muzeqea, nga Zadrima, nga bregu i Matit dhe për gjithësisht nga rafshinat. Përveç këtyne hynte një pjesë e madhe nga çifliqet që kishin Shqiptarët jashtë, nga njerzit që ndodheshin në mërgim dhe nga rrogat e mercenerëve Shqiptarë që ndodheshin në shum vise të perandoris.

Nga Tanzimati e pastaj situata filloj të ndrojë krejt: Nënpunsit e mëdhenj ashtu dhe gjyqtarët vinin nga Stambolli, fuqia e armatosur e perandoris në Shqipri ishte fort e paktë, qetësia'u prish krejt dhe vendi u varfërua, pluçkën e vendit e zëvëndësoj malli i Evropës, nga prishja e qetësis dhe nga mos besimi, bujqësia, blegtoria, tregtia dhe zejtari e vëndit u paksua.

Për këto arsye, auktori në këtë kapitull parapëlqen sistemin administrativ të vjetër dhe kritikon sistemin e centralizimit që filloj të zbatohej në Shqipëri pas Tanzimatit.

BKSH

KAPTINA E XII.

Ska dyshim se, janë armiqt e perandoris Ottomane ose gjënd që nuk njohin thellësisht as ojerzit, as sendet, ata që kanë shtirë në mendimin e disave idenë se populli Shqiptar sot për sot dëshëron të ndahet nga perandoria dhe që kërkon një kombinezon i cili mund ta verë në gjendje të vetëqeverisetë nën një formë autonome. Nuk bëhet gjë më e rëmë e më e pa drejtë.

Shqiptarët që prej kaq shekujsh kanë ruajtur ekzistencën, gjuhën, zakonet dhe karakterin e tyre, janë të bindur se duke qënë nën zotnimin e një pushteti tjetër, cili do qoftë, nuk do të vonojnë të humbasin gjith këto të mira dhe do të mbarojnë duke u ndryshuar. Pra, g'do transformim që mund t'i ndryshojë gjuhën zakonet, traditat dhe kombesin e tyre, për ata do të jetë kalm' i fatkeqsis; dhe Shqiptarët dëshërojnë shumë të jenë dhe të mbeten Shqiptarë, prandaj me hirin e tyre dhe me një zëmër të lehtë nuk mund të pranojnë një eventualitet të tillë.

Gjith ashtu Shqiptarët e dinë se duke qënë të ndarë në tre besime dhe mësimi botnuer duke qënë akoma në gjëndje fillestare, nuk do të mundnin të mereshin vesh lehtas me njeri tjetërin për t'u sunduar me vehtëbe pa pasur një dorë të fortë që t'i prijë e t'i kryesojë: Kanë nevojë për një faqi që ti shtyjë e ti

ndalojë, si mbas rethanave, dhe i'u mushtojë zelin, ose i'u çpori plogështin e tyre.

Po të lehen me kokë të tyre dhe në shtytkat e tyre, do të japin pamjen e grindjeve të pa sosura të cilat nuk do të vonojnë të degjenerohen në lufta qytetnore dhe ata e dinë se ku përfundojnë këto luftëra!

Për kundrazi, janë të bindur, dhe eksperienca e pesë shekujve e ka provuar se bashkimi i tyre i ngushtë me perandorinë Ottomane formon shansin e vetem të shpëtimit: është ky bashkim q'u siguron një jetë të përshtatëshëm me dëshirat dhe me aspiratat e tyre, se pse nuk cenon as mendimet kombetare, as gjuhën as edhe traditat e tyre; nuk transformon karakterin e popullit dhe nuk kërcënon ekzistencën e tij nga pikpamja e racës dhe e kombesis.

Janë këto idera, dhe duke folur politikisht, është ky shpirt mendues që kanë lidhur racën Shqiptare në mnyrë të pa ndashme me fatin e perandoris. Këto idera dhe ky shpirt akoma janë e qëndrojnë ne gjith fuqinë e tyre: Këto janë rezultat' i ngjikshëm dhe i shtytkës të situatës së tyre. Si Shqipri, nuk mund të vazhdojë të jetojë veç se nën një zotnim që nderoi ekzistencen, zakonet dhe kombsin e s'aj dhe gjer tashti ka qënë perandoria Ottomane që ka permbushur gjith këto kondita.

Pra pamvarësisht nga anomalia e pa besueshmes dhe e pa pranueshme që do të paraqiste të shmangurit e muslimanëvet të Shqipris dhe të ndarët e tyre nga Halifati q'e adhurojnë dhe e nderojnë si një dogmë fetare, janë gjith rethanat që po parashtrojmë nëa syt' e lexuesit të cilët lëflojnë me fitim dhe e venë në puh qëllimin e keq dhe injorancën e atyre që përpiqen t'ushqejnë opinjonin publik me thënje mashtë-

rimtare ose me sende që janë të ditura dhe të futin mosbesimin në shpirtin e qeveris perandore.

Ngjarjet që janë xhvilluar në Bullgari nuk provojnë kur gjë: Me arsye nuk mund të përdoren si prova për të përfunduar se po ato ngjarje mund të ndodhshin dhe në Shqipri. Ndermjet të muslimanëve të Bullgaris dhe të krishterëve Bullgarë, qysh prej kohëve më të lashta, ka patur një largim fatal i cili ka krijuar armiqsira dhe që ka mbajtur të dy elementat ballë njeri tjetërit, në një gjendje ndarjeje të plotë, bile në jë gjëndje armiqsie të msheftë për disa dhe të cilët për të tjerët. Athere, meret vesh se një plasje qe e mudëshmë dhe bile e palarguëshme, se pse për fat të keq nuk u bë ç'lypsej të bahej për ta larguar. Fataliteti i shtyti dhe burrat e Shtetit u lanë të tërhiqeshin prej këtij fataliteti.

Por, për Shqiprinë sendet paraqiten nën një pamje krejt të ndryshmë. Muslimanët e Shqipris janë Shqiptarë si dhe të krishterët; flasin po atë gjuhë, kanë po ato zakone, vazhdojnë po ato doke dhe po ato tradita. Në mes t'atyre dhe të krishterëve kurrë s'ka pasur smire të rënjosura as dhe armiqësira shekullore.

Ndryshim' i fes kurrë s'ka qënë një shkak për t'i shtytur në një përçarje sistematike; muslimanët e të krishterët, me pak përjashtime, gjithmonë kanë jetuar, në një shkallë barasije, që gëzojnë po ato të drejta dhe përmbushin ato detyra.

Pra, konditat nuk janë të njëjta për të lejuar shpirtligësin dhe injorancën të bëjnë krahasime dhe të tregojnë shembla të parakaluara.

Gjith ç'kemi thënë provon se ësht e nevojshme mbase dhe e domos-doshme, t'i jepet Shqipris një organizim i fort, njëgjinës, i mbeshtjellë, i përshtatë-

shëm me nevojat dhe me karakteret e popullësis, dhe të vëhet, me anë reformash rënjore, në gjëndje që të xhvillojë inteligjencën, pasurinë dhe fuqinë ushtara ke të s'aj.

Me qenë se lumtëria e perandoris Ottomane është një kondit e domosdoshme për ekzistencën e Shqipris dhe të lumtëris s'aj, na kërjo rezulton se xhvillimi i Shqipris jo vetëm që nuk vjen në kundreshtim me interesat e qeveris perandore, por me arsye të drejtë do t'ishte një element fuqie, një granti rendi dhe duke folur relativisht, një kompensim i humbjeve q'i ka shkaktuar luft' e fundit a'Evropë.

Besojmë se nuk duhet një çforcim i math i imagjinatës për të kuptuar gjith rëndësin e s'aj, dobinë dhe më mirë me thënë, nevojën për qeverinë perandore që të mendojë seriozisht këtë çështje dhe t'i vërë n'akord interesat e vertetа të s'aja me dëshirat edhe me aftësit e popullësive Shqiptare. Në këtë çshtje ka vetëm fitim dhe as një rrezik ose humbje.

Shënime mbi kaptinen XII.

Traktat' i Berlinit q'u nënshkua në muajin Korrik 1878, për sa i përkiste Shqipris, përmbante tri dispozita:

1. — I jepte Serbis Sanxhakun e Nishit që kishte një popullsi Shqiptare prej 70.000 frymë;

2. — Malit Zi i jepte Gusinën e Plavën, Tivarë, dhe bajrakët e Trepshit, të Hotit e të Grudës;

3. — Greqis i jepte, për veç Thesalis, Janinën dert në lumin Kallamë.

Sanxhakun e Nishit, me qenë se Serbia e kish'e okupuar në luft' e sipër ashtu dhe Mal i Zi qytetin e Tivarit ,Shqiptarët me gjith që këto vende i revandikonin, nuk' kishin se ç'bënin, ße pse ndodheshin ballë një fakti të mbaruar dhe të konfirmuar me traktatin e Berlinit; por sa për Gusinj e Plavë, Hot' e Grudë ng'an' e Malit Zi dhe për Janinën deri në Kallama, me qenë se këto vënde ishin të Shqipris dhe nuk ishin marë me luftë, me t'u përhapur lajmi i traktatit, gjith Shqipria u tund dhe u organizua lidhja e Prizrenit, për t'i bërë ballë rezikut të coptimit. Përfaqsuesit e Shqipersi Abdul Bej Frashëri dhe Mehmet Ali Bej Vrioni u dërguan n'Evropë ng'an' e lidhjes pranë kabineteve të përfaqsuesve të mbëdhenj, për mos zbatimin e dispozitave q'u përmëndnë më sipër. Për veç kësaj nga gjith Shqiptarët që ndodheshin në Stamboll, fuqive të mbëdhaj ju drejtuan protestime reth pa drejtësive të traktatit.

Brenda në Shqipri u formuan komisione prej parïs vendit të cilët okupuan qeverit lokale. Ng'an' e Veriut kundru Malit Zi, në Gusinj' e në Plavë, n'Ylqin dhe në Hot e në Grudë, u dërguan fuqi kombtare t'armatosura për mbrojtjen e vëdit. Në Toskëri në qendrën e Frashërit u regjistruan 30.000 shpirt për t'okupuar Janinën e Prevezën dhe për t'i ba ballë me armë Greqis që mund t'i okuponte vëndet me ushtëri.

Gjith këto ngjarje, i dhanë të kuptojë Evropës se populli Shqiptar ishte i gjallë dhe që dodhej në gjëndje të ruante vendin e vetë me armë në dorë.

Me anë tjetër komisionet e formuara brenda në Shqipri dhe që kishin lidhje me atë të Prizrenit nenshkruan një parashtresë të përgatitur në Frashër me të cilën kërkonin prej Sulltanit dhe prej Portës Nallë

bashkimin e vilajeteve Shqiptare në një vend, emnimin e një qeveritarit të përgjithëshmë, autorizimin e gjuhës Shqipe dhe formimin e një fuqis ushtarake që do të bënte pjesë plotësuese të ushtëris imperiale. Me fjetër fjalë kërjo parashtresë kërkonte qartaz autonominn e Shqipris.

Gjith këto ngjarje e lëvizje në shtypin e Evropës u përhapne dhe u interpretuan me mënyra të ndryshme. Disa thoshin se Shqipria po ndahet nga trupi i perandoris Ottomane, disa thoshnin se Shqipria kërkon autonomi, disa ishin pro dhe disa kundër. Gazetat shtypi i Moskovit, i Greqis dhe i Serbis si dhe shtypi i partizaneve të Lyre thoshte se lëvizja e shqyptarëve është blof dhe e shtytur nën dorë prej Sulltan Abdul Hamidit.

Auktori me këtë broshurë i përgjigjet shtypit të botës duke thënë se Shqiptarët s'kan interesë që të ndahen krejt nga trupi i perandoris; por që kërkonin një autonomi dhe që kjo nuk ishte kundra interesave të vërteta të perandoris Ottomane dhe q'ishte një gjë e dobishme si për Shqiprinë ashtu dhe për perandorin.

Paria intelektuale e Shqipris aherëshme nuk' kishte desidnar plotësisht për një ndarje definitive nga perandoria Ottomane. Por sa për autonominë e dëshëronin me gjith shpirt. Shkaqet e nos ndarjes definitive ishin këto:

1. — Rafsha kulturore e Shqipris ndodhej në një shkallë kaq t'ulët sa kryetarët e lëvizjes kishin frikë se një ndarje e tillë do të zbërthente një anarshi kaq të madhe dhe të vazhdueshme sa mun d të rezikonte jetën e Shqipris.

2. — Me qënë se Shqipria kishte një populsi muslimane me shumicë të madhe, si mbas ndjenjave fetare t'aherëshme, një kryengritje me armë kundra Sulltanit Halif për një ndarje definitive do t'ishte e dyshimtë.

3. — Shqiptarët kishin kaqë interesa ekonomike të përbashkta me perandorinë sa që ndarja ng'ajy trup i math do të provokonte një varfëri në Shqipri.

Autori me këtë broshur të botuar për opinjonin publik të Evropës shënon disa pika në këtë kaptinë. Pa u çkoqitur gjendja e aherëshme, brënda dhe jashtë Shqipris, nuk mund të kuptohet dhe të çmohet mirë vepra e Vassa Pashës që jemi duke përkthyer e shpjeguar.

KAPTINA E XIII.

Cila ësht organizata që ka nevojë Shqipria për t'u vënë në gjëndje të xhvillojë burimet e vëndit dhe të lumtërojë? Ja një çeshtje për të cilën mbase prej shum kohe bëhet fjalë pa reusërtur t'i epet një zgjidhje e arsyeshme. Kujt mund t'i a ngarkojmë këto fakt të vajtueshmë?

Ka shumë vjet që Gibboni ka shkruar këto fjalë: «Brëndësia e Shqipris ës!:t më pak e njohur na brëndësia e Afrikës». Këjo a ësht një paradoks? Duke parë se ç'thuhet dhe ç'mendohet akoma për këtë vënd, jemi të shternguar të besojmë se Gibboni ishte në të drejtë dhe se situata s'ka ndruar aspak. Shqipria nuk ësht njohur, edhe për këtë shkak nuk ësht ditur as mundur t'i jepet një organizatë e pershtatëshme, praktike, që të mund të sjellë rezultate të cilat qeveria perandore osht dhe popullsitë kishin të drejtë të prisnin.

Në vend që të studjohej çeshtja në gjithsin e s'aj, gjithmonë janë marrë me detaje, me disa situata pjesore, bile me disa sende jo të vërteta. Duke mos ditur gjuhen e vendit, karakterin edhe traditat e popullit, gjith ata që janë okupuar me këtë çeshtje kanë qënë të shtërguar t'u stilen raportave të së tjerëve, njoftimeve të njerzëve të pa ditur ose inkompetent; dhe kshu për ata ka qënë e pa mundëshme të bëjnë

një mendim të kulluar, të prerë dhe të plotë mbi vëndin, mbi aftësitë dhe aspiratat e banorëve, mbi burimet natyrale të tokës dhe të dobinave të situatës së sotme.

Prandaj njeriu nuk duhet të çuditet n'ësht se vëndi ndodhet në kërleshje me nevojat, me aspiratat e veta, me pa miaftësin e mjeteve, me ngatërrimet e administratës, me mjerimin dhe me çgurxëmin.

Në formimin e vilajeteve, faqeza kanë pasur vetëm një qëllim, të bashkuarit e qyteteve dhe të katundeve në numër të miaftueshmë për të formuar grupe popullësish miaft të rëndësiëshme, pa u marë parasysh hashkangjinësia e grupeve, as dhe ndryshim i racave, i gjuhëve, i dokeve dhe i zakoneve të njerzve që fucmojnë ato qytete e katunde. U ndanë ata që duhej të ishin të bashkuar, dhe u vunë së bashku elemente të ndarë, të cilët duke qënë të shtytur prej parimeve të ndryshme, kanë lëftuar njeri-tjetrin dhe mbaruan duke asjetërsuar njeri tjetërin po në një kohë që asjetërsonin veprimin e qeveris dhe xhvillimin e burimeve botnor.

Kësi soj Shqipria u nda në tre vilajete: Shkodre, Janinë dhe Manastir. Kohrat e fundit u bë një ndryshim i ri dhe u krijua vilajet i Kosovës, i përbërë prej sanxhakëve të Prishtinës, Novi-Pazarit, Pizrenit, Ueqypit, Dibrës, Nishit e Sharqojit. Manastiri, nuk di se pse, u bashkua me Selanikn.

Vilajet' i Janinës u formua prej sanxhakut të Janinës, Prevezës, Gjinokastrës, Berat dhe Larisës. Me kët mënyrë, Nishi dhe Sharqoj, vënde të banuara prej një shumicës Bullgare, dhe Novi Pazari i cili gjithmonë ka hërë pjesë të Bosnjes, u bashkuan me

një provincë të Shqipris Epërme ashtu dhe Larisa, vënd i Thesalis u bashkua me Shqipërinë e poshtme.

Si mbas mendimit t'onë, ndarja e Shqipris në tre vilajete vet-vetiu miaftonte për të çkatruar plotsisht veprimin mirë bërës të unitetit administrativ, pa e agravuar ane një të përzier jetërgjinëse, si ajy që thamë më sipër.

Fjales së lashtë «diviđe et imperas», ndaji për të mbretruar, i ka shkuar koha, se pse ryma e shekullit që shtyn në bashkim, ç'do gjë që prier për të çbashkuar, për veç nuk formon një element fuqie, më në fund nuk është veç se një fuqi rënuëse. S'ka nevojë tjetër veç se të themi që ju se ku janë efektet, të dukshme, pulzuëse, për të provuar vërtetsinë e sendeve që thamë më parë.

Një eksperiencë e gjatë dhe e pëkllueshme na ka treguar se që kur Shqipria u privua na forma administrative e vjetër e s'aj dhe u nda në tre provinca të qeverisura prej njerzve që nuk njohin vëndin, nuk dinë gjuhën dhe zakonet e banorëve, Shqipria ka humbur shumë nga fama, nga fuqia, nga pasuria dhe nga lamtëria e s'aj.

Ligjet e Tanzimatit dhe reformat të cilat shumë herë është dashur të vëhen në veprim, në vënd nuk' kanë zënë rënjë, se pse veprim' i një qeveritari është asjetërsuar prej veprimit t'atij q'e ka zëvëndësuar. Disa, duke pasur mendime propanike, përkrahnin gabimet e kohës shkuar dhe rëndin e vjetër të sendeve; dhe të tjerët me gjith që donin të bënin sende të ra, por populli ato nuk i kuptonte.

Përjashtimet dhe privilegjet e banorëve të malevet vinin në kundreshtim me mënyrën me të cilën administroheshin popullësit e fushës.

Vëndet kufitar me Malin e Zi dhe me Sërbinë ishin të përjashtuar nga rekrutimi ushtarak; kur se të tjerët i shtroheshin me forcë. Me këtë mënyrë, ku do kishte mungesë bashkimi, mungesë njëformësie, mungesë barasije administrative dhe prandaj konfusion në mjetet të autoritetit publik. Këtyre vështyrësinave t'u shtojmë dhe dhënien e marjes së një pasaporti për të vajtur nga një vilajet, te tjetri, të konsiderohen njerzit e nji qyteti Shqiptar si të huaj në një qytet Shqiptar tjetër, taksat, oktrova dhe kaq masa të tjera të cilat, pa qënë të dobishme për qeverin perandorë, dukeshin sikur donin të sillnin një çarje e ndarje, bile një pabarasi të së drejtave dhe të detyrave në mes të njerzve po të një vëndi dhe një race.

Këto veshtyrësina, si mbas mendimit t'onë nuk mund të çdukon deri sa do të vazhdohet të qeveriset Shqipria në tre trupa të ndarë, dhe me tri administrata të veçanta. Dyzet vjet mundime dhe fillesa të pa dobishme provojnë se, mendimi jonë është bazuar mbi eksperiencën dhe mbi fakte kondra të cilave fjalët dhe ipotezat nuk mund të lëftojnë.

Eksperiënca të rea me nji kuptim separatist, besojmë se nuk do të bënte gjë tjetër veç se të ligështonte situatën, të shtonte çkurajimin dhe të thante burimin e gjallnis së vëndit.

Prandaj na dukët se është n'interesën e gjithëve me një interesë kryesore bashkim i Shqiprjs në një vilajet të vetem, me një organizim të fjeshtë, të përmbledhur dhe të fortë, duke i dhënë një pjesë të gjërë elementit të vëndit n'administratën publike dhe të inogurohet nën hijen e N. M. T. Sulltanit një periudhë bashkimi dhe vëllazërimi për gjith besimet dhe për gjith fetë.

Është bashkim' i gjith nënshtetasve që bën fuqinë e një përandorije, garanton përparimin, lumtërinë dhe madhështin e s'aj; ndarja dhe përçarja, d. m. th., dobsia, mjerimi dhe dekadenca.

Duke pajuar Shqipërinë me një administratë bashkimtare me ligje baras për të gjithë në zbatimin e tyre, do t'i epet shpirt guximit në zemrën e popullit dhe si rezultat' i parë pikës pari do të bëhet vibet në dorë sigurimi publik, respekti për autoritetet e kushtetuar dhe besimi i të gjithëve në kohën e ardhme.

Me këto tri elemente të rendit e të lumtëris publike, është e sigurtë se bujqsia nuk do të vonojë të marrë përpjestime ma të mbëdha; ushqimi i kafshëve, kjo pasuni e parë e vëndit do të bëhet në një shkallë ma të gjërë, tregtia do të marë hapa më të sigurta dhe më të çpenguara, industria do t'i krijojë vendit burime të reja dhe arsimi publik do të mbarojë duke u përhapur ku do, duke sjellë me vëhte, përparimin, qytetrimin dhe prandaj begatinë dhe mirëgjëndjen e përgjithshme.

Dhe më qënë se karakter' i popullit Shqiptar është mallsishit luftëtar, Qeveira perandore mund t'i apë një organizim ushtarak të tillë si ajy i Svierës, dhe kshu në fund të gjashtë deri në tet vjetë, Shqipria do të ndodhej në gjëndje që t'i jëpte perandoris 200 batalione prej trupave t'organizuara mirë, të mësuar, të diciplinuar, besnikë dhe trima; 200 batalione që do të vriteshin të gjithë gjer te ushtari i fundit për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e perandoris dhe për të dëshmuar lidhjen e pa ndryshueshme dhe të vazhdueshme që kanë ndaj personit të shenjtë të Suvranit të tyne.

Shënime mbi kaptinen XIII.

Me qënë se qëllim' i auktorit me këtë vepër ka qënë një propagandë hrënda dhe jashtë në përkrahje të autonomis Shqiptare, në këtë kaptinë vazhdon të tregojë gabimet e administratës, injorancën e nënpunsave të lartë dhe vështyrësinat që rjedhin nga një ndarje e qarqeve administrative midër vilajetet Shqiptare. Këto ikonveniente i përmbledh në disa pika:

1. — Auktori thotë se Shqipcia në vend që të përmblidhej në një unitet administratif, pikës pari u nda në tre vilajete, masandaj u krijua dhe një i katërt në emrin Kosovë,

2. — Vilajet i Janinës për veç sanxhakeve të Gjinokastrës, Beratit dhe Prevezës, përfshin dhe Sanxhakun e Thesalis që ka për kryevend Larisën, sanxhak i cili është i bantuar prej grekëve. Gjith ashtu dhe vilajeti i Kosavës, për veç Prizrenit, Prishtinës dhe Ipekut, perfshinte dhe sanxhakun e Jeni Pazarit që banohej prej boshnakëve dhe prej sanxhakut të Nishit dhe të Shar-qoji që banohej prej Bullgarëve. Më në fund thotë autori dhe sanxhaku i Manastirit ju aneksua Selanikut.

Për të dhënë një kuptim të mirë brezit të ri mbi situatën administrative të vilajeteve Shqiptare e shohim të nevojshme që të japim disa shpjegime:

Para Tanzimatit Shqipria, si gjith vilajetet e tjera të Tyrqis, ndahej në disa unitete administrative, d. m. th., në vilajete, dhe këto në sanxhake dhe këto në krahina. Në qendrën e vilajeteve qendronte një «Ajalet-Valisi» dhe në qendrat e sanxhakeve një «sanxhak

o bein dhe nëpër krahina ndodhej një «muselim». Në kohra të vjetëra Shqipria ndahej në tri Ajalete: 1. — Janinë, 2. — Shkodrë, 3. — Ohri. Këjo ndarje dukej m'e arsyeshme, se Shqiprinë e ndante në tri copa: Jugë, Veri dh Mes. Ajalet i Ohrit që qubej Shqipri e mesme përfshinte dhe Durrsin, d. m. th. se shtrihej deri në Adriatik; gjith ashtu dhe Shkodra përfshinte Prizren, Jakovë dhe Ipek.

Pas Tanzimatit me qënë se Rusia kërkonte të ndante nga Tyrqia, popujt hristianë sllavë, së pari në provinca autonome dhe pastaj në Shtete independente, Turqia për të humbur tragën e shumicave q'ishin prej një race, prej një gjuhe dhe prej një feje, mendoj që ndarjen e vilajeteve ta bënte me atë mënyrë që as në ndonjë vilajet të mos kishte shumicë Sllavë kristianë dhe kshtu shtërngohej që vilajeteve t'u epte një dasi edhe një gjërësi jashta nevojave gjeografike dhe ethnike. Bije fjala u krijua vilajet i Manastirit duke përfshirë dhe sanxhakun e Serfixhes popullsia e të cilit ishin Grekër me pakica turqësh dhe ag'an' e Shqipris po ky vilajet përfshinte dhe krahinën e Ndroqit e cila ndodhet 10-12 qilometro larg Durrsit. Këjo gjë formonte një anomali gjeografike dhe ethnike edhe kshu në një vilajet përmbliheshin grupa Shqiptarësh, Bullgarë e Grekër të cilët s'mereshin vesh kurrë me njeri tjetërin. Për të shërbyer të këtilla qëllimeve anormale, vilajet i Shkodrës përfshinte vetëm sanxhakun e Durrsit dhe malsinat e Shkodrës, me një popullsi prej 200.000 frymë kur se vilajet' i Manastirit kishte 1,250.000 frymë. Gjith ashtu dhe vilajet i Kosovës me gjith që kishte një shumicë popullsi Shqiptare, përfshinte dhe sanxhakët e Tashlixhes e të Senicës q'ishin Serbo-Bushna-

kë dhe sanxhaku i qendrës Yeqypi, duke përfshirë qarqet: Ishtip, Karatovë dhe Koçanë përfshinte një sasi të konsiderueshëm Bullgarë. Me këtë mënyrë dhe vilajet i Kosovës përmbledhte në një vënd tre elemente: Shqiptarë, Serb, dhe Bullgarë. Ky sistem administratif me të vërtetë paraqiste veshtyrësnia të mbëdha se këta popuj të ndryshmë gjithmonë ndodheshin në konflikt me njeritjetërin.

Parndaj auktori çfaq mendimin se do të ish gjë e dobishme që vilajetet që përmbledhnin shumica të mbëdha Shqiptarësh të bashkoheshin me një vënd. Ky bashkim do të lehtësonte administratën, populësit prej një gjuhe e një gjaku do t'i afronte njëri me tjetërin, zakonet dhe nevojat e vëndit do të kuptoheshin më mirë dhe si përfundim gjëndja do të përmirësohej.

Auktori me këtë veprë bohet interpret i qëllimeve që përfshinte parashtresa e Lidhjes së Pizrenit për bashkimin e vilajeteve shqiptare në formë autonomije dhe konkludon tue thënë se Shqipria e bashkuar me këtë mënyrë do t'ish e zonja të qiste 200 batalione ushtarë t'organizuar, të disiplinuar dhe të shpirtësuar me ndjenja kombtare, do të formonin një fuqi e cila do të peshonte me rëndësin e s'aj në çeshtjet Ballkanike.

Midis burrave të shtetit të perandoris Ottomane, me gjith që të rallë, por ka pasur disa njers të mënçëm që kanë pasur këtë mendim: Si Ahmet Ejup Pasha dhe Gazi Ahmet Muhtar Pasha, dy gjeneralë të shquar të ish perandoris Ottomane.

KAPTINA E XIV.

Arritmë në fund të panimit t'onë. Mirë ose ligësht punën e bëmë me ndërgjegjje, më bindje dhe si detyrë. Besojmë se gjith ç'kemi thënë është e damkosur në kend me të vërtetën e forcuar prej historis, prej traditave dhe prej logjikes së ngjarjevet.

Me cilësin t'onë si Shqiptar, kemi bindje për sa kemi thënë dhe besojmë se kemi kryer një detyrë duke thënë hatnësht. Kemi pasur një qëllim, i cili është të bëjmë të njohur popullin Shqiptar duke treguar origjinën dhe fazat prej të cilavet ka qënë i shtrenguar të shkojë gjat xhvillimeve të shekujve, për t'arritur në ditët t'ona: e pershkruam si ç'është, me cilësit, më të mirat, me nevojat dhe me shpresat e tij.

Duke qënë i haruar, kemi dashur ta sjellim në kujtimin e popujve të qytetruar: duke qënë i përburzur, e mbrojtmë kundra qëllimeve të këqia; duke qënë i ngarkuar me epitje, u munduam t'i apim të drejtë.

A esht një krim të duam vëndin t'onë? Ç'ka është një cilësi, një burni për të tjerët nuk mund të jetë tjetër send për né. Kemi guximin e mendimit t'onë dhe zëmrën që digjet me dëshirën të shohim Atdhenë t'onë, fatbardhë dhe të math, donim që të mos dalë i furpëruar në pranësinë e kombeve të qytetnuar, të nderçëm dhe panëtorë.

Ky është shkaku që na shtyti, ndjena që na dha guximin.

E thamë qysh në fillim, se ky punim nuk është as i rëgullt as i plotë, për të qënë kësisoj lypsen shumë, është një punim për kujtimin, një sqen' e fjeshtë, një kanavac' e përgatitur për një studim që do të lypte një xhvillim të math.

A do të kthehemi përsëri në këtë çeshtje? Vetëm Perëndia e di. Por të tjerë më të aftë e më të dëtur mund të merren me këtë subjekt për interesen e shkencës: Dëshirat t'ona do të shkojnë gjithë ata që do të studjojnë Shqiprin dhe Shqiptarët, se pse detyru të ngrehç mbë këmbë një popull që ka rënë, është një përpjekje fisnike.

Nuk jemi eksklusivistë, Dinim vëndin t'onë, por duam aq dhe mbase më shumë të vërtetën dhe drejtësinë. Në qoftë se jemi në gabim, le të na i tregojnë, do të korrizhojmë vetë-vehtëhen. Në qoftë se mendimet t'ona nuk' kanë bazë, le të na i bëjnë t'i shofim, dhe nuk do të dyshojmë as pak që të rjeshtohem' nga an' e së vërtetës. Gabimi për njerzit është. «Errare humanum est». Një lurp i rëmë kurrë nuk do të na shtije të përkrahim një parim fallco, se pse qysh kemi guximin e mendimit t'onë, asht u kemi dhe guximin të pohojmë të pa drejtat dhe gabimet t'ona, kur i konstatojmë. Një pohim i tillë nuk çnderon as pak.

Greqis i dhamë të drejtë, sa do që madhëria e shkuar e s'aj s'ka nevojë për voten t'onë për t'i u impozuar admirimin e brezave të më pastajmë. I njohim titullin si nëna e qytetrimit. Përulemi përpara gjenis të pa imituëshmë të s'aj. Kush guxon të përdorij pendën nuk duhet të mos dijë se sa i detyrohen racës Greke njerzia, shkencat dhe artet, kësaj race më

një lëng të fortë që ka mbulluar botën mbarë me gloritn e s'aj.

Por ky nderim i singjertë q'i bejmë Greqis nuk duhet të shtypij dashurinë t'onë që kemi për Shqipërinë; është Atdheu jonë dhe dëshërojmë t'a shohim fatbardhë e të bashkuar nën hijen e Sulltanit. Para pëlçejnë ta qajmë të vdekur se sa ta shohim të coptuar për filimin e fqinjëve t'onë.

Nuk duam që populli Shqiptar të humbas tipin karakteristik të tij, zakonet, legjendat dhe gjuhën e vetë. Këto janë begatit e vetmа që na kanë lënë etnit t'onë. Dëshërojmë t'i ruajmë.

N'është se këjo dëshirë është e pa drejtë, le të na i provojnë.

FUND

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

BKSH

ВКSH

BKSH

BKSH

BKSH